



**Komuna e
Istogut**

2012/2017

...për qytetin tim!

Plani Lokal i Veprimt në Mjedis



Plani Lokal i Veprimit në Mjedis

2012/2017



Komuna e Istogut

Projekti është financuar nga:



Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar.

Zbatimi i projektit është mbështetur edhe nga:



MMPH dhe MAPL.

Ky projekt është zbatuar nga:



REGIONAL ENVIRONMENTAL CENTER

Qendra Rajonale e Mjedisit, REC – Zyra në Kosovë.

Botim i Qendra Rajonale e Mjedisit, REC – Zyra në Kosovë.
<http://kosovo.rec.org/>; <http://www.rec.org/>

PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2012/2017

Copyright © 2012 REC

Të drejtat e botimit të këtij publikimi i mban:

Qendra Rajonale e Mjedisit, REC – Zyra në Kosovë

Design & Layout: Arben Grajqevci (Rrjeti)

Shtypi: RRJETI, Prishtinë

Përmbajtja

Ç'është REC?	7
Fjala e Kryetarit të Komunës.....	9
Fjalorthi i shkurtesave.....	10
Akterët dhe përgjegjësitë e PLVM-së.....	11

Pjesa 1

I. HYRJE	15
Detyrimet ligjore për hartimin e PLVM-së	15
Plani Lokal për Veprim në Mjedis ka për qellim të:	15
Metodologjia e përgatitjes së PLVM-së	16
Dokumenti është i hartuar mbi tri baza kryesore:.....	17

Pjesa 2

Informata të përgjithshme për Istogun.....	19
2.1 Historiku	19
2.2 Popullsia	20
2.3 Barazia gjinore	21
2.3.1 Shkaqet që prodhojnë varfëri dhe diskriminim gjinor	22
2.3.2 Mekanizmi për arritjen e barazisë gjinore	22
2.4 Punësimi dhe papunësia.....	23
Mjedisi social dhe ekonomik	24
2.5 Mirëqenia sociale.....	24
2.6 Shëndetësia.....	24
2.7 Arsimi	24
2.8 Sipërfaqja, dendësia e banimit	25
2.9 Infrastruktura rrugore.....	26
2.10 Transporti publik	27
2.11 Rrjeti elektrik	27

Pjesa 3

III. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese	29
3.1 Pozita gjeografike.....	29
3.2 Kushtet klimatike	30
3.3 Mjedisi	31
3.3.1 Ndotja urbane	33
3.3.2 Mbeturinat	33
3.3.3 Mirëmbajtja e gjelbërimit të qytetit	34
3.4 Ajri	35
3.5 Tokat	36
3.5.1 Tokat erozive	37
3.5.2 Pyjet	38
3.5.2.1 Gjendja e pyjeve	39
3.5.2.2 Roli prodhues	39
3.5.2.3 Menaxhimi i pyjeve	39
3.6 Uji 40	
3.6.1 Burimet.....	41
3.6.1.1 Cilësia e ujit.....	42
3.6.2 Burimet e ujërave termominerale:.....	42
3.6.2.1 Uji termal i Banjës	43
3.6.3 Gjendja mjedisore e burimeve të Istogut.....	43
3.6.4 Menaxhimi i ujërave	44
3.6.5 Mbrojtja e ujërave nga ndotja	45
3.6.6 Kanalizimi.....	45
3.6.7 Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore	47
3.7 Biodiversiteti.....	48
3.7.1 Peizazhet	49
3.7.2 Shpellat	50
3.7.3 Bota shtazore dhe bimore	50
3.7.4 Trashëgimia natyrore.....	50
3.7.4.1 Mokna	51
3.7.4.2 Ruajtja e trashëgimisë natyrore	52
3.7.5 Trashëgimia kulturore	53
3.7.5.1 Trashëgimia arkitektonike	54
3.7.5.2 Trashëgimia etnokulturore	57
3.7.5.3 Trashëgimia shpirtërore:.....	58
3.7.6 Zhvillimi ekonomik	58
3.7.6.1 Bujqësia	58
3.7.6.2 Prodhimtaria perimore.....	60
3.7.6.3 Zhvillimi i pemëtarisë	61
3.7.6.4 Agrikultura (Blegtoria, bimët mjekuese)	62
3.7.6.5 Apikultura	62
3.7.6.6 Akuakultura (Kultivimi i peshkut)	63

3.7.6.7 Pylltaria	63
3.7.6.8 Industria dhe zhvillimi ekonomik	64
3.7.6.9 Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme	64
3.7.7 Tregtia.....	64
3.7.8 Zejtaria.....	65
3.7.9 Turizmi	65

Pjesa 4

IV. Anketa me qytetarë dhe Identifikimi i Problemeve	69
1.1. Pesë problemet kryesore në fushën e mjedisit në Komunën tuaj	69
1.2. Tre ndotësitë kryesore të mjedisit në territorin e Komunës tuaj	69
1.3. Çka duhet të jetë bazë e zhvillimit të ardhshëm të Komunës suaj?	70
1.4. Rrumbullakësoni tri problemet që më së shumti ndikojnë negativisht në cilësinë e jetës në lagjen tuaj?	70

Pjesa 5

Identifikimi i Problemeve	71
1.Ujërat	72
2 toka	73
3 Ajri	74
4 Biodiversiteti	74
5 Mjedi social dhe ekonomik	75
6 Turizmi	76
V. Planifikimi i veprimeve	77
Literatura/Referencat	103



Ç'është REC?

Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) është organizatë ndërkombëtare neutrale, joavokuese dhe jofitimprurëse, e cila mbështet zgjidhjen e problemeve mjedisore në Evropën Qendrore dhe Lindore (EQL). Kjo qendër e përmbush misionin duke promovuar bashkëpunim ndërmjet Organizatave Jo Qeveritare (OJQ), qeverive, bizneseve si dhe personave tjerë kyç mjedisor si dhe duke përkrahur këmbimin e lirë të informatave dhe pjesëmarrjen publike në vendimmarrjen për mjedis. REC është themeluar në vitin 1990 nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Komisioni Evropian dhe Hungaria.

Aktualisht, REC bazohet ligjërisht në Kartën e vet, nënshkruar nga qeveritë e 29 vendeve dhe Komisioni Evropian dhe në një marrëveshje ndërkombëtare me qeverinë e Hungarisë. Zyra qendrore e REC-ut është në Szentendre, Hungari si dhe zyrat fushore dhe zyrat e shteteve në 17 vendet përfituese.



Fjala e Kryetarit të Komunës

Të nderuar qytetarë të Komunës së Istogut

Kam nderin dhe kënaqësinë që t'ju njoftoj rreth procesit të hartimit të Planit Lokal të Veprimit në Mjedis (PLVM), proces ky mjaft i rëndësishëm për të ardhmen e Komunës tonë. Për realizimin e suksesshëm të këtij projekti, fillimisht, është themeluar një trup koordinues prej pesë (5) anëtarësh në nivel të Komunës, e që pjesë e të cilit trup është edhe Nënkryetari i Komunës. Më pastaj kemi themeluar Grupin Punues me 21 anëtarë nga shërbyes civilë, përfaqësues biznesesh, si dhe nga shoqëria civile, të cilët me mjaftë përkushtim kanë punuar në hartimin e PLVM-së, duke bashkëpunuar ngushtë edhe me përfaqësues të Ekzekutivit dhe Legjislativit të Komunës tonë të cilët ndihmuan duke ofruar informacion dhe të dhëna të dobishme nga fushat e ndryshme, si mbrojtja e mjedisit, urbanizmi, shëndetësia, zonat e gjelbra, komunikacioni, bujqësia, ekonomia, mirëqenia sociale etj. Në këtë kontekst, kontribut të çmueshëm për hartimin e PLVM-së kanë dhënë edhe qytetarët tanë me opinionet e tyre që kanë të bëjnë me sferën e mjedisit.

Qëllimi kryesor i këtij plani është krijimi i strategjisë për tejkalimin, gjegjësisht eliminimin e problemeve të ndotjes së mjedisit jetësor, po ashtu edhe të problemeve të natyrave të tjera. Që të arrihej ky qëllim, ishte e nevojshme të punohej në kontinuitet, në mënyrë kualitative dhe objektive. Për veprimtaritë dhe fazat e përgatitjes së PLVM-së, qytetarët e Komunës së Istogut ishin të informuar nëpërmjet mjeteve të informimit publik, të atyre elektronike dhe të shkruara, po ashtu edhe përmes takimeve direkt, përmes debateve publike dhe tryezave të caktuara. Hartimi i një plani afatgjatë mjedisor do të bëjë të mundur zgjidhjen hap pas hapi të problemeve mjedisore.

Natyrë e Istogut është shumë e vlefshme. Ajo ka shumë funksione, është shtëpi për shumë lloje të florës dhe faunës. Istogu me burime të fuqishme të ujit, me tokë pjellore, me një trashëgimi të pasur natyrore dhe kulturore, ofron rekreacion për banorët lokalë dhe tërheq turistët që kontribuojnë në ekonominë lokale. Andaj, qëllimi dhe përkushtimi ynë do të jetë ruajtja dhe mbrojtja e kësaj pasurie, në mënyrë që këtë mjedis ta bëjmë edhe më të bukur, duke krijuar dhe siguruar një të ardhme me ambient të pastër dhe të shëndoshë për qytetarët tanë. Vëmendja jonë do të jetë e përqendruar në përmirësimin e jetës së qytetarëve tanë, duke e mbështetur fuqishëm zhvillimin dhe përmirësimin e infrastrukturës në qytet dhe përgjithësisht në Komunë. Komuna e Istogut është në rrugën drejtë suksesit dhe ne dëshirojmë që edhe ju të jeni pjesë e kësaj rruge. Bashkëpunimi ynë me Ju, Qytetarë të nderuar, do të na mundësojë të identifikojmë çështjet për të cilat PLVM-ja angazhohet. Plani Lokal i Veprimit në Mjedis është një dokument pune, i cili pritet të shërbejë si hap i parë i marrjes së investimeve për përmirësimin e mjedisit në Komunën e Istogut për vitet në vijim. Ky dokument do të ju shërbejë të gjithë akterëve vendas dhe të huaj, që të fokusohen në investime në fushën e mjedisit për qytetin, respektivisht Komunën tonë. Unë do të jem i gatshëm, që në çdo kohë, të punojmë së bashku, të merremi me shqetësimet tuaja, me qëllim që qyteti i Istogut dhe Komuna jonë të jenë shembull i mirë i mjedisit. Me këtë rast, dua të falënderoj Sida-n dhe REC-un në Kosovë, për kontributin e vazhduar që kanë dhënë dhe vazhdojnë të japin për qytetin dhe Komunën e Istogut në sferën e ruajtjes dhe mbrojtjes së mjedisit.

*Përzhemërsisht,
z. Haki Rugova
Kryetari i Komunës së Istogut*

Fjalorthi i shkurtesave

OBSH	- Organizata Botërore e Shëndetësisë
OSCE	- Organization for Security and Co-operation in Europe
OJQ	- Organizata Joqeveritare
OB	- Organizata Buxhetore
AER	- Agjensioni Evropian për Rindërtim
AMMK	- Agjensioni i Mbrojtjes së Mjedisit i Kosovës
BB	- Banka Botërore
FMN	- Fondi Monetar Ndërkombëtar
EC	- European Council
BE	- Bashkësia Evropiane
ESK	- Enti i statistikave të Kosovës
USAID	- United State Agency for International Development
MMPH	- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MB	- Ministria e Bujqësisë
MSH	- Ministria e Shëndetësisë
IKSHPK	- Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i Kosovës
REC	- Regional Environmental Center
SHC	- Shoqëria Civile
KEK	- Korporata Energjetike e Kosovës
PVKM	- Plani i Veprimit i Kosovës për Mjedis
SWOT	- Strengths, Weaknesses, Opportunities and Threats
UA	- Udhëzimi Administrativ
PK	- Parlamenti i Kosovës
PLVM	- Plani Lokal i Vlerësimit Mjedisor
DEU	- Direktiva Evropiane e Ujit për Konsum Human
KSK	- Komisioni Sanitar i Komunës
PZHK	- Plani Zhvillimor Komunal
PZHU	- Plani Zhvillimor Urban
CUP	- Cilësia e Ujit të Pijshëm
KKU	- Këshilli Kombëtar i Ujit
KUR	- Kompania Rajonale Ujore
ZRRUM	- Zyra Rregullative e Ujit dhe Mbeturinave

Akterët dhe përgjegjësit e PLVM-së

Ky Projekt është implementuar nga:

Qendra Rajonale e Mjedisit, REC (Regional Environmental Center) - Zyra në Kosovë.

Koordinator i REC për PLVM:

Daut BLAKAJ

Komuna e Istogut

Koordinatore e Komunës për PLVM:

Elfete BLAKAJ

Anëtarët e Trupit Koordinues:

- | | |
|-------------------|---|
| 1. Agim Ademaj, | Nënkryetar i Komunës, kryesues; |
| 2. Demë Çeta, | Kryesues i Kuvendit Komunal, anëtar; |
| 3. Qazim Loxha, | Drejtor i Drejtoratit për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, anëtar; |
| 4. Isa Hoxhaj, | Drejtor i Drejtoratit për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, anëtar; |
| 5. Bedri Hasanaj, | Drejtor i Drejtoratit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtar dhe; |
| 6. Elfete Blakaj, | Përgjegjëse për mjedis, anëtare. |



Personat dhe grupet e ndryshme që janë përfshirë në hartimin e PLVM-së për Komunën e Istogut janë:

- | | |
|------------------------|---|
| 1. Elfete Blakaj, | Përgjegjëse për mjedis, koordinatore; |
| 2. Muhamet Gusturanaj, | Udhëheqës i zyrës për integritime evropiane; |
| 3. Lulzim Blakaj, | Udhëheqës i sektorit administrativ të kuvendit komunal; |
| 4. Sanije Mavraj, | Koordinatore e Njësitit për të drejta të njeriut; |
| 5. Rrustem Gashi, | Përgjegjës për planifikimin rural; |
| 6. Zekije Sutaj, | Këshilltare ligjore; |
| 7. Beqir Metaj, | Udhëheqës i sektorit për bujqësi, pylltari dhe hidroekonomi; |
| 8. Fadil Kabashi, | Inspektor i bujqësisë, pylltarisë dhe hidroekonomisë; |
| 9. Sami Ferati, | Udhëheqës i sektorit të arsimit; |
| 10. Arta Fetahu, | Zyrtare për zhvillim dhe planifikim; |
| 11. Brahim Hetemaj, | Udhëheqës i sektorit të shëndetësisë; |
| 12. Alma Destanoviq, | Udhëheqëse e sektorit për të drejta dhe integritim të komuniteteve dhe; |
| 13. Naser Gjocaj, | Zyrtar për hapësirë publike dhe efikasitet të energjisë. |
| 14. Naim Ferati, | nga kompania e ujësjellësit “Hidrodrini”; |
| 15. Daut Latifaj, | nga kompania “Ambienti”; |
| 16. Luana Hasanaj, | nga OJQ “Liria I”; |
| 17. Zeqir Mehmetaj, | nga Radio “Fontana”; |
| 18. Ismet Rugova, | nga kompania “Ma Con”; |
| 19. Ismail Bytyçi, | nga kompania “Trofta e Re”; |
| 20. Ismet Loshi, | nga kompania “Graniti”; |
| 21. Naim Imeraj, | nga kompania “Sinalco” dhe, |
| 22. Rexhep Shoshi, | nga radhët e ekspertëve bujqësorë. |

Gjithashtu, në hartimin e dokumentit ndihmuan:

- NDËRMARRJET PUBLIKE DHE KOMUNITETI I BIZNESIT PRIVAT;
- NDËRMARRJET PUBLIKE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE;
- KOMPANITË RAJONALE TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE DHE;
- SHOQËRIA CIVILE DHE QYTETARËT

Baza ligjore për hartimin e PLVM-së

 Republika e Kosovës	KUVENDI I KOMUNËS		 Komuna e Istogut
	01 Nr.49/2011	Data: 28.10.2011	

Kuvendi i Komunës, në bazë të nenit 24 alineja 1. Të Ligjit për mbrojtjen e mjedisit, Ligji nr.03/L-025 dhe nenit 17 pika (e) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), në mbledhjen e mbajtur më: 28.10.2011 mori:

V E N D I M

- I. Me qëllim të ruajtjes dhe mbrojtës së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të komunës të hartohet Plani Lokal i Veprimit në Mjedis (PLVMN) .
- II. Plani Lokal i Veprimit në Mjedis do të hartohet nga Grupi punues për hartimin e PLVM-ns dhe i njëjti duhet të përmbaj të gjitha elementet e përcaktuara në Ligjin për mbrojtjen e mjedisit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Trupi Koordinues dhe Grupi Punues për hartimin e PLVM-ns.
- IV. Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Trupi Koordinues, Grupi punues dhe një kopje në arkivin e Kuvendit

Kryetari i Komunes,
 Henda Ceta



Legjislacioni i Republikës së Kosovës në fushën e mbrojtjes te mjedisit harmonizuar me standardet evropiane që është përdorur si referencë për përgatitjen e PLVM-së.

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit (2009/03-L-025)
- Ligji për Mbeturinat (2005/02-L30)
- Ligji për Mbrojtjen e ajrit (2004/30)
- Ligji për Mbrojtjen e bimëve (2006/02-L95)
- Ligji për Mbrojtjen e natyrës (2005/02-L18)
- Ligji për Mbrojtjen e varieteteve të bimëve (2007/02-L98)
- Ligji për Mbrojtjen nga zhurma (2007/02-L102)
- Ligji për Mbrojtjen nga zjarri (2006/02-L41)
- Ligji për Bujqësi dhe zhvillim rural (2009/03-L-98)
- Ligji për Bujqësi organike (2007/02-L122)
- Ligji për Gjuetinë (2005/02-L53)
- Ligji për Plehrat Artificiale (2003/10)
- Ligji për Planifikim Hapësinorë (2003/14)
- Ligji për Pyjet ndryshim (2004/29)
- Ligji për Ujërat (2004/24)
- Ligji për Ujitjen e tokave bujqësore (2005/02-L9)
- Ligji për Vlerësimin e ndikimit në mjedis (2009/03-L-024)
- Ligji për Vetëqeverisje Lokale (2008/03-L040)
- Ligji për Zonat e veçanta të mbrojtura (2008/03-L039)
- Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (2009/03-L-015)
- Udhëzimi administrativ Nr 02/07 për mbeturina nga Bateritë dhe Akumulatorët
- Udhëzimi administrativ Nr 03/07 për administrimin e vajrave të përdorura mbeturinë
- Udhëzimi administrativ për automjete e hedhura dhe mbeturinat e tyre, 20.12. 2006
- Udhëzimi administrativ Nr. 12/2008 për asgjësimin e mbeturinave medicinale
- Udhëzimi administrativ Nr. 05/2008 për administrimin me mbeturinat medicinale
- Udhëzimi administrativ Nr. 05/2009 për administrimin e mbeturinave publike
- Udhëzimi administrativ Nr. 04/2009 për ndëshkime dhe gjoba mandatore
- Planin Kombëtarë për Veprim në Mjedis i Kosovës, 2006-2010

Pjesa 1

I. HYRJE

Planet Lokale të Veprimit në Mjedis (PLVM) janë dokumente të politikës mjedisore vendore, të cilat paraqesin prioritete mjedisore dhe listën e veprimeve për zgjidhjen e tyre. Përgatitja e këtyre planeve zhvillon më tej aftësitë e pushtetit vendor dhe subjekteve të tjera të interesuara për mjedisin dhe komunitetin.

Gjithashtu, PLVM nxit bashkëpunimin midis shoqërisë civile, publikut, pushtetit vendor dhe atij qendror, biznesit dhe subjekteve të tjera mjedisore, duke përkrahur shkëmbimin e lirë të informacionit dhe pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes.

Detyrimet ligjore për hartimin e PLVM-së

Përgatitja e PLVM-së është e detyrueshme për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore që kanë filluar procesin e asocim-stabilizimit dhe që synojnë të integrohen në BE. Për vendin tonë, hartimi i këtyre planeve nga qeverisjet vendore është detyrë ligjore, e përcaktuar në Nenin 24 të Ligji për mbrojtjen e mjedisit Nr.03/L-25

Plani Lokal për Veprim në Mjedis ka për qëllim të:

- Zgjidh problemet mjedisore nëpërmjet identifikimit të prioriteteve dhe përcaktimit të veprimeve për zgjidhjen e tyre, duke përfshirë të gjithë aktorët e mundshëm për përcaktimin e këtyre veprimeve dhe krijimin e strategjive për zbatimin e tyre në mënyrë efektive, të ndërthurura sipas një Plan Veprimi.
- Zhvillojnë shoqërinë civile nëpërmjet forcimit të koordinimit dhe komunikimit ndërmjet sektorëve të ndryshëm në komunitet, duke sjellë së bashku përfaqësues të komuniteteve të ndryshme që përfaqësojnë interesa të ndryshme në këto komunitete, përfshirë autoritetet vendore, përfaqësues të OJQ-ve, biznesin, shkencëtarë, duke shpjeguar teknikat specifike që organizatorët lokalë mund të përdorin për të përcaktuar aktorët kryesorë të procesit, të rrisin pjesëmarrjen dhe kontributin e publikut në proces, për rekrutimin dhe punën me vullnetarët dhe nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet grupeve të interesuara dhe organizatave.

- Rrisin aftësitë e qeverisjes vendore dhe komunitetit për paraqitjen e elementëve thelbësore të planit të veprimit të komunitetit, duke vlerësuar problemet dhe mundësitë komunitare, duke organizuar komitete qytetare, duke përfshirë publikun, përcaktimin e prioriteteve, hartimin e strategjive dhe zhvillimin e një Plan Veprimi.
- Rrisin shkëmbimin e informacionit në nivel lokal nëpërmjet sjelljes së shembujve dhe modeleve nga plane të mëparshëm të komuniteteve nga të cilat pjesëmarrësit mund të nxjerrin ide dhe teknika të zbatueshme në rastet konkrete të tyre, të mbledhin me kujdes informacion mbi gjendjen e tanishme të mjedisit.
- Japin zgjidhje konkrete për problemet e komunitetit me anë të shkëmbimit të përvojave lidhur me përdorimin e aftësive në analiza, planifikime, debate dhe vlerësime që janë thelbësore për një veprim të komunitetit efektiv. Duke u dhënë pjesëmarrësve mundësinë për të vënë në praktikë punën në grupe, duke u marrë me zgjidhjen e problemeve praktike nëpërmjet ndërveprimit të grupeve të vogla të punës.

Metodologjia e përgatitjes së PLVM-së

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për Komunën e Istogut u hartua përgjatë një periudhe njëvjeçare dhe në hartimin e tij, janë përfshirë akterë të pushtetit vendorë dhe komuniteti i gjerë. Për këtë u ngrit një grup pune me specialistë të fushave të ndryshme (ambientalizëm, arkitekturë, turizëm, shëndetësi, arsim, sport, trashëgimi kulturore, etj.), të cilët punuan në bashkëpunim me ekspertë tjerë vendor dhe ndërkombëtarë për hartimin e PLVM.

Së pari, është bërë trajnimi i grupit punues të cilët u ftuan në projekt në aspektet e hartimit të PLVM-së dhe gjetjes së mjeteve shtesë për realizimin e aktiviteteve për përmirësimin e cilësisë mjedisore.

Në kuadër të projekti për hartimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis (PLVM), është bërë një anketim i qytetarëve të Komunës së Istogut. Ka qenë një numër i konsiderueshëm i pyetësorëve, të cilët kanë ndihmuar dhe orientuar grupin punues në mënyrë më të drejtë në zgjedhjen e fushave prioritare. Një falënderim për këtë i takon qytetarëve të Komunës së Istogut dhe shoqërisë civile, e cila në procesin e anketimit të respondentëve ka ndihmuar që procesi i anketimit të jetë i suksesshëm. Për të pasur një përfshirje sa më të gjerë dhe për të marrë mendimet e komunitetit dhe shoqërisë civile, janë organizuar edhe debate publike dhe debate në media.

Dokumenti i është paraqitur Kuvendit Komunal të Istogut dhe është miratuar prej tij më 28.05.2012, duke e kthyer atë në një dokument zyrtar pune.

Procesi themelor i hartimit të PLVM-së ndahet në faza, të cilat lidhen njëra pas tjetrës:

- a) Nënshkrimi i marrëveshjeve dhe memorandumëve REC – Komunë;
- b) Aktivitetet përgatitore;
- c) Formimi i trupit koordinues TK;
- d) Formimi i grupit punues GP;
- e) Trajnimi i GP
- f) Vlerësimi i gjendjes së mjedisit;
- g) Anketimi i qytetarëve;
- h) Hartimi i vizionit të komunitetit;
- i) Caktimi i prioriteteve;
- j) Hartimi i planit të veprimit për fushat prioritare dhe;
- k) Caktimi i prioriteteve në realizimin e planit të veprimit.

Dokumenti është i hartuar mbi tri baza kryesore:

1. Analiza e gjendjes mjedisore

Paraqet një analizim të hollësishëm të situatës për të gjitha çështjet e marra në konsideratë nga plani, duke e paraqitur atë në të gjitha aspektet e tij dhe të ndërlidhura ndërmjet tyre. Kjo analizë shërben për të pasur një ide më të qartë të problemeve mjedisore, të cilat shqetësojnë Komunën e Fushë-Kosovës.

2. Lista e problemeve mjedisore

Problemet mjedisore paraqiten sipas një matrice të paracaktuar, e cila jep në mënyrë të detajuar të gjithë treguesit për identifikimin e një problemi. Pjesët më të rëndësishme të kësaj matrice janë shkaktarët e problemit dhe prioriteti për secilin.

3. Plani i veprimeve për zgjidhje

Ky kapitull është pjesa më e rëndësishme e Planit, pasi paraqet të gjitha veprimet dhe projektet e mundshme për zgjidhjen e problemeve mjedisore të përcaktuara.

Kjo matricë u shërben autoriteteve vendore për të hartuar projektet konkrete dhe për sigurimin e fondeve nga donatorët.

VIZIONI

*“Istogu i gjelbëruar dhe i pastër,
me vlera të trashëgimisë natyrore e
kulturore, me turizëm e bujqësi të
zhvilluar, tërheqës për të gjithë”.*

Vizioni për të ardhmen e Komunës së Istogut është vazhdimësi e qëllimeve të definuar me Planin Hapësinor të Kosovës, ku territori i Istogut i takon “Kopshteve të Kosovës”.

Bazuar në potencialet dhe resurset natyrore të Komunës, vizioni është ndërtuar në tri shtylla kryesore të zhvillimit, të ndërlidhura njëra me tjetrën: Agrikultura, Turizmi dhe Ndërmarrjet.

Istogu llogaritet si vend potencialit dhe traditës bujqësore, blegtorale, akuakulturës, bletarisë dhe e një pylltarie të zhvilluar. Rajon me ndërmarrje të zhvilluara të qëndrueshme, konkurruese në tregun vendor dhe jashtë tij, si bizneset e vogla të orientuara kryesisht kah potencialet ekzistuese të zhvillimit, si plantazhet e mollës, hurdhata e peshkut, përpunimi i drurit, industria e lehtë etj.

Për të realizuar këtë është e nevojshme që zhvillimi ekonomik në përgjithësi dhe e turizmit në veçanti, të bëhet duke transformuar Istogun në vend qetë për investitorë dhe turistë vendorë dhe të huajë. Përmirësimi i mjedisit, ruajtja dhe ngritja e resurseve dhe vlerave natyrore dhe ofrimi i kushteve për një zhvillim të qëndrueshëm për nevojat e komunitetit dhe qytetarëve në tërësi. Pas-taj, ruajtja, mbrojtja dhe rehabilitimi i monumenteve të trashëgimisë kulturore dhe historike, si dhe rritja e atraksionit për investitorët e jashtëm dhe të brendshëm përmes përgatitjes së ofertës lokale zhvillimore.

Pjesa 2

INFORMATA TË PËRGJITHSHME PËR ISTOGUN

2.1 Historiku

Komuna e Istogut shtrihet në pjesën veriore të rrafshit të Dukagjinit. Komuna, në veri-perëndim kufizohet me Malin e Zi dhe Serbinë, në veri-lindje me komunën e Zubin Potokut, në lindje me Komunën e Skenderajt, në jug me Komunën e Klinës dhe në jug-perëndim me Komunën e Pejës. Ka sipërfaqe prej 453.84 km². Qendër komunale është qyteti - Istog.

Istogu ka një pozitë të përshtatshme gjeografike, e hapur në të gjitha anët, më përjashtim të pjesës veriore e cila është e rrethuar më male të larta më lartësi mbidetare përtej 2.000 metrave. Më një infrastrukturë të mirë rrugore, që i mundëson komunikim të mirë më trevat e tjera të Kosovës.



Foto 2. Istogu i viteve 1930



Foto 3. Istogu sot (2012)

Ky territor, në aspektin gjeografik dhe etno-kulturor, njihet si Podgur. Si nocion, Podguri është një nën-krahinë etnografike që zë pozitën veriore të Rrafshit të Dukagjinit. Kufizimi gjeografik i Podgurit fillon me burimin e lumit “Drini i Bardhë”, ngjitet në majën e Rusolisë, vazhdon me masivin e maleve të Moknës, ndërsa kufiri lindor e juglindor është lumi “Gujavç”. Takimi i lumit “Gujavç”, me lumin “Istogu” dhe me “Drinin e Bardhë” e përmbyll gjeografikisht Trevën e Podgurit. Popullata autoktone e ka emërtuar “Pod i gurit” shkëmbin i cili i detyron tri burimet e ujit Istogun, “Vrellën” dhe “Drinin e Bardhë” të shpërthejnë në të njëjtën lartësi mbidetare. Istogu gjendet në qendër të Podgurit.

Pozita gjeografike, klima, pasurit natyrore, kanë kushtëzuar që Istogu të jetë i banuar që nga lashtësia. Ai ishte pjesë integrale e hapësirës iliro-shqiptare. Në territorin e Komunës së Istogut janë gjetur gjurmë vendbanimesh që datojnë edhe nga parahistoria. Istogu është i pasur po ashtu më vlera emblematike të trashëgimisë së kulturës materiale dhe shpirtërore.

Sipas burimeve historike, thuhet se Istogu është shtrirë në pjesën e territorit në mes të Istogut të madh dhe të Istogut të vogël, aty ku bashkohet lumi i “Istogut” me lumin e “Qaushit”.

Sipas shënimeve ka ekzistuar një koloni romake e cila ka qenë e vendosur në lokacionin që i përket Istogut të sotëm. Po ashtu, Istogu përmendet si lokacion edhe ka fundi i shekullit XIV, kur kjo pjesë e Dardanisë ishte nën pushtimin sllav.



Foto 4. Lagje e vjetër e Istogut



Foto 5. Lagja e re e Istogut

Gjatë kohës së sundimit turk, Istogu si vendbanim ka qenë i njohur me mullinj të përbluarjen e drithit dhe të punëtorëve për përpunimin e leshit (zhgunit). Gjatë kohës së sundimit të Turqisë, kazaja (Komuna) e Istogut i ka takuar Sanxhakut të Pejës, sikurse edhe kazatë e Gjakovës, Beranës (Ivangradi) dhe Gucisë.

Rrethi i Istogut në kuptimin e sotëm administrativ është formuar më 1913, pas pushtimit të Kosovës nga ana e ushtrive serbo-malazeze. Istogu si qendër e rrethit ka funksionuar prej vitit 1912 deri në vitin 1947. Më 1947 qendra u transferua në Gjurakoc. Më 1 janar të vitit 1960, u bë edhe një riorganizim i organeve lokale të pushtetit, kështu që në tërë territorin e Kosovës u suprimuan të gjitha rrethet. Pas suprimimit, u bashkuan Komunitat Istog e Gjurakoc, me qendër në Istog për të formuar njësinë e administrimit lokal, ashtu si funksionon edhe sot. Me shtimin e përmbytjeve administrative, arsimore e kulturore, Istogu në dhjetor 1978 shpallet qytet.

2.2 Popullsia

Sa i përket popullsisë, burimeve njerëzore dhe tregut të punës, janë me rëndësi të veçantë të bëhen analiza socio-ekonomike, meqenëse në të shumtën e rasteve të dhënat ekzistuese origjinale dhe statistikore janë të pamjaftueshme, për shkak se nuk ofrojnë informata të sakta sa i përket numrit të banorëve se ku jetojnë, vendit ku jetojnë jashtë Komunës së Istogut, dhe nuk ofrojnë të dhëna se sa banorë të komunave të tjera punojnë në Komunën e Istogut.

Tani nga regjistrimi i fundit i popullsisë, pas rezultateve përfundimtare në shumicën e fushave të cekura, mund të kemi të dhëna më të sakta. Por, kjo nuk nënkupton që të dhënat ekzistuese janë totalisht të pashfrytëzueshme.

Sipas rezultateve preliminare të regjistrimit të fundit të popullsisë, Komuna e Istogut ka 39,294 banorë. Nga ky numër të gjinisë mashkullore janë evidentuar 19.987, kurse të gjinisë femërore janë evidentuar 19.307 banore.

Të dhënat mbi popullsinë dhe statistikat e punësimit në Komunën e Istogut nga regjistrimi i fundit prill, 2011, duken kështu:

Tabela 1. Numri i popullsisë dhe statistikat e punësimit

Komuna	Numri i përgjithshëm i popullsisë	Meshkuj	Femra	Dendësia e banorëve/ km ²	Të punësuar	Fuqia punëtore	Të punësuar sektori publik
Istog	39.294	19.987	19.307	86.5	9.938	25.921	2.095

Përveç të dhënave në tabelë, janë edhe rreth 15.000 banorë jo rezident që punojnë jashtë Kosovës.

Nga komunitetet që jetojnë në Komunën e Istogut:

- 90.9 % janë shqiptarë;
- 4.3 % RAE;
- 3.2 % boshnjakë dhe;
- 1.6 % të tjerë.

2.3 Barazia gjinore

Barazia gjinore është një gur themeltar në procesin e zhvillimit demokratik të një kombi. Për të vendosur këtë gur atje ku duhet është e nevojshme të merren në konsideratë të gjitha pabarazitë gjinore që karakterizojnë sot familjen, komunitetin, tregun e punës dhe në përgjithësi shoqërinë.

Transformimi i thellë politik, social dhe ekonomik pas vitit '99, solli ndryshime të dukshme në strukturën e ekonomisë, nivelin e jetesës së popullatës, si dhe ekuilibrit gjinor në shoqërinë e Kosovës. Mirëpo, përkundër këtyre ndryshimeve, kjo nuk ka ndikuar në masë të madhe në përmirësimin e gjendjes së pozitës së grave në shoqëri. Nga pikëpamja demografike, gratë në Kosovë përbëjnë gjysmën e popullsisë. Deri në fund të viteve të '80-ta dominonte familja patriarkale, ku 2-3 breza jetonin në një familje. Mirëpo, pas viteve '90-ta nga emigrimi që u bë jashtë Kosove dhe migrimi i popullatës nga zonat rurale drejt zonave urbane, përshpejtuan shpërbërjen e familjes patriarkale.

Me gjithë përmirësimet në vitet e mëvonshme, papunësia dhe varfëria kërcënojnë një numër jo të vogël familjesh në Kosovë, por në mënyrë të veçantë papunësia dhe varfëria po ndikojnë negativisht në statusin social të grave.

Tradicionalisht gratë kanë barrën kryesore të mirëqenies në familje, megjithatë ato kanë më pak mundësi se burrat në përdorimin e burimeve dhe mjeteve që nevojiten për përmbushjen e përgjegjësisë të tyre. Niveli i lartë i papunësisë, niveli ulët arsimor, angazhimi i grave në punë të pakualifikuara, mungesa e mundësive kualifikuese, qasja e dobët dhe mungesa e lirisë së përdorimit të metodave të planifikimit familjar, pastaj fakti që shumë shpesh gratë janë objekt i dhunës, i keqtrajtimit dhe veprimeve arbitrare në familje, si dhe përfaqësimi i dobët në strukturat publike drejtuese dhe politike, po ndikojnë në thellimin e varfërisë në Kosovë dhe në zgjatjen e saj.



Foto 6. Vizitë muzeut komunal



Foto7. Ekspozitë e Veshjes së Podgorit

2.3.1 Shkaqet që prodhojnë varfëri dhe diskriminim gjinor

- Dominimi i normave patriarkale;
- Vështirësitë në zbatimin e Ligjit vonojnë barazinë gjinore;
- Niveli i ulët arsimor i grave;
- Qasja e kufizuar në formimin profesional dhe pronësi;
- Niveli i ulët i punësimit;
- Përjashtimi i grave nga vendimmarrja për shkak të normave sociale;
- Pabarazia në vendimmarrje dhe në përfaqësimin në strukturat e larta shtetërore;
- Dhuna në familje;
- Pabarazia në kulturë dhe në media dhe;
- Përfaqësimi i dobët i gruas në fushën akademike.

2.3.2 Mekanizmi për arritjen e barazisë gjinore

Për tejkalimin e kësaj gjendjeje të pozitës së gruas dhe rolit të sajë në shoqëri, në Kosovë janë krijuar një varg mekanizmesh institucionale dhe instrumente ligjore që synojnë avancimin e pozitës së gruas në shoqërinë kosovare. Në këtë kontekst, roli i shoqërisë civile është shumë i rëndësishëm, posaçërisht i OJQ-ve vendore, që avokojnë në sensibilizimin e opinionit lidhur me avancimin e pozitës gruas.

Mekanizmat në nivelin qendror:

- Agjencia për barazi gjinore;
- Zyra për qeverisje të mirë;
- Institucioni i Ombudspersonit-Njësia për Barazi Gjinore dhe;
- Këshilli ndërministror për Barazi Gjinore.

Mekanizmat në nivel lokal:

- Zyrtarët për barazi gjinore në komuna dhe;
- Komitetet komunale për barazi gjinore.

Në komunën e Istogut, Zyra për barazi gjinore, kryen një sërë aktiviteteve që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe promovimin e barazisë gjinore, si: Monitorim dhe lobim në institucione për respektimin e mundësisë së barabartë në punë, në pranime dhe komisione të ndryshme si administratë, arsim dhe shëndetësi. Pastaj, angazhim direkt për ndihmë financiare për gratë mbajtëse të familjes në sferën e akordimit të bursave për studentë të këtyre familjeve, ndihma mjekësore dhe ushqim në vazhdimësi. Krahas kësaj, organizojnë aktivitete dhe Tryeza që kanë për temë mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, si dhe promovojnë të drejtat e grave përmes botimit të fletushkave, palosjeve, që kanë si temë mbrojtjen e grave dhe fëmijëve.

Struktura gjinore e të punësuarve në Komunën e Istogut: Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve në administratën komunale 157 sish, të gjinisë mashkullore janë 118, kurse të gjinisë femërore janë 39. Në arsim, nga 689 të punësuar, 360 janë të gjinisë mashkullore dhe 289 të gjinisë femërore, ndërsa në shëndetësi, nga 123 gjithsejtë të punësuar, të gjinisë mashkullore janë 32, kurse të gjinisë femërore 91 sosh. Nga kjo skemë del së punësimi i femrës në Komunën e Istogut është mjaftë i avancuar e që përfshinë rreth 40 % e të punësuarve.

Tabela 2. Struktura gjinore e të punësuarve

Komuna e Istogut	Të punësuar në administratë	Të punësuar në arsim	Të punësuar në shëndetësi
Gjithsejtë	157	649	123
Meshkuj	118	360	32
Femra	39	289	91

Mirëpo, përkundër themelimit të një sërë mekanizmave që synojnë përmirësimin e pozitës së gruas në shoqërinë kosovare, këto mekanizma ende nuk kanë arritur efektin e duhur. Andaj, për këtë qëllim shoqëria kosovare duhet orientuar në zhvillimin e një sërë objektivash:

- Përhapja e vlerave dhe praktikave që promovojnë barazinë gjinore, mbrojtjen e të drejtave dhe fuqizimin e gruas;
- Rritja e qasjes së grave dhe vajzave në arsim cilësorë;
- Përmirësimi i shëndetit të vajzave dhe grave duke rritur përgjigjen e sistemit shëndetësor ndaj nevojave të tyre shëndetësore;
- Fuqizimi ekonomik;
- Përmirësimi i situatës së grave në rrezik;
- Përmirësimi i treguesve të punës për gratë dhe vajzat;
- Përmirësimi i imazhit të grave në media, kulturë dhe sport, dhe;
- Të arrihet pjesëmarrja e barabartë e të dyja gjinive në vendimmarrje për të gjitha çështjet e rëndësishme në shoqëri.

2.4 Punësimi dhe papunësia

Shkalla e punësimit në Komunën e Istogut është mjaftë e ulët, duke marrë për bazë numrin e popullsisë aktive për punë. Po ashtu, ka mungesë të shkathtësive në punë, sidomos të shkathtësive praktike në zgjidhjen e problemeve. Shumica e të punësuarve në kompanitë private edhe pse me përvojë, nuk janë formalisht të certifikuar. Ofrimi i trajnimeve profesionale (formale) për të punësuarit e sektorit privat është i mangët.

Numri i të punësuarve në sektorin publik është 2095, ndërsa në sektorin privat llogaritet përafërsisht se janë të punësuar 2493 punëtorë, në sektorin jo formal 1150 punëtorë, ndërsa në bujqësi llogaritet përafërsisht 4200 persona që krijojnë të ardhura nga kjo lëmi. Sipas shënimeve të zyrës komunale të punësimit të evidentuar, si të pa punë janë 5954 persona, prej tyre 3668 meshkuj, ndërsa 2286 femra.

Realisht numri i të papunëve është disa herë më i madh se numri i të evidentuarve në zyrën komunale të punësimit. Duke marrë parasysh numrin e popullsisë aktive (25.921) dhe numrin e përgjithshëm të punësuarve (9.938), del se shkalla e punësimit në Komunën e Istogut është 36 %. Ndërsa, shkalla e papunësisë llogaritet në 64 %, shkallë e cila është mjaftë e lartë. Të dhënat nga hulumtimi tregojnë se afër 25 % të popullsisë që jetojnë në qytet, janë të punësuar. Prej të tjerëve, 13 % jetojnë me ndihma sociale, ndërsa një pjesë e popullatës burimin e të ardhurave e kanë nga pensioni (nga buxheti i Kosovës), rreth 38 %, kurse pjesa tjetër nga ndihmat që u sjellin familjarët dhe të afërmit që kanë punësuar në botën e jashtme. Të punësuarit në administratën komunale janë 157 punëtorë, e ku prej tyre 118 janë meshkuj e 39 femra.

MJEDISI SOCIAL DHE EKONOMIK

2.5 Mirëqenia sociale

Për shkak të papunësisë së madhe që mbretëron në Komunën e Istogut, si dhe pasojave të luftës së fundit, që ende nuk janë sanuar sa duhet, në Komunën e Istogut është i madh numri i rasteve sociale dhe të pastrehëve që kërkojnë ndihma.

Sipas statistikave numri i rasteve të përfshira në skemën e asistencës sociale në Komunën e Istogut është 765 familje me 3.437 anëtarë. Janë edhe 20 kërkesa që janë paraqitur për tu futur në këtë listë të asistencës sociale.

Numri i familjeve të vendosura në strehimore kolektive në Komunë e Istogut është 12 sosh. Kurse, numri i kërkesave për strehim të rasteve sociale dhe njerëzve në nevojë është 25 sosh.

2.6 Shëndetësia

Në Komunë e Istogut kryhen shërbime primare dhe sekondare mjekësore. Këto shërbime qytetarët e Komunës së Istogut i kryejnë në pesë (5) Qendra të Mjekësisë Familjare dhe në dhjetë (10) Ambulanca në fshatra. Kurse, shërbimet sekondare banorët e Istogut e shfrytëzojnë Spitalin rajonal në Pejë dhe në ambulanca private. Në qytetin e Istogut funksionon QKMF, kurse në fshatrat Vrellë, Banjë, Gurrakoc, Rakosh funksionojnë QMF-re. Shërbimet mjekësore, banorët e Komunës së Istogut i kryejnë edhe në Ambulancat e fshatrave, në; Kaliqan, Sudenicë, Dobrushë, Saradran, Zallq, Dubravë, Cerkolez, Shushicë, Veriq dhe Osojan.

Në QKMF janë këto shërbime: Shërbimi i Emergjencës, Shërbimi i Mjekësisë Familjare, Shërbimi i Internistikës, Shërbimi i Vaksinimit, Shërbimi i Maternitetit, Shërbimi i Stomatologjisë, Shërbimi i Pediatriisë, Shërbimi i Rëntgenologjisë, Shërbimi i Laboratorit.

Në QMF kryhen Shërbimet e Mjekësisë Familjare dhe shërbimet Stomatologjike, ndërsa në ambulanca vetëm shërbimet e mjekësisë Familjare.

Struktura e të punësuarve sipas Profesionit në shëndetësi është: Mjekë (26), Teknik-e Medicinale (63), Staf Administrativ (8), Staf ndihmës-teknik (26). Gjithsejtë në mjekësi janë të punësuar 123 punëtorë. Nga numri i përgjithshëm i Punësuar në Objektet Shëndetësore 35 punëtorë janë të gjinisë mashkullore, ndërsa 88 janë të gjinisë femërore.

2.7 Arsimi

Komuna, përmes Drejtorisë për Arsim dhe Kulturë, kryen detyrat dhe obligimet e veta në përputhje me ligjet dhe rregullat e MASHT-it dhe në pajtim me Ligjin për Arsim në Komunat e Republikës së Kosovës, Statutit e Rregulloreve Komunale që përcaktojnë përgjegjësit ndaj procesit edukativo-arsimor të gjitha niveleve. Kjo Drejtori angazhohet, organizon edhe menaxhon aktivitete kulturore, rinore dhe sportive. Kryen edhe punë e detyra ndër zyrtare të parapara me statusin dhe rregullat e organizimit brenda dhe jashtë Komunës.

Në fushën e Arsimit, kjo Drejtori mbulon organizimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve edukativo-arsimore që nga: Niveli parashkollor 235 fëmijë (15 grupe); Shkollimi special i nxënësve me aftësi të kufizuara me 18 fëmijë (2 paralele); Niveli i arsimit të obliguar që përfshinë nxënësit nga klasa e I-rë deri në klasën e IX-të, 7251 (308 paralele); Niveli i mesëm i lartë: 2237 nxënës (70 paralele). Numri i përgjithshëm i nxënësve është 9.772 nxënës, plus paralelet special me 20 nxënës. Numri i të punësuarve në arsim është 654 veta, ku prej tyre 518 janë mësimitdhënës, 31 personel administrativë dhe 105 personel teknik-ndihmës.

Numri i institucioneve shkollore në Komunën e Istogut: 5 kopshte të fëmijëve, 11 shkolla amë nëntëvjeçare, 15 paralele të ndara për shkollim fillor, 2 shkolla të mesme të larta dhe një paralele e ndarë e SHMT-profesionale “Rudina” B. i Dubravës.

Është vlerësim i përgjithshëm se në aspektin organizativ, arsimit i Komunës së Istogut është mirë i organizuar dhe i mbikëqyrur.

Në kuadër të Drejtoratit të Arsimit në Komunën e Istogut funksionon edhe sektori për Kulturë, Rini dhe Sport, i cili kryen një varg aktivitete, në organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve të ndryshme kulturore dhe sportive.

Istogu ka një Shtëpi të Kulturës, një Qendër Kulturore e tri biblioteka, ku qytetarët e Istogut i organizojnë një sërë aktivitete kulturore. Sa i përket sportit, në Istog janë 5 klube sportive, dy qendra rinore, dy objekte për aktivitete rinore në zonat komunale dhe një objekt sportiv.



Foto 8. Gjimnazi “Haxhi Zeka” në Istog



Foto 9. Nxënës duke shkuar në shkollë

2.8 Sipërfaqja, dendësia e banimit

Komuna e Istogut sot ka sipërfaqe prej 453.84 km², kjo paraqet 4.17 % të sipërfaqes së Kosovës. Njësia kadastrale e Istogut (qytetit) ka sipërfaqe 3113.15 ha (31.13 km²) dhe ka pozitë qendrore në territorin e Komunës. Kjo njësi kadastrale, shtrihet prej kufirit me Serbi në veri, përfshin masivin malor dhe territorin e dy vendbanimeve, Istog dhe Istog i poshtëm, kufizohet me 5 njësi të tjera kadastrale, Syne, Dubravë, Dragolec, Muzhevinë dhe Cerrcë. Istogu ka 2,9 km vijë kufitare me Serbinë, 15.5 kufi të bashkësisë lokale dhe 12.5 km kufi me njësi të tjera kadastrale.

Komuna ka 52 vendbanime, prej të cilave një (1) është qyteti-Istogu, ndërsa si qendra urbane janë: Gjurakoci, Banja, Rakoshi, Vrella. Ndërsa, vendbanime të tjera janë: Bajica, Llukavci i Begut, Belica, Bollopoja, Veriqi, Orroberda, Dobrusha, Istogu i Poshtëm, Dragolevci, Dreja, Dubrava, Zhakova, Zallçi, Zabllaqi, Kalijani, Kashica, Kovraga, Koshi, Kërnina, Llugat, Lubova, Lubozhda,

Dubova e Vogël, Mojstiri, Muzhevina, Veriqi i Ri, Osojani, Polana, Prekalla, Prigoda, Rakoshi, Syneja, Serbobrani, Cërkolezi, Sudenica, Llukavci i Thatë, Syrigona, Shushica, Tomoci, Trubuhoci, Tuqepi, Uça, Corolluka, Cërrca dhe Shalinovica. Këto vendbanime janë grupuar në 10 bashkësi lokale. Bashkësitë lokale korrespondojnë me vendbanimet më të mëdha (Istog, Vrellë, Bajë, Rakosh, Gjurakoc, Dubravë, Dobrushë, Zallq, Crkolez dhe Osojan).

Për ta gjetur numrin ekzistues të banorëve në nivel të qytetit, është bërë hulumtim me pyetësorë në çdo shtëpi, nga i cili hulumtim del se numri i banorëve në qytet është 6000, numri i amvisërive është 1200, ndërsa numri mesatarë i anëtarëve në familje është 5.0 a/familje.

Dendësia e banimit në Komunë është 91 b/km². Dendësia e banimit në raport me njësinë kadas-trale është më e madhe në pjesën e rrafshit të Komunës. Por, kjo e dhënë nuk është domosdoshmërisht dendësia e banimit brenda kufijve të zonës urbane, pasi që nuk ka kufij të njohur të zonës urbane. Sipërfaqja e ndërtuar sot, është llogaritur si zonë urbane, që është 222 ha, nga e cila rrjedh se dendësia e banimit në sipërfaqen e ndërtuar zonën urbane është 27 b/ha/.

2.9 Infrastruktura rrugore

Istogu ka lidhje të mira me qendrat rajonale në Kosovë, po ashtu edhe me qytete të rëndësishme në shtetet fqinje. Rruga kryesore Mitrovicë-Pejë kalon në territor të Komunës dhe disa rrugë e lidhin Komunën me Prishtinën e Klinën.

Masivet malore në pjesën veriore të Komunës i vështirësojnë lidhjet rrugore të Komunës me Malin e Zi, Serbinë dhe Komunën e Zubin Potokut. Megjithatë, lidhje të mira me Rozhajën, Malin e Zi, realizohen përmes rrugëve Istog-Pejë-Rozhajë dhe Istog-Radac-Rozhajë. Ndërsa, përmes rrugës Istog-Rakosh-Cërkolez, komunikimi me pjesën veriorë të Kosovës, si Zubin Potokun, është mjaft e vështirë, për shkak të rrugës së dobët që lidhë këto lokalitete.

Rrugët lokale në Istog sigurojnë lidhje të mira në mes qendrave të bashkësive lokale dhe kanë qasje kryesisht të mirë të gjitha vendbanimeve në rrjetin rrugor - komunal.

Bazuar në funksionin e tyre në hapësirën e Komunës, duke pasur parasysh lidhjen mes qendrave të bashkësive lokale, lidhjen e vendbanimeve dhe lidhjen me vendbanimet e komunave fqinje, është bërë kategorizimi i rrugëve lokale.

Tabela 3. Infrastruktura rrugore në Komunën e Istogut

Gjatësia e infrastrukturës së transportit	km
Autostradë	0.0
Rrugë lokale	176
Rrugë urbane	22
Gjatësia e infrastrukturës hekurudhore	0.0

Në këtë mes duhet theksuar se nga gjithsejtë 22 km rrugë urbane, të asfaltuara janë 16 km, kurse nga 176 km rrugë lokale, të asfaltuara janë 81 km. Rrugët regionale që gravitojnë nëpër Komunën e Istogut të asfaltuara janë tërësisht 65 km.

Totali i rrugëve që janë përfshirë në planin komunal për mirëmbajtje dimërore është 117 km. Në Komunën e Istogut sa i përket infrastrukturës rrugore rëndësi i është kushtuar edhe trotuareve dhe parkingjeve.

Gjatësia e trotuareve të shtruara në asfalt, beton apo kupëza është 30 km, kurse të parregulluara janë 15 km trotuare. Në planin komunal për mirëmbajtjen e trotuareve, si larjen dhe pastrimin e tyre verës dhe dimrit janë të përfshira 10 km. Numri i vendeve për qasje të personave me aftësi të kufizuara në trotuare është 12.

2.10 Transporti publik

Nga 52 fshatra sa ka Komuna e Istogut përfshirja e qytetarëve në transportin publik është e mirë, përkatësisht 47 fshatra janë të përfshira në këtë lloj transporti. Kështu që numri i vendndalimeve të autobusëve të transportit publik është 120, kurse i vendndalimeve të autobusëve të pajisura me shenjizim është 78, ndërsa numri i vend parkingjeve në rrugë dhe jashtë rrugëve është 12.

Lokacione të destinuara për parkim 2 sosh, numri i parkingjeve për persona me aftësi të kufizuar është 2 dhe numri i vend parkingjeve të rezervuara për taksi janë 7 sosh.

2.11 Rrjeti elektrik

Në aspektin e mirëmbajtjes së rrjetit, si dhe furnizimin e konsumatorëve me energji elektrike, i tërë konsumi elektrik i Istogut, në nivelin shpërndarës, menaxhohet dhe eksploatohet nga Distrikti i Pejës. Në aspektin e planifikimit të zgjerimit të rrjetit shpërndarës kjo njësi disponon vetëm me shënimet nga terreni. Po ashtu, implementimin e projekteve të reja, kjo njësi punuese vetëm e garanton nga aspekti i sigurisë elektrike, si dhe merr pjesë në komisionet teknike të objekteve të reja për nivelin shpërndarës.

Zona e Istogut furnizohet nga trafostacioni TS Istogu 110/10 kV/kV, me fuqi instaluese 1x 31,5 MVA. Ky trafostacion furnizohet përmes linjave të nivelit 110 kV, nga drejtimi i TS Vallaqit përmes linjës nr. 126/4, dhe nga drejtimi i TS Peja I përmes linjës nr. 126/3. Të dy linjat janë të seksionit 150mm². Përkundër faktit se linjat në fjalë janë ndër më të vjetrat në Kosovë, mirëmbajtja e tyre ka bërë që të mos vjen në pyetje furnizimi kontinuel i TS Istogut. Vlen të potencohet se këtu furnizimi përcillet me parametra nën vlerat e lejuara teknike, si pasojë e rënieve të mëdha të tensionit. Ndërtimi i trafostacionit të ri në fshatin Veriq ka krijuar linjat e reja nga Istogu për Pejë, Klinë dhe Skenderaj në nivelin 110 kV, si dhe lidhja me trafostacionin Peja III. Me këto projekte, definitivisht, furnizimi i Istogut do të sigurohet në shkallën më të lartë të furnizimit me rrymë.

Ndriçimi publik në Komunën e Istogut është i vendosur qytetin e Istogut, përkatësisht vetëm në rrugët kryesore, si dhe në rrugët kryesore në Qendrat urbane, në Vrellë, Gurrakoc dhe në Banjë.

Nga 22 km rrugë në zonat urbane, gjatësia totale me ndriçim publik është 12,5 km, kurse nga 81 km rrugë rurale me ndriçim publik mbulohen vetëm 2 kilometra, çka do të thotë se në Komunën e Istogut në rrjetin e ndriçimit publik janë të përfshira një (1) për qind e gjatësisë së rrugëve të Komunës së Istogut.

Pjesa 3

III. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese

3.1 Pozita gjeografike

Istogu është një Komunë, afër bjeshkëve të Mognës, që shtrihet në pjesën veri-perëndimore të Kosovës dhe në pjesën veriore të Dukagjinit, me lartësi mbidetare gjer në 2 155 m. Istogu ka sipërfaqe prej 453.84 km².

Në lindje kufizohet me Komunën e Skenderajt, në jug me Komunën e Klinës, në jug-perëndim dhe perëndim me Komunën e Pejës. Në veri me Malin e Zi dhe Serbinë, si dhe në veri-lindje kufizohet me Komunën e Zubin Potokut.

Komuna e Istogut ka një pozitë të përshtatshme gjeografike dhe është e hapur në të gjitha anët, me përjashtim të pjesës veriore, e cila është e rrethuar me male të larta, Bjeshkë të thata dhe Mokna me një lartësi mbidetare gjer në 2155 m, dhe është e lidhur me rrugë të asfaltuara me të gjitha komunat e Kosovës.

Zona e FUSHËS mbulon afërsisht 44 % të territorit, ku shtrihen numri më i madh i vendbanimeve, e banuar me rreth 62 % të numrit të tërësishëm të banorëve të Komunës së Istogut. Kjo pjesë e Komunës është kryesisht rrafshinore me lartësi mbidetare 400 – 500 m. Është e rrethuar me peizazhe të bukura kodrinore të Rrëzës, ngjyra tërheqëse të gjelbërimit dhe prapavijë kodrinore, si element identifikues i Komunës. Në kuadër të kësaj zone shtrihen dy subqendrat, Gurakoci dhe Banja, që i ofrojnë kësaj zone shërbime të mira dhe ndikojnë në zhvillimin social dhe ekonomik të qendrave dhe vendbanimeve të tjera. Në këtë zonë kryqëzohen dy rrugët regjionale, rruga Mitrovicë-Pejë dhe Prishtinë-Istog.

Zona e emëruar “Rrëza” përfshinë vendbanime që shtrihen ndërmjet zonës rrafshinore “Fushës” dhe zonës kodrinore “Bjeshkës”, si dhe paraqet “kufirin” ndërmjet rrafshit dhe kodrës. Ka një shtrirje vijore, me lartësi mbidetare prej 500 deri 650 m. Kjo zonë përfshinë 17 % të sipërfaqes së tërësishme të Komunës. Përgjatë tërë territorit kjo zonë përshkohet nga rruga regjionale Mitrovicë-Pejë-Mali i Zi.

Zona “Bjeshka” përfshinë zonën veriore të Komunës dhe përbëhet nga malet dhe pjesërisht nga toka bujqësore, livadhet dhe kullosat. Kjo zonë mbulon afërsisht 39 % të sipërfaqes së tërësishme të Komunës, ndërsa ka një dendësi shumë të ulët të popullsisë, vetëm 4 % e numrit të tërësishëm të banorëve të Komunës.



Foto 12. Istogu në Hartën e Kosovës



Foto 13. Istogu: Zonat (Fusha, Rrëza, Bjeshka)

3.2 Kushtet klimatike

Territori i Komunës së Istogut karakterizohet me klimë kontinentale të butë në të cilën ndikim të madh ka afërsia e kurorës malore të “Bjeshkëve të Thata” nga pjesa veriore që ka ndikim të madh në ndryshimin e shpeshtë të temperaturës gjatë ditës. Ky territor nuk ndryshon shumë sipas kushteve të temperaturës nga territoret tjera të pjesës veriore të rrafshit të Dukagjinit, të cilat janë në një pjesë të madhe nën ndikimin e klimës kontinentale dhe që kanë më pakë nxehtësi dhe më tepër të reshura. Temperaturat mesatare mujore sillet prej 0.5 °C në janar deri në 23.3°C në gushtë. Temperatura mesatare vjetore është 11.3°C, ndërsa në periodën vegetative 17.6° C. Sasia vjetore e të reshurave është mesatarisht afro 740 mm, që këtij territori i japin karakterin e lagështë. Mirëpo, renditja e tyre gjatë periudhës vegetative është 307mm ose 41 % dhe jashtë periudhës vegetative 431 mm ose 59 %, e sidomos gjatë muajve të verës (qershor-gushtë) me afro 147mm (20 % nga të reshurat vjetore). Kështu që, gjatë periudhës vegetative paraqitet deficit i lagështisë në tokë për zhvillimin normal të kulturave bujqësore dhe si faktorë kufizues në prodhimtarinë bujqësore.



Foto 14. Peizazh veror



Foto 14. Peizazh dimoror

Lagështia relative mesatare vjetore e ajrit është 70 %, ndërsa gjatë periudhës vegetative është 63 %, që këtij territori i jep karakteristikën e hapësirës me lagështi mesatare të ajrit. Gjatë periudhës vegetative në këtë territor lajmërohet deficit i të reshurave e më këtë edhe lagështia në tokë, ky deficit është afro 307 mm (3.070 m³/ha), i cili duhet të kompensohet me anë të ujitjes.

Regjioni i gjerë i Istogut përshkohet me klimë të mesme kontinentale në të cilën përpos faktorëve të jashtëm ndikojnë edhe faktorët lokal të brendshëm prej të cilëve më të rëndësishmit janë lartësia mbidetare, drejtimi i shtrirjes së masiveve malore, drejtimi i shtrirjes së luginave, afërsia me detin Adriatik dhe pellgun e lumit “Drini i Bardhë”. Sipas shënimeve temperatura mesatare vjetore e ajrit është 10,7 °C. Temperaturat më të ultë janë shënuar në muajin janar, ndërsa më të larta në muajin korrik dhe gusht. Temperatura mesatare mujore e ajrit në janar ka qenë -0.4 °C në korrik 20.3 °C dhe në gusht 19.6°C. Me rritjen e lartësisë mbidetare bie edhe temperatura mesatare e ajrit. Sipas shënimeve 10 vjeçare sasia mesatare e reshjeve është 730 mm. Renditja e tyre është gjatë periudhës vegetative 307 mm ose 41 % dhe jashtë periudhës vegetative 423 mm apo 59 %.

Në pjesën e ftoftë të vitit, tetor-mars, sasia mesatare e reshjeve është më e madhe, ndërsa në periudhën prill-shtator është më e vogël. Gjatë dimrit reshjet zakonisht janë me borë, ku trashësia e shtresës dhe kohëzgjatja e mbajtjes varen nga lartësia mbidetare dhe morfologjia e terrenit, si dhe ekspozicioni i terrenit. Erërat kanë rëndësi të madhe, si modifikues të klimës në regjionin e gjerë të Istogut sepse bartin me vete karakteristikat e klimës nga vijën. Sipas observimeve dhe materialit në disponim në Istog më së shpeshti fryjën erëra nga jug-perëndimi, perëndimi dhe lindja. Në Komunën e Istogut erë dominonte është ajo veriperëndimore 88 %, era perëndimore 6.7 %, kurse ajo lindore 40 %.

Duhet theksuar se në Istog e rrethinë frynë herë-herë një erë e fuqishme lokale të cilën vendasit

e quajnë “meqava” dhe e cila formohet me zbritjen e masave të ftohta ajrore nëpër shpatijet malore. Kjo erë përfshinë të gjitha fshatrat rrëzë shpatijeve malore prej fshatit Syriganë e gjerë në Kaliqan dhe arrin shpejtësinë deri në 150 kilometra në orë dhe me këtë rast shkakton dëme të mëdha në objekte të banimit, kulme, si dhe në bujqësi, posaçërisht në pemëtari. Në drejtim të Gurrakocit ajo përfshinë një largësi prej 4 km. Lagështia mesatare vjetore është rreth 70 %, ndërsa rrezatimi diellor mesatar mujor është 176 orë.

Tabela 4. Të dhënat statistikore - mujore për klimën

Muajt / Parametrat	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Resgjet mesatare në (mm)	77	61	54	47	59	56	36	40	41	55	91	86
Temperatura mesatare (°C)	-0.4	0.8	8.5	11.8	16.1	18.4	20.3	19.6	18.4	11.5	5.7	1.3
Diellzimi mesatar (h)	70	102	147	184	221	258	299	289	222	168	95	66

Tabela 5. Temperaturat mesatare, sipas stinëve të vitit

Muajt / Parametrat	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Resgjet mesatare në (mm)	77	61	54	47	59	56	36	40	41	55	91	86
Temperatura mesatare (°C)	-0.4	0.8	8.5	11.8	16.1	18.4	20.3	19.6	18.4	11.5	5.7	1.3
Diellzimi mesatar (h)	70	102	147	184	221	258	299	289	222	168	95	66

3.3 Mjedis

Istogu mund të thuhet se ka një ambient të pastër, meqë nuk ka fabrika për ndotjen e tij në masë të madhe. Mirëpo, edhe në këtë Komunë ka ndotje të ambientit dhe degradim të pasurisë ambientale. Dhjetë vitet e kaluara, si dhe lufta në Kosovë, janë burim i problemeve të mëdha mjedisore, si në Kosovë, po ashtu edhe në Istog.

Natyrë e Istogut është shumë e vlefshme. Ajo ka shumë funksione, është shtëpi për shumë lloje të florës dhe faunës, ofron rekreacion për banorët lokal dhe tërheq turistët që kontribuojnë në ekonominë lokale. Mirëpo, gjendja jo e mirë mjedisore është si rezultat i ndërtimeve dhe planifikimit jo të mirë, infrastruktura jo adekuate, shtimi i numrit të automjeteve, ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, nga mungesa e trajtimit të ujërave, prerja e pakontrolluar e pyjeve, akumulimi i plehrave urbane, si pasojë e mos menaxhimit të mirë, mungesa e riciklimit etj.

Një ndër çështjet me rëndësi në fushën e mbrojtës të mjedisit është prerja e pakontrolluar e pyjeve. Degradimi i pyjeve po ndikon në shkatërrimin e sipërfaqeve, të cilat e kanë edhe rolin e mbrojtësit, nëpër të cilat uji i shkaktuar nga të reshurat e mëdha po kalon pa ndonjë pengesë në shtretërit e lumenjve, që si rezultat kemi vërshimet. Rrezik tjetër permanent paraqesin edhe të reshurat, të cilat ndikojnë në rritjen e sasisë dhe nivelit të ujit në lumenj, të cilët të pambrojtur vërshojnë sipërfaqe të mëdha të tokës kualitative bujqësore.

Pra, mbrojtja e ambientit është e rëndësishme së veçantë. Për të arritur sigurinë dhe mbrojtjen e ambientit duhet të merren masa për parandalimin e shkatërrimit të pyjeve, prerja e drurëve të lejohe vetëm në rastet kur zëvendësohet me ri-mbjellje. Në sipërfaqet ku ekziston rreziku nga erozioni

prerja e drurëve është rreptësisht e ndaluar. Të parandalohet ndotja e vazhdueshme e lumenjve dhe ujërave nëntokësore nga kanalizimi dhe rrjedhjet e mëtejshme në lumenj. Është shumë e rëndësishme fillimi i punimeve në lidhjen e shtëpive në sistemin e kanalizimit, si në fshatra ashtu dhe qytet. Për shtëpitë e shpërndara në zonat rurale, realizimi i sistemit të kanalizimit do të jetë i shtrenjtë, kështu që këtu duhet të vendosen rezervuarët septik. Derdhja e ujërave të zeza në lumenj rreptësisht të ndalohet. Në zonën urbane, sistemi kanalizimit të zhvillohet në përputhje me Strategjinë e Kosovës për trajtimin e ujërave.



Foto 16. Mbeturinat në lumin e "Istogut"



Foto 17. Derdhja e ujërave të zeza në lum



Foto 18. Rregullimi shtratis të lumit "Istog"

Tabela 6. Problemet mjedisore në Komunën e Istogut

Nr.	Problemet
1.	Trajtimi jo adekuat i ujërave të zeza, përkatësisht derdhja e tyre në lumenj.
2.	Mbeturinat-Mbetjet urbane, të papërpunuara, që grumbullohen në vende të hapura, pranë qendrave të banimit.
3.	Mos-kyçja në kanalizim i të gjitha lagjeve të qytetit.
4.	Mungesa e hapësirave çlodhëse dhe të gjelbra-parqeve, shesheve e këndeve të argëtimit.
5.	Grumbullimi i hekurishteve në vendet urbane dhe të banueshme.
6.	Deponitë e automjeteve të pa përdorshme.
7.	Keq menaxhimi i pyjeve.
8.	Formimi i deponive ilegale pranë qendrave të banimit dhe vendet rurale.
9.	Hedhja e mbeturinave në kanale të ujitjes.
10.	Mungesa e strategjisë për ruajtjen e biodiversitetit.
11.	Mos përfshirja e të gjitha vendeve urbane dhe rurale në grumbullimin e mbeturinave në kontejnerë.
12.	Ndërtimi i banesave kolektive pa zona të gjelbëruara.
13.	Mungesa e strategjisë zhvillimore.
14.	Mungesa e një zhvillimi të qëndrueshëm në zonën turistike.
15.	Kapaciteti i ulet i deponisë Komunale në Tuqep, si transfer i mbeturinave.
16.	Mungesa e strategjive për parandalimin e erozionit.

Masat që duhet ndërmarrë:

Andaj me qëllim të ruajtjes së ambientit duhet marrë disa masa nga Komuna:

- Trajtimi adekuat e ujërave të zeza;
- Kufizimi i zgjerimit të vendbanimeve dhe rregullimi i hapësirës së Istogut dhe të hapësirave të tjera të Komunës, që të jenë sa ma tërheqëse për të jetuar;
- Minimizimi i ndikimeve të rrezikshme, si vërshimet, erërat, zjarret etj.;
- Mbrojtja e llojlojshmërisë së peizazheve natyrore;
- Ngritja e hapësirave të gjelbër në qytet;
- Shfrytëzimi i burimeve të ujit;
- Minimizimi i veprimeve të dëmshme të njeriut në mjedis;

- Kontrolli i zhvillimit në zonën urbane;
- Përparimi i sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm;
- Ndërtimi i sistemit të kanalizimit fekale dhe atmosferik;
- Rikonstruktimi dhe rigjenerimi i zonave të trashëgimisë historike dhe kulturore;
- Mbrojtja e tokës kualitative bujqësore dhe ndalimi i ndërtimit në tokat e kategorisë 1-4;
- Mbrojtja e ndotjes së ajrit nga trafiku dhe prodhimtaria urbane dhe industriale;
- Mbrojtja e ujërave nga derdhjet e kanalizimeve, me trajtime adekuate, ndërtimin e impianteve;
- Mbrojtja e lumenjve nga derdhjet ujërave të hurdhave të peshqve dhe;
- Matja e rregullt e sasisë së ndotjes së këtyre ujërave.

3.3.1 Ndotja urbane

Një ndër problemet kyçe në botën e sotme është ndotja e mjedisit. Jemi dëshmitar të kohës kur brenda një dhjetëvjeçari në natyrë janë bërë ndryshime aq të mëdha, që në kushte normale për të ndoshta do të duhej një shekull. Ndërrimet e klimës, prishja e ekosistemeve, tharja e bimëve dhe e drurëve, ngrohja globale, erozioni etj., janë shenja se duhet të brengosemi seriozisht për mjedis ku jetojmë.

Rrezikimi i mjedisit në Komunën e Istogut, sikurse edhe në komunat e tjera zakonisht janë si rezultat i planifikimit joadekuat urbanistik, infrastrukturës jo adekuate, numrit të rritur të automjeteve, ndotjes së ujit, rrjedhave, për shkak të mungesës së trajtimit të ujërave të zeza, prerjes së pakontrolluar të pyjeve etj. Qendrat urbane janë të mbingarkuara nga mbeturinat inerte dhe deponitë ilegale të mbeturinave.

Kjo situatë e kërcënon mjedisin, duke shkaktuar ndotjen e ujit, ujërave nëntokësorë, ajrit dhe dheut. Ujërat e zeza kalojnë të pa trajtuara në ujin e lumit “Istog”, “Vrelle” dhe lumenj të tjerë më të vegjël të Istogut. Sipas të dhënave nga studimi: “Kadastru i ndotësve të ujërave të Kosovës” del se në regjionin e Pejës ndotësi më i madh u ujërave nga vend-shkarkimet, është Istogu me 24 sish, prej të cilëve 10 janë ndotës kolektiv dhe 14 ndotës të veçantë.

Nuk është bërë mjaft për organizimin e mbledhjes së mbeturinave dhe transportit të tyre. Kurse, në zonat rurale organizimi i mbledhjes dhe transportit të mbeturinave është shumë i vogël në krahasim me nevojat në terren.

Po ashtu, problem që po ndikon në mjedis, këtu në Istog dhe rrethinë, është degradimi nga mi-hjet sipërfaqësore nga një numër i konsideruar i gurëthyesve. Në Komunën e Istogut janë të evidentuar 7 gurthyes që marren me eksploatimin e zhavorrit, dy në Vrellë, tre në Lubozhde dhe një në fshatin Sine. Po ashtu, janë një prodhues i lëngjeve “Sinalko” në fshatin Vrellë dhe tre prodhues të kubzave nga betoni në Zallq.

3.3.2 Mbeturinat

Në Komunën e Istogut menaxhimi i mbeturinave është përmirësuar dukshëm falë donacioneve të jashtme, të cilat me programet e tyre kanë ndikuar në përmirësimin e kushteve të grumbullimit të mbeturinave. Ekziston deponia rajonale në Cvërk e cila akumulon 0.54 kg mbeturina për kokë banori, në ditë. Mirëpo, sa i përket Istogut, procesin e grumbullimit dhe bartjes së mbeturinave prej bazës, deri të deponimi, e bënë Kompania rajonale e mbeturinave “Ambienti”, njësi në Istog, cila mbledhë, grumbullon dhe transporton mbeturinat në deponinë e fshatin Tuqep. Deponimi i këtyre mbeturinave nuk behët në Sverk, për shkak të kostos së lartë të transportit, andaj për këtë qëllim është hapur deponia e Tuqepit, e cila i plotëson përkohësisht nevojat e grumbullimit të mbeturinave

për këtë trevë. Kjo kompani, kontraktonte punë me Komunën për mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbëruara dhe trotuareve, pastrimin fshirjen dhe larjen e rrugëve në qytet, mirëmbajtjen e parkut dhe varrezave të qytetit. Gjithashtu, e bënë edhe deponimin e këtyre mbeturinave në deponinë e Tuqepit. Mbledhja e mbeturinave bëhet përmes shërbimit me kontejnerë. Në këtë mes, kjo kompani nuk bënë grumbullimin e mbeturinave inerte.

Kjo njësi posedon tri lloje të kontejnerëve:

- Kontejnerë të madhësisë 1,1 m³ - 384 copë;
- Kontejnerë 1.3 m³ - 5 copë dhe;
- Kontejnerë të madhësisë 1.5 m³ - 15 copë.

Për bartjen e mbeturinave kjo njësi ka në dispozicion tre (3) kamionin për kontejnerë 1.1 dhe një (1) kamion për kontejnerë të mëdhenj.

Sasia e mbeturinave që grumbullon kjo kompani:

- Ditore216 m³;
- Mujore.....4.752 m³;
- Vjetore.....57.024 m³ dhe;
- Mbeturina mjekësore...150 m³

Si zonë e shërbimit dhe grumbullimit mbeturinave të kësaj kompanie është qyteti i Istogut në tërësi dhe 12 fshatra pjesërisht, nga 50 fshatra sa ka Komuna e Istogut.

Numri i konsumatorëve të përfshirë në rrjetin e grumbullimit të mbeturinave është:

- Amvisëri.....1.161;
- Biznesi.....378 dhe;
- Institucione.....18.

Mirëpo, për plotësimin e nevojave për grumbullimin e 80 % të mbeturinave në Komunën e Istogut nevojiten të sigurohen edhe 400 kontejnerë dhe dy kamion për transportin e mbeturinave. Mungesa e kontejnerëve dhe kamionëve për transport, si dhe mos përfshirja e të gjitha fshatrave në rrjetin e grumbullimit të mbeturinave ka ndikuar në shtimin e deponive ilegale. Kështu, si pasojë e kësaj në Komunën e Istogut janë evidentuar më se 25 deponi ilegale të hedhjes së mbeturinave. Në zonën urbane të Istogut nuk ka deponi formale të mbeturinave, mirëpo ka shumë vende ku ato janë grumbulluar në formë kaotike. Janë identifikuar dy zona të mbeturinave, kryesisht inerte, si dhe disa lokacione të mbeturinave nga amvisëritë. Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve behët vetëm në qytetin e Istogut.



Foto 19. Mosmirëmbajtja e mbeturinave



Foto 20. Menaxhimi i mbeturinave

3.3.3 Mirëmbajtja e gjelbërimit të qytetit

Mirëmbajtjen e pjesëve të gjelbëruara të qytetit dhe atë: mbjellja e luleve, fidanëve, kositja e barit, mbjellja dhe kositja-rregullimi i rrethojave të gjalla, krasitja e drurëve sipas nevojës etj., bëhet nga Kompania rajonale e mbeturinave “Ambienti”, njësi në Istog.

Istogu edhe pse ka një ambient të gjelbëruar për shkak të pozitës gjeografike, e ku më se gjysma e sipërfaqes së tij është bjeshkë dhe male, nuk mund të mburret me ndonjë park të qytetit. Ekziston një park i vogël në qendër të qytetit, i cili më tepër është vend i grumbullimit të mbeturinave dhe papastërtisë, se sa që shfrytëzohet për pushim dhe rekreacion. Janë edhe disa lokacione të gjelbëruara, mirëpo nuk i plotësojnë parakushtet për parqe të mirëfillta për pushim dhe rekreacion. Parku më i madh dhe më i mirëmbajtur është parku i Banjës.

Numri i parqeve e shesheve në Komunë është shtatë (7). Totali i sipërfaqeve të parqeve dhe shesheve komunale të cilat mirëmbahen rregullisht janë 68 hektarë, kurse numri i parqeve e shesheve komunale me qasje në ujë të pijshëm janë tre (3) sosh.



Foto 21. Kompleksi Trofta



Foto 22. Mirëmbajtja e gjelbërimit

3.4 Ajri

Ndotja e ajrit që shkaktohet nga përzierja me substanca që futen në rrugë natyrore apo antropogjenë (të shkaktuara nga njeriu), përbënë shkaktues kryesor të përkeqësimit të cilësisë së tij. Aktualisht, shkaktarët më të mëdhenj të ndotjes së ajrit në Komunën e Istogut janë: Komunikacioni-transporti me mjete të vjetra motorike dhe kryesisht pa katalizatorë, pjesërisht industria e lehtë, gjeneratorët, pastaj deponitë e hapura të mbeturinave komunale me metan dhe CO₂, deponitë e automjeteve të dëmtuara, deponitë e grumbullimit të hekurishteve, si dhe operatorët e ndryshëm që veprojnë në Komunën e Istogut.

Një ndër ndotësitë kryesorë të ndotjes së ajrit në Komunën e Istogut janë edhe automjetet. Numri i automjeteve të regjistruar në Komunën e Istogut është 7.000 automjete të llojeve të ndryshme. Mosha mesatare e këtyre automjeteve është viti 2000, ndërsa mesatarisht qarkullojnë rreth 100 kilometra në ditë. Këto automjete, kryesisht, nuk kanë katalizatorë, gjë që veprojnë drejtpërdrejtë në ndotjen e ambientit, përkatësisht të ajrit. Aktualisht ka mungesë të ligjeve dhe standardeve lidhur me emisionet në ajër dhe cilësinë e tij.

Në Komunën e Istogut ka një numër të madh të operatorëve që ndikojnë në ndotjen e ambientit dhe të ajrit.

Tabela 7. Operatorët që ndikojnë në ndotjen e ambientit janë:

Nr.	Operatorët	Numri
1.	Pompat e benzinës	15
2.	Gurthyesit	7
3.	Kultivuesit e peshqve	10
4.	Thertoret	7
5.	Sharrat-gaterrat	14
6.	Përpunuesit e metaleve dhe plastikës	19
7.	Deponitë e materialit ndërtimor dhe ndërmarrjet	48
8.	Automekanikët dhe autolarjet	23
9.	Hotelet dhe restorantet	27
10.	Fermat e lopëve (mbi 20 krerë lopë)	8
11.	Fermat e deleve (mbi 100 krerë dele)	18
12.	Qendrat tregtare	4
13.	Prodhuesit e ambulive dhe tepihëve	3
14.	Deponitë e automjeteve të dëmtuara	6
15.	Deponitë e hekurishteve	2

3.5 Tokat

Territori i Komunës së Istogut përfshinë një sipërfaqe prej 45.384 ha, me 4.17 % të territorit të Kosovës me 46 komuna kadastrale. Në këtë Komunë aktivitet kryesorë ekonomik është bujqësia dhe blegtoria. Toka bujqësore përfshinë një sipërfaqe prej 20.084 ha.

Në pjesën veriore të Komunës së Istogut shtrihen rajonet e larta të cilat kufizohen me masivin e “Bjeshkëve të Thata” me lartësi mbidetare deri në 2.155 m. Në pikëpamje të kushteve orografike territori i Komunës së Istogut ka kushte të volitshme për prodhimtarinë bujqësore për shkak të klimës së volitshme, pasurisë së burimeve të ujit dhe për arsye se deri në 600 m të lartësisë mbidetare gjinden 23.240 ha, apo 51.19 % sa ka sot sipërfaqe tokësore. Prodhimi më intensiv i bujqësisë dhe prodhimtarisë perimore mundë të organizohet në sipërfaqe deri në 500 m të lartësisë mbidetare, ku këto sipërfaqe të përgjithshme janë afro 14.160 ha, apo 31.19 % dhe gjinden nëpër luginat e lumenjve që shtrihen nëpër territorin e Komunës së Istogut.

Në Komunën e Istogut, si toka të punuara dhe kopshte shfrytëzohen afro 12.176 ha, ndërsa si livadhe dhe kullosa afro 12.620 ha. Sipërfaqet në lartësi mbidetare prej 500-600 m janë të përshtatshme për prodhimtarinë e pemëve e këto sidomos në pjesën lindore të Komunës në drejtim të Rakoshit, nëse do të ketë mundësi të ujitjes. Ndërsa, sipërfaqet në lartësi prej 600-700 shfrytëzohen vetëm pjesërisht për prodhimtarinë bujqësore në pjesën lindore, kurse sipërfaqet tokësore në lartësi mbidetare mbi 700 m mbi nivelin e detit përbëjnë 40 % të territorit të Komunës, ku një pjesë e tyre shfrytëzohen për kullosa dhe pjesa më e madhe e tyre si pyje. Toka e territorit të Komunës së Istogut është mjaftë heterogjene, sepse përmbanë shumë tipe dhe nën-tipe.

Më së tepërmi është e përfaqësuar tipi i tokës së zezë në gurë gëlqeror e cila përfshinë 14.815 ha, apo 32.63 % të territorit të përgjithshëm, të cilës i takon boniteti i klasës VI-VIII dhe ky tip i tokave përfshinë kryesisht pjesët kodrinore-malore, dhe sipas karakteristikave është kryesisht tokë pyjore dhe kullosa malore.

Tabela 8. Sipërfaqja e tokës sipas bonitetit, klasës 1.2.3-8

Klasa	Sipërfaqja	
	Ha	%
1, 2 dhe 3	4.320	9.51
4 dhe 5	23.540	51.85
6, 7 dhe 8	17.540	38.64

Toka të mira të bonitetit të klasës së 1 dhe 3 ka mjaftë pakë, gjithsejtë afro 4.320 apo 9.51 %. Mirëpo, pjesërisht këto sipërfaqe janë të pushtuara nga shtëpitë e banimit dhe objekte të tjera, kështu që sipërfaqja reale për prodhimtari bujqësore është shumë më e vogël. Në këtë grup hyjnë kryesisht tokat aluviale, të cilat janë afro 2.000 ha.

Grupin e dytë të tokave të klasës së bonitetit 4 dhe 5 më së shumti e përbëjnë tipat e tokës të cilat përfshijnë afro 23.540 ha, apo 51.85 %.

Në këtë grup hyjnë: tokat aluviale deluviale me 428,5 ha, tokat e kuqe me 3.021 ha, tokat e përhimëta carbonate me argjil me 286 ha, tokat deluviale me 4.671 ha, diluviumi lesinor me 2.014 ha, rrëshinorja e eroduar me 1.285 ha, pseudoglej me 4.906 ha, tokat minerale moçale me 2.742 ha, rendzinat dhe renëdezinat e përhirta me 857 ha.

Tokat e këtyre grupeve karakterizohen me kufizime në shfrytëzimin e tyre, si toka të punuara, sepse janë nën ndikimin e erozionit, janë të tharta të cekta apo mjaftë zhavorre e disa me regjim të dobët ujor-fizik (tokat minerale-moçalike dhe pseudoglej). Në këto toka në të ardhmen duhet marrë

masa për mirëmbajtje dhe rregullimin e regjimit ujorë, meqë këto sipërfaqe do të shndërroheshin në sipërfaqe të punuara.

Grupin e tretë e përbëjnë tokat të cilat i takojnë klasës së bonitetit V-VII, në këtë grup janë të radhitura tokat e zeza në gurë gëlqeror me sipërfaqe me të mëdha prej 4.815 ha, tokat e përhita të tharta skeletoide me 6.678 ha, apo gjithsejtë afro 23.346 ha.

Një pjesë e këtyre sipërfaqeve është tokë e punuar, ndërsa pjesa tjetër xhindet nën livadhe malore dhe nën pemë, kullosa dhe pyje. Tokat e këtij grupi nuk janë të përshtatshme për tu punuar sepse janë të cekta, skeletoide dhe të tharta apo gjinden në një lartësi më të madhe mbidetare.

Prandaj, Komuna e Istogut ka sipërfaqe relativisht të vogël të përshtatshme për shfrytëzim intensiv, gjegjësisht ka gjithsejtë afro 22.000 ha (bruto), apo 48 % nga territori i përgjithshëm. Fatkeqësisht për momentin bujqësia në Komunën e Istogut paraqet veprimtarinë themelore ekonomike të popullatës sonë, ku rreth 65 % të popullsisë krijojnë të ardhura nga bujqësia.

Madhësia e vogël e fermës është njëri nga faktorët kufizues për një prodhimtari intensive bujqësore. Duke qenë në një situatë të këtillë fermerët të cilët janë të orientuar nga prodhimi komercial shpeshherë janë të detyruar që të marrin tokë me qira (8.9 %).

Në një situatë të këtillë, kur sipërfaqet e tokës bujqësore janë shumë të kufizuara, rritja e produktivitetit (rritja e rendimentit për njësi të sipërfaqes) në to është mundësi reale për një prodhim i cili në të ardhmen e afërt duhet të orientohet në zëvendësimin e importit të produkteve bujqësore. Natyrisht se duhet hulumtuar në vazhdimësi mundësitë e eksportit për ato prodhime të cilat Kosova ka mundësi t'i eksportoje.

Tabela 9. Tregues të rëndësishëm të fermës

Madhësia mesatare e fermës (ha)	2.36
Madhësia mesatare e ngastrës bujqësore (ha)	2.01

Kryesisht, prodhimtarja bujqësore intensive në Komunën e Istogut është e koncentruar në prodhimin e pemëve, perimeve dhe drithërave.

3.5.1 Tokat erozive

Gjatë periudhave kur të reshurat janë të shpeshta dhe pas shkrirjes së borës, sasia e ujit rritet duke krijuar përmytje (vërshime). Faktorë të tjerë që shkaktojnë vërshime, janë edhe mbeturinat nëpër lumenj, si dhe rrokullisjet e gurëve nga bjeshkët.

Zonat e rrezikuara nga vërshimet janë zonat pranë rrjedhave dhe kjo si rezultat i mungesës së pandave mbrojtëse. “Përroi i Bollovanit” e rrezikon qytetin e Istogut, për shkak se në rrjedhën e tij të dikurshme sot ka ndërtim. “Përroi i Dragiqit” nga ujërat e pyllit e rrezikon fshatin Cerrcë sepse rrjedha e tij e dikurshme sot shfrytëzohet si rrugë nga fshatarët. Vrella rrezikohet nga përroi i quajtur “Lugu i Madh”. I rrezikuar konsiderohet edhe Kalliqani nga “Përroi Drenik”, i cili vazhdon shtrirjen e tij edhe nëpër fshatin Studenicë. Edhe lumi i Istogut vërshon dhe me këtë rast dëmton fshatrat: Llukavc i Begut, Llugë, Zabllaq, një pjesë afër urës të lagja Hasanaj afër Gurrakocit vazhdon deri të fshati Rudicë. Dëme të kësaj natyre shkakton edhe Gujavçi, i cili përfshin Drejën dhe Zallqin. Në periudhat kur të reshurat janë të shpeshta, përroskat akumulojnë ujë dhe erodojnë më së shumti pjesën malore. Ky erodim është i theksuar në Syriganë, Kalliqan dhe Vrellë. Për këtë arsye Komuna duhet të krijojë bazën e të dhënave për rrjedhat e lumenjve dhe erozioneve dhe ti vendosë ato në GIS harta për të treguar zonat ku vërshimet mund të ndodhin. Këto të dhëna do të shërbejnë për mbikqyerje të vazhdueshme të lumenjve dhe për analiza hapësinore për nivelin e ndikimeve nga vërshimet. Komuna në bashkëpunim me institucionet përkatëse të nivelit qendror duhet të hartojë planin e veprimeve nga vërshimet dhe masat zbutëse për përgjigje të menjëhershme ndaj rreziqeve nga vërshimet.

Masat e domosdoshme për parandalimin e erozionit janë:

- Masat Hidraulike;
- Masat Bujqësore dhe;
- Masat Biologjike.

Me qëllim të parandalimit të erozionit dhe zvogëlimit të ndikimeve negative, Komuna duhet të ndër marrë hapat e menjëhershme si:

- Parandalimi i prerjes dhe degradimit të pyjeve;
- Parandalimi i kullotjes së tepërt;
- Parandalimi i shfrytëzimit joracional të resurseve natyrore që mund të shkaktojnë erozion dhe;
- Krijimi i pendëve mbrojtëse.

3.5.2 Pyjet

Komuna e Istogut, sipas lokacionit gjeografik të territorit të saj, shtrihet në pjesën më veriore të Rrafshit të Dukagjinit dhe është kryesisht vend malor. Pyjet janë pasuri në vete për Komunën e Istogut. Ato mbulojnë një pjesë të konsiderueshme të këtij territori. Dikur pyjet e dushkut mbulonin një pjesë të konsiderueshme të rrafshinës së sotme pjellore, ku sot vendin e tyre e zënë drithërat dhe kulturat tjera bujqësore. Sipas të dhënave të regjistrimit të fundit të pyjeve të vitit 1961, sipërfaqet pyjore janë 19.220 ha, prej tyre në sektorin shoqëror janë afro 13.570 ha apo 68,8 %, ndërsa në sektorin privat 5.650 ha apo 32,2 %.

Nga sipërfaqja e përgjithshme e pyjeve në Kosovë (490.000 ha), Istogu me sipërfaqe pyjore merr pjesë me 3,92 %.

Pyjet e Istogut janë të renditura në formë “katesh” apo brezash, duke filluar nga rrafshi me drunjtë shtatshkurtër deri të majat çetinore shkëmbore në bjeshkët e larta me shtat më të gjatë. Këtë radhitje brezore e diktuan kushtet, përkatësisht elementet natyrore: baza pedologjike, klima në varshmëri me lartësinë mbidetare dhe vet pozita gjeografike e arealit të caktuar.

Pyjet në Istog përbëhen nga brezi i pyjeve të larta dhe të ulëta. Janë të pasura me drunjtë me një mesatare prej 90 m³/ha. Ndër llojet më karakteristike janë: breu, ahu, bungu, por të diferencuar mirë rriten edhe qarri, shparri, rrapi (tash i kapluar nga një sëmundje, gjendet në fazën e zhdukjes, si lloj), frashër, shkoza, panja dhe çetinat e ulëta në lartësinë malore mbi 1500m. Si lloje të grupuara dhe të veçuara rriten edhe lajthia, bliri, shelgu, verri, akacia etj.

Etati vjetor në pyjet e Istogut sillet prej 4-5 m³. Fatkeqësisht, fondi pyjor është në zvogëlim e sipër nga niveli i lartë i prerjeve legale dhe ilegale, zjarret dhe mungesa e pyllëzimeve të reja. Sipas strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal të Istogut, duke u bazuar në vizionin, qëllimet dhe objektivat, ndër projektet që synohen të realizohen është pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura.

Pyjet e larta janë kryesisht të ruajtura, duke iu falënderuar mos përshtatshmërisë së terrenit në të cilin gjenden. Në të shumtën e rasteve, pyjet janë të mbjellura me lisa (rreth 8000 ha, prej të cilave janë të degraduara rreth 3000 ha), pjesën tjetër të pyjeve e përbëjnë pyjet e larta të mbjellura me ah, bredh të kuq dhe bredh.



23. Brezi i mesëm (pyje gjetherënëse)



Foto 24. Pyje të larta (halorët)

3.5.2.1 Gjendja e pyjeve

Përkundër parimeve mbi menaxhimin, ruajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm, përfshirë parimin parandalues, konservimin e diversitetit biologjik, barazisë ndërbreznore dhe zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm, gjendja e pyjeve dita ditës ndryshon. Ndryshimet në gjendjen e pyjeve janë kryesisht në zvogëlimin e fondit pyjor, llojit të drunjtëve, si dhe sipërfaqeve të pyllëzuara nga prerjet ilegale dhe zjarret.

Tabela 11. Struktura e pyjeve publike në Komunën e Istogut

Nr.	Struktura e pyjeve	Sipërfaqja – ha	Sipërfaqja - %
1.	Të pastra të breut	3.700	27.3
2.	Të pastra të ahut	5.000	36.8
3.	Të bungut	2.050	15.1
4.	Shkurret	320	2.3
5.	Tokë pyjore	2.500	18.5

3.5.2.2 Roli prodhues

Roli prodhues i pyjeve të Istogut është mjaft i rëndësishëm, duke iu falënderuar strukturës së sipërfaqeve pyjore. Kjo vërehet edhe nga të dhënat (1978 Instituti Ekonomik - Prishtinë) së përbërjet e pas-tra të gjethorëve dhe halorëve janë 8.700 ha apo 64.41 % nga sipërfaqja e përgjithshme e pyjeve.

Mirëpo, prodhimi i tanishëm i pyjeve të territorit të Istogut është zvogëluar dukshëm nga prerjet e egra të paraluftës dhe ato ilegale që janë mjaft të larta edhe sot, pastaj sipërfaqja jo prodhuese e përgjithshme pyjeve dhe ajo pjesërisht prodhuese është afro 35,9 % apo 1/3 e territorit të përgjithshëm me pyje.

Funksioni më i rëndësishëm i pyjeve është se ato mbrojnë tokën nga erozioni dhe mënyrat e ndryshme të zhveshjes dhe kanë ndikim në karakteristikat klimatike, në pengimin e vërshimeve të sipërfaqeve bujqësore dhe vendbanimeve në pjesët pranë bregut të ujërave.

Në Komunë e Istogut nuk ka pyje për destinim të veçantë, ato kryesisht kanë karakter ekonomik dhe pjesërisht mbrojtës nga erozioni dhe ndikimet e ndryshme natyrore, ndërsa zona të shpallura, si zona të mbrojtura me ligj nuk ka, ka vetëm propozime në kuadër të parkut nacional të “Bjeshkëve të Nemuna”.

3.5.2.3 Menaxhimi i pyjeve

Deri në vitin 2003, me menaxhimin dhe mbrojtjen e pyjeve shtetërore dhe private, si dhe të tokës pyjore, është marrë Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Hidroekonomisë e KK të Istogut, ndërsa sot janë nën kompetencë të Agjencionit Pyjor të Kosovës.

Pyjet në pronësi shtetërore kanë qenë nën qeverisje dhe mbrojtje të kompanisë “Radusha”, e cila ka qenë përgjegjëse për çështjet që kanë të bëjnë me qeverisjen e pyjeve, tokës pyjore dhe mbrojtjen e florës dhe faunës në Komunën e Istogut. Krahasuar me komunat e tjera të Rrafshit të Dukagjinit pylltaria e Komunës së Istogut renditet e para.



Foto 25. Dëmtimi i pyjeve



Foto 26. Keq-menaxhimi i pyjeve

Tabela 12. Gjendja e pyjeve dhe shfrytëzimi i tyre

Sipërfaqe tokësore nën pyje (ha)	20.150	
Lloji i druritëve të pyllit (%)		
	Halor	27.3 %
	Ahu	36.8 %
	Bungu	15.1 %
	Shkurre	2.3 %
Pronësia e pyjeve	% private	% shtetërore/komunale
	32.2	68.8
Shfrytëzimi i drurit për ngrohje	64.677 m ³	
Prerje të rregullta	2.000 (dru zjarri+ teknikë)	11.705
Prerje të jashtëligjshme	Nuk ka të dhëna	3.644,49 m ³ (dru zjarri + teknikë)

3.6 Uji

Territori i Komunës së Istogut shquhet me hidrografi të zhvilluar. Lumenjtë kryesor janë: lumi i “Istogut”, lumi i “Vrellës” dhe “Drini i Bardhë”. Përveç këtyre lumenjve, ekziston edhe një numër i konsiderueshëm i rrjedhave më të vogla të përhershme dhe të përkohshme, si: “Përroi i Keq”, “Shushica”, “Çaushi”, “Gujavçi”, “Bllagaça” etj.

Nëpër vendbanimin e Istogut, rrjedh lumi i “Istogut” me gjatësi prej 14 km, që formohet nga burimi i “Istogut”. Burimi i “Istogut” buron nga çarja e shkëmbinjve gëlqeror që gjenden mbi vendbanim. Ky lum është i begatshëm me ujë dhe përmes formës së vijës, përçohet nëpër vendbanim. Uji i tij shfrytëzohet për ujitjen e kopshteve, pemishteve dhe livadheve. Pjesa e epërme e rrjedhës së lumit të “Istogut” është e gjerë 4 m, ndërsa në fund ai vjen e zgjerohet në 6-10 m. Shtrati i tij është i cekët, i prerë dhe kryesisht me zhavorr, ndërsa gryka e tij është me rërë dhe lym. Ka shumë dredha, ndërsa brigjet e tij dikur ishin të mbushura me drunj. Në pranverë, uji i këtij lumi pushton brigjet pranë lumit. Në anën e majtë të lumit të “Istogut”, gjenden “Shushica” me gjatësi prej 24 km, “Çaushi” 13 km dhe “Gujavçi” me gjatësi prej 26 km. “Shushica” gjatë verës shteret, ndërsa “Çaushi” dhe “Gujavçi” kanë gjithnjë ujë. Lumi i “Istogut” është degë e djathtë e “Drinit të Bardhë”, i cili rrjedh në një pjesë nëpër Komunën e Istogut dhe paraqet kufi natyral në mes të kësaj Komune me Komunën e Pejës. Ky lum rrjedh edhe në Komunën e Klinës dhe Rahovecit, kështu që rrjedhat e ujit të këtyre komunave i përkasin degëve të lumit të “Drinit të Bardhë”.

3.6.1 Burimet

Drini i Bardhë - Nga burimi i “Drinit të Bardhë”, për Komunën e Istogut, kryesisht furnizohet me ujë të pijshëm Lokaliteti i Banjës, duke përfshirë fshatrat: Dubovë e Vogël, Lubovë dhe Carrallukë. Për nevojat e kësaj zone nga Burimi i “Drinit të Bardhë”, i cili është në territorin e Pejës, shfrytëzohen 22 l/s, brenda vitit.

Burimi i Istogut - Nga burimi i lumit “Istog” furnizohen me ujë të pijshëm dhe për ujitje, pjesa dërmuese e banorëve të kësaj komune, të cilët shfrytëzojnë ujë me kapacitet 255,74 l/s. Kapaciteti i Burimit të “Istogut” nga vrojtimet, matjet që janë bërë që nga vitit 1933 e deri me 1941, për të vazhduar nga vitit 1953-59, është konstatuar se rrjedha mesatare e kësaj gurre është 6,6 m³/s, ndërsa varieteti i sasisë së ujit që buron është nga 2,4-8,5 m³/s.

Burimi i Vrellës - Burimi i “Vrellës” furnizon me ujë Vrellën, Stupet, Temalin, Sudenicën, Kaliqanin dhe Orroberden. Për momentin nga ky burim shfrytëzohen 46,72 l/s, kurse kapaciteti i kësaj gurre, sipas vrojtimeve nga viti 1961-63, është 0,12-1,5 m³/s. Ndërsa, mesatarja e kësaj gurre është 1,1 m³/s (1 metër = 1000 litra).

Krojet - Krahas burimeve kryesore nga furnizohen me ujë banorët e Komunës së Istogut, ekzistojnë edhe burimet alternative apo burimet e vogla, përkatësisht krojet e ndryshme nga grumbullohet uji për banorët e lokaliteteve të ndryshme.

Kështu Bashkësia Lokale e Rakoshit me pesë fshatra e njohur, si mbivada, furnizohen me ujë të pijshëm nga krojet në bjeshkët të “Kosharishtes”, “Vojdullit” dhe të “Strofcit”. Në bjeshkët e Kosharishtes uji grumbullohet nga “Kroni i Qajrit”, “Gurrat e Bardha” dhe “Kroni i Xhafes”. Nga bjeshka e Vojdullit, shfrytëzohet “Kroni i Hysen Mulit”, “Kroni i Bajraktarëve” dhe “Kroni i Rrafshit”. Të gjitha këto gjashtë (6) kroje së bashku në vit prodhojnë ujë mesatarisht 7 litra për sekondë, prej nga furnizohen 6 fshatra, një pjesë e Burgut të Dubravës dhe Veriqi. Ndërsa, nga Bjeshka e Strofcit uji grumbullohet, kaptohet, nga “Kroni i Shaba Sejdisë”, “Gurrat e Mëdha” dhe “Kroni i Majës së Madhe”. Të tria këto kroje mesatarisht prodhojnë ujë në vit 4,5 l/s. Burime alternative ekzistojnë edhe në Bjeshkët e Kaliqanit, Rodopoles, Ujmirit etj.

Fshatrat si Sineja, Mojistiri dhe Lagja Avdylaj (Ledina e Mojistirit) furnizohen me ujë të pijshëm nga “Bjeshka e Boavices”, përkatësisht nga Krojet: “Mihanes”, “Cibreli”, “Haxhi Avdylit” etj.



Foto 27. Burimi i Istogut



Foto 28. Penda e burimit në Istog (Në Pranverë)



Foto 29. Burimi i ujit në Vrellë

Përndryshe, në Komunën e Istogut ekzistojnë 320 kilometra ujësjellës, prej nga me ujë të pijshëm furnizohen më se 95 % të popullatës, duke përfshirë këtu, qytetin e Istogut, me qendrat urbane Gurrakoci dhe Banja, me 48 fshatra. Kështu, në bazë të kësaj skeme jashtë rrjetit të ujësjellësit kanë mbetur edhe vetëm katër (4) fshatra, të cilët furnizohen me ujë të pijshëm nga pusët (bunarët) dhe gurrat e ndryshme.

Në kuadër të furnizimit apo të prodhimit të ujit të pijshëm në Njësinë Operacionale në Istog janë këto asete:

- Tetë Depo (Rezervuare) të ujit me kapacitet 700m³, 400m³, 400m³, 800m³, 500m³, 200m³, 400m³, 400m³;
- Katër stacione të pompimit;
- Pesë stacione të klonimit dhe;
- Një rrjetë prej 320 km të dimensioneve prej Ø50 deri në Ø500 gyp sjellës të ujit.

Shërbimi publik për furnizim me ujë.	Gjatësi a e ujës sjellësit në km.	Arkëtim i i pagesave e %	Tarifat e konsumit të ujit në (EUR/m ³).	Sasia e konsumit të ujit m ³ / vit.	Sasia e përdorur nga industria m ³ / ditë.	Konsumi i ujit për banorë m ³ /ditë.	Sasia ujit të përdorur në zona të gjelbëruara m ³ / vit.	Humbjet e ujit brenda sistemit të furnizimit (%).
Nj. Istog "Hidro drini"	320	65	0,27	12.380.000	17.280	0,780	221.617.120	72

3.6.1.1 Cilësia e ujit

Sa i përket ujërave të Komunës së Istogut, burimet janë të mira, me ujë të pastër kimikisht dhe bakteorogjikisht. Këto burime njihen, si burime me ujë të fortë, përkatësisht, si burime të egra, për nga fortësia (ph), meqë rrjedhin nga shkëmbinj të gëlqeror, dhe nuk sedimentojnë (nuk ka gurë) gjatë procesit të vlimit në kufijtë e normales. Në bazë të analizave përkatëse, del se uji i burimeve të Istogut është një ndër ujërat më të pastra, kurse fortësia (ph) e tyre është 7.81. Po ashtu, njihen si ujëra të ëmbla, pa aromë dhe pa ngjyrë. Janë shumë të kërkuara për industrinë e ujërave, si dhe për prodhimin e lëngjeve të ndryshme dhe të birrës. Derisa përdoret për nevojat e publikut dhe menaxhohet nga kompania, në të gjitha këto burime bëhet glorifikimi, si dhe për çdo javë bëhen matjet e gjendjes shëndetësore të ujit. Deri më tani nuk ka pasur rezultate negative. Në bazë të kapacitetit të këtyre burimeve, nëse këto ujëra shfrytëzohen racionalisht, për 100 vjetët e ardhshme i plotësojnë nevojat e banorëve të këtij lokaliteti.

Sa i përket fshatrave që ende nuk janë të përfshira në rrjetin e ujës sjellësit e që për furnizim me ujë shfrytëzojnë bunarët, rregullisht behët analiza bakteorogjike dhe kimike e këtyre bunarëve. Në bazë të analizave që u janë bërë bunarëve, 11 puseve private, 8 ujës sjellësve lokal dhe një pusi të një shkolle, shumica e këtyre bunarëve janë të pastra dhe të përdorshme. Nga 20 mostra bakteorogjike 13 sosh janë dal të kontaminuar me baktere që nuk i përgjigjen standardeve të lejuara, të shprehura në përqindje 65 %. Kurse, nga 20 mostra kimike, dy mostra kimikisht nuk i përgjigjen standardeve të lejuara, të shprehura në përqindje, 10 %.

3.6.2 Burimet e ujërave termominerale:

- Uji termal në Banjë;
- Uji i termal në Studenicë;
- Uji mineral në Banjë dhe;
- Uji mineral në Zabllaq.



Foto 30. Burimi i ujit termomineral në Banjë



Foto 31. Burimi i ujit termomineral në Studenicë

3.6.2.1 Uji termal i Banjës

Burimet e shumta termo-minerale në Kosovë, janë pasojë e aktivitetit intensiv vullkanik dhe proceseve të shumta tektonike në të kaluarën e saj gjeologjike. Në Banjë gjendet Burimi i ujit termo-mineral me një kapacitet 17,5 l/s. Ky ujë ka temperaturë 46 – 48 0C, me mundësi të zgjerimit dhe të shfrytëzimit të kapaciteteve turistike termale. Uji i Banjës ka cilësi shëruese të sëmundjeve reumatike dhe të sëmundjeve të tjera të ndryshme. Përpos Banjës, si vend karakteristik për prezencën e këtyre ujërave, por të kapacitetit më të vogël gjenden edhe në Studenicë.

Banja gjendet në lartësinë mbidetare prej 540 metra, në tarracën bigrene dhe nga të çarat e tokës burojnë disa gurra të nxehta, të vakëta dhe të ftohta minerale. Për nga cilësia e tyre, hyjnë në radhën e ujërave tokësore-alkale, karbo-të tharta dhe me përmbajtje të vogël të sulfurit. Në bazë të mbeturinave të banjës së vjetër dhe të gypave të dheut, është konstatuar se ujërat e Banjës janë shfrytëzuar që nga romakët, pastaj nga sunduesit dhe aristokracia mesjetare e më vonë edhe nga turqit.

Ujërat që gjenden në Studenicë, janë ujëra të vakëta. Këto ujëra sot përdoren nga 30 shtëpi, të cilat më së tepërmi e përdorin për ujitje. Karakteristikat e këtyre ujërave nuk njihen.

3.6.3 Gjendja mjedisore e burimeve të Istogut

Burimi i lumit “Istog” dhe “Vrellë”

- Infrastrukturë e dobët;
- Mungesa e urës që lidh brigjet, rrezik për qytetarë;
- Mungesa e ulëseve për vizitorë;
- Papastërtia e madhe e shtratit poshtë rrjedhës së burimit;
- Mungesa e kontejnerëve për hedhjen e mbeturinave dhe;
- Mungesa e mbrojtjes nga erozioni.

Uji termo-mineral në Banjë

- Ambienti i papastër.
- Shfrytëzim i pamjaftueshëm i potencialeve;
- Këq menaxhimi;
- Promovimi i dobët dhe;
- Kujdes joadekuat nga institucionet komunale.

Uji i nxehtë në Studenicë

1. Mos promovimi;
2. Mungesa e infrastrukturës dhe;
3. Mungesa e iniciativave për projekte nga Komuna dhe donatorët.

Burimet i ujit mineral - Banjë dhe Zabllaq

- Mos promovimi dhe;
- Mungesa e iniciativave për investime.

Lumenjtë

1. Derdhja e ujërave të zeza në lum;
2. Hedhja e mbeturinave;
3. Mos rregullimi i shtratit të lumit;
4. Mungesa e digave për kanale të ujitjes;
5. Vërshimi i tokave punuese dhe i vendbanimeve;
6. Ujë i papastër dhe;
7. Vërshime në vjeshtë dhe dimër.

3.6.4 Menaxhimi i ujërave

Menaxhimi i sistemit të ujësjellësit dhe ujërave të zeza në Komunën e Istogut bëhet nga Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Hidrodrini”, e cila është e licencuar për këtë qëllim. Ndërkaq, menaxhimi dhe mirëmbajtja e sistemit të kanalizimit të ujërave të shiut bëhet nga Komuna e Istogut përmes kontraktorëve të jashtëm.

Gjatë muajve të verës shfaqen probleme në furnizim me ujë, sidomos në pikat kritike të sistemit, sidomos në zonat e larta dhe pikat e largëta. Arsyt kryesore për probleme të tilla konsistojnë në faktin se humbjet e ujit në sistemin e transimit dhe në sistemin distributiv janë në një shkallë jashtëzakonisht të lartë - rreth 60 %. Këto humbje paraqesin ndryshimin ndërmjet sasisë së prodhuar dhe sasisë së faturuar të ujit. Pra, ato përfshijnë humbjet komerciale dhe humbjet fizike/teknike. Proportioni i këtyre dy kategorive të humbjeve nuk dihet saktësisht, por vlerësohet të jetë 50 % / 50 %. Faktorët kryesorë që ndikojnë në shkallën e lartë të humbjeve vlerësohet të jenë: rrjeti i vjetruar i ujësjellësit, kyçe ilegale, mos-matja e saktë e ujit.

Trajtimi i ujit të pijes bëhet me sistemin e dezinfektimit, në formën që në burimet e ujit ekzistojnë stacionet e klorimit, ku klorohet uji konform standardeve të përcaktuara me dispozitat ligjore. Sistemi i furnizimit me ujë është i ndarë në dy (2) zona: (I) zona e epërme, që furnizohet me ujë përmes sistemit të pompimit dhe (II) zona e poshtme, që furnizohet me ujë me rrjedhje me gravitacion.

Duke pasur parasysh rëndësinë e infrastrukturës së ujësjellësit, ujërave të zeza dhe ujërave të shiut për kualitetin e jetës, mirëqenien e popullatës dhe për zhvillimin ekonomik dhe social të Komunës, padyshim që Komuna ka një rol të rëndësishëm në zhvillimin e kësaj infrastrukture. Kjo para së gjithash nënkupton interesin dhe përgjegjësinë e Komunës për ofrimin e shërbimeve cilësore për pjesën e përfshirë të popullatës me këto shërbime, dhe po ashtu edhe për zgjerimin e infrastrukturës dhe krijimin e kushteve për përfshirjen e zonave aktualisht të pambuluara me shërbimet e ujësjellësit dhe ujërave të zeza. Rrjedhimisht planet zhvillimore dhe urbanistike të Komunës duhet të harmonizohen me planet e investimeve kapitale për rehabilitimin dhe zgjerimin infrastrukturës në territorin e saj administrativ.

Në këtë kontest, Grupi punues, vlerëson se projektet për ujësjellësit dhe ujërave të zeza, të jenë rezultat i konsultimeve me KRU “Hidrodrini” dhe të korrespondojnë me planet investimeve të kësaj kompanie, duke qenë, po ashtu, në korrelacion me planet zhvillimore të Komunës së Istogut. Në anën tjetër, infrastruktura e kanalizimit të ujërave të shiut është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e Komunës, për të cilën nuk ekziston një kompani publike e as departament komunal i veçantë përgjegjës për menaxhim dhe mirëmbajtjen e saj. Si pasojë e saj mungojnë pasqyra e plotë e gjendjes ekzistuese dhe projektet e planifikuara.



Foto 32. Kanalet e ujitjes (nga burimi Istog)



Foto 33. Menaxhimi i ujërave-porta ndarse

3.6.5 Mbrojtja e ujërave nga ndotja

Sistemi i kanalizimit për qytetin e Istogut është ndërtuar në vitin 1972, 2004, 2008 në gjatësi 20.900 m, si sistem i tipit të ndarë: sistem i veçantë për largimin e ujërave të zeza nga sistemi i largimit të ujërave të shiut. Rrjeti i kanalizimit në Gurakoc të ujërave të zeza ka filluar të ndërtohet në vitin 1994, 2007 në gjatësi prej 17.200 m.

Problemet kryesore që kanë të bëjnë me rrjetin e kanalizimit të ujërave të zeza në Komunën e Istogut janë:

1. Mos-përfshirja e disa zonave urbane të qytetit;
2. Mos-përfshirja e zonave rurale dhe;
3. Dimensionet jo-adekuate të rrjetit (si pasojë e rritjes së popullatës).

3.6.6 Kanalizimi

Qyteti i Istogut ka vetëm rrjetin e kanalizimit fekal, përderisa mungon ai atmosferik. Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit është bërë pa ndonjë planifikim të mirëfilltë, varësisht prej nevojave të kohës dhe mjeteve materiale në dispozicion. Si pasojë është se dimensionet e gypave janë joadekuate dhe në shumë vende sjellin probleme të caktuara. Gjithashtu, edhe mirëmbajtja e rrjetit është shumë i vështirësuar. Vështirësi sjell edhe mos pagesa e rregullt e qytetarëve për shërbime. Si në çdo vend në Kosovë edhe në këtë rast rol dominues në shpërndarjen e rrjetit të kanalizimit, ka luajtur konfiguracioni i terrenit. Kështu të gjitha ujërat e zeza, pa përjashtim, shkarkohen në lumit e qytetit, në Istog. Shkarkimi i ujërave të zeza bëhet pa ndonjë trajtim paraprakë duke e ndotur ujin e lumit.

Infrastruktura e ujësjellësit dhe kanalizimit në Komunën e Istogut është joadekuate, si në kuptimin e cilësisë së saj, po ashtu edhe në kuptimin e shtrirjes së pamjaftueshme të saj. Kjo situatë ka për pasojë shërbime jocilësore të popullatës me shërbimet vitale, siç janë furnizimi me ujë dhe shërbimet e kanalizimit. Për më tepër një infrastrukturë e këfillë joadekuate dhe në rastin e kanalizimit të ujërave të shiut dhe impiantit të ujërave të zeza, mungesa e plotë e infrastrukturës ka pasojë mjedisore dhe sigurisht që paraqet pengesë për zhvillimin ekonomik dhe social të Komunës.

Tabela 14. Pesë problemet kryesore në fushën e mjedisit në Komunën e Istogut

	Zhurma	Mbeturi nat komunal e	Ujërat e zeza	Mungesa e shërbimeve komunal e	Rrugët jo të mira lokale, shtigjet, mungesa e parkingjeve	Mungesa e informave dhe transparenca	Mos mirëmbajtja e zonave të gjelbra, parqeve dhe shiritave mbrojtës	Mbrojtja e pasurive dhe vlerave natyrore	
Gjinia	Meshkuj	102 20.4%	175 35.0%	167 33.4%	69 13.8%	91 18.2%	95 19.0%	108 21.6%	91 18.2%
	Femra	103 20.6%	171 34.2%	144 28.8%	87 17.4%	64 12.8%	96 19.2%	110 22.0%	82 16.4%
Total		205 41.0%	346 69.2%	311 62.2%	156 31.2%	155 31.0%	191 38.2%	218 43.6%	173 34.6%

3.6.6.1 Masat që duhet ndërmarr

a. **Rehabilitimi i rrjetit ekzistues të kanalizimit të ujërave të zeza**

Rrjeti ekzistues i kanalizimit të ujërave të zeza është tejkaluar në kuptim të periudhës projektuese, meqenëse i njëjti është ndërtuar për periudhën projektuese deri në vitin 1990. Rrjedhimisht, dimensionet e tubacioneve të rrjetit janë joadekuate (të pamjaftueshme) për numrin aktual të popullatës së Istogut. Kjo ka për pasojë bllokimet e shpeshta të kolektorëve (pusetave) të kanalizimit dhe përmbytjet e rrugëve dhe pronave të qytetarëve.

Prandaj, rekomandohet të bëhet modelimi hidraulik i rrjetit ekzistues që do të shërbente si bazë për ri-disejnimin e këtij rrjeti dhe hartimin e projektit zbatues që do të përmbushte nevojat e popullatës deri në vitin 2036.

Bazuar në konfiguracionin gjeografik të Komunës së Istogut dhe në studimet për këtë çështje nga hartuesit të Planit Zhvillimor Komunal, na mundëson që sistemi i ujërave të kanalizimit të evakohet (grumbullohet) me gravitet dhe në 4 kemi katër (4) zona (pellgje) të grumbullimit. Grumbullimi i tërësishëm i ujërave të zeza pothuaj i tërë vendbanimeve të KK-Istog do të përfundonin në fshatin Zabllaq, ku parashihet trajtimi i tyre.

b. **Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit të ujërave të zeza**

Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit të ujërave të zeza në zonat urbane që aktualisht nuk janë të përfshira, e duke u bazuar në Planin Zhvillimor dhe Urban të Istogut është konstatuar edhe nga Grupi punues, si një prioritet i lartë dhe parakusht bazik për zhvillimin e Istogut.

Ndikimet negative në ujëra janë kryesisht nga derdhjet e kanalizimeve të ujërave të zeza, të cilat nuk janë të trajtuara paraprakisht. Me planin e ri parashihet integrimi i infrastrukturës së kanalizimit të ujërave të zeza dhe ndarja e kanalizimit atmosferik, i cili mund të derdhet në lumenj. Po ashtu, është paraparë ndërtimi i një impianti kryesor apo si alternativë - Impiant lokal, apo si nënstacion, para lidhjes së impiantit kryesor që parashihet të ndërtohet në Komunën e Pejës, varësisht në koordinim mes dy komunave, si dhe politikave institucionale, në këtë rast me Ministrin e Planifikimit Hapësinor dhe Mjedisit.

Përveç eliminimit të ndotjes me mbeturina të shtretërve të lumenjve, masat për mbrojtjen nga vërshimet kanë paraparë parandalimin e ndikimeve negative të rritjes së sasisë së ujit nëpër lumenjtë dhe përroskat e Komunës së Istogut.

Komuna duhet të hartojë dhe nënshkruajë një marrëveshje mirëkuptimi me prodhuesit e peshkut, pasi që ujërat nga hurdhata derdhen në lumenj dhe ujërat e tilla ndotin ujin e lumenjve. Matja e rregullt e sasisë së ndotjes do të mundësojë veprimet adekuate. Po ashtu, Komuna duhet t'i obligojë këta prodhues që ta mirëmbajnë sasinë e ujërave në kanalet e ujitjes prej nga furnizohen me ujë hurdhata e peshqve, për të mos e cenuar ujitjen e arave që është komponentë esenciale e prodhimit të suksesshme bujqësore.

Prandaj, është e nevojshme që institucionet përgjegjëse Komuna e Istogut dhe KRU "Hidrodrini" të harmonizojnë veprimet e veta për planifikimin dhe për shqyrtimin e formave dhe mundësive për financimin e investimeve të cilat janë identifikuar dhe përpunuar me këtë dokument, dhe të cilat konsiderohen të domosdoshme për ndërtimin e një infrastrukture funksionale dhe cilësore të ujësjellësit dhe kanalizimit.

Konkluzionet:

- Trajtimi jo adekuat i ujërave të zeza, përkatësisht shkarkimi i ujërave të zeza pa trajtimin e tyre në lumenj;
- Problemi sanitar i mbledhjes dhe largimit të pamjaftueshëm dhe joadekuat të ujërave të zeza;
- Mos-kycja në kanalizim i të gjitha lagjeve të qytetit;

- Hedhja e mbeturinave në kanale të ujitjes;
- Përmbytjet e shpeshta në disa pjesë të qytetit;
- Mbulimi me këtë shërbim është ende i pamjaftueshëm në rajonin rural dhe;
- Mungesa e pajisjeve për trajtim të ujerave të zeza dhe mungesa e impianteve lokale biofushore në zonat rurale.

Veprimet:

- Rehabilitimi i rrjetit ekzistues të kanalizimit të ujërave të zeza;
- Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit të ujërave të zeza;
- Ndërtimi i rrjeteve të ndara për kanalizim të ujërave të zeza dhe atmosferike në qytet;
- Ndërtimi i sistemit të kanalizimit kolektiv në zonat rurale-trajtimi biofushor dhe;
- Ndërtimi i kanaleve të hapura për ujërat atmosferik në zonat rurale.



Foto 34. Impianti për pastrimin e ujërave të zeza në Bajicë



Foto 35. Kolektori për pastrimin e ujërave (planifikuar të ndërtohet në Zallq)

3.6.7 Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore

Istogut shquhet me hidrografi të zhvilluar. Lumenjtë kryesor janë: lumi i “Istogut”, lumi i “Vrelës” dhe “Drini i Bardhë”. Përveç këtyre lumenjve, ekziston edhe një numër i konsiderueshëm i rrjedhave më të vogla të përhershme dhe të përkohshme, si: “Përroi i Keq”, “Shushica”, “Çausi”, “Gujavçi”, “Bllagaqa” dhe lumi i “Renovaqes”.

Istogu, po ashtu, ka sasi të mëdha të ujit nëntokësor, i cili e ka rrjedhën e vet nëntokësore paralele me rrjedhat sipërfaqësore. Fal lartësisë së ulët mbidetare 350-450 metra mesatarja, lugina e lumenjve në mes “Drinit” e “Istogut” llogaritet ndër rajonet më të favorizuara të Ballkanit, në aspektin klimatik. Këtu depërtojnë, përmes luginës së “Drinit të Bardhë”, rrymat mesdhetare të cilat e favorizojnë zhvillimin e vegjetacionit bimor. Është e rëndësishme të thuhet se ujërat e kësaj treve, burojnë nga “Bjeshkët e Nemuna” dhe nga “Bjeshkët e Thata” dhe “Moknes”, bjeshkë që kanë pjerrtësi të ramjes nga përendemi në lindje, kurse rrafshi ka ngritje nga përendemi në lindje, gjë që krijon pellg, përkatësisht ujëmbledhës që për rajonin e Dukagjinit ka sasira të mjaftueshme të ujit, si sipërfaqësore ashtu edhe nëntokësore. Të gjithë këtë e mundëson Podi (Shtrati), përkatësisht shtresa e shtratit të këtij pellgu i cili është mbajtës i mirë i ujërave.

Ujërat nëntokësore nuk shfrytëzohen për furnizim të ujësjellësit, por shfrytëzohen për pije nga pusët (bunarët) familjare, si dhe për ujitje të tokave bujqësore. Këto ujëra janë të ndotura në mënyrë indirekte nga përdorimi i plehrave minerale dhe pesticideve, por në një masë të vogël. Ujërat nëntokësore më së tepërmi ndoten nga derdhjet e ujërave të zeza, operatorë të tjerë ndotës të mjedisit, si thertoret, pastaj punuesit e masës së asfaltit etj.

3.7 Biodiversiteti

Të dhënat flasin se vetëm ne 100 vitet e fundit, zhdukja e specieve e shkaktuara nga njeriu është shtuar rreth 1000 here. Po ashtu, rreth 12 % e shpendëve, 23 % e gjitarëve, 25 % e haloreve dhe 32 % e ujë-tokësorëve kërcënohen për zhdukje, ndërkaq që rezervat peshkore të botës janë reduktuar deri në 90 %, që nga fillimi i industrisë së peshkimit.

Ekspertët supozojnë se nëse do të vazhdohet me këtë trend, humbja e biodiversitetit do të ketë pasoja fatale për njerëzimin. Vlerësimet e fundit shkencore parashikojnë se, me ritmet e sotme të shpyllëzimeve, brenda 25-30 vjetëve të ardhshëm do të zhduken deri në 10 % te llojeve të njohura në planet. Pasojat e kësaj humbje do të reflektohet edhe në ekonominë botërore dhe në zhvillimet shoqërore në përgjithësi, duke pasur parasysh faktin se afro 40 % e ekonomisë botërore dhe 80 % e nevojave të njeriut plotësohen nga resurset biologjike.

Për të tejkaluar këtë situatë nevojitet të veprohet sa më shpejtë që është e mundur në hartimin strategjisë për biodiversitetin, miratimi i ligjeve, rregulloreve dhe aspekteve të tjera ligjore për mbrojtjen e biodiversitetit, forcimin e institucioneve që merren me çështjet e mbrojtjes së natyrës dhe biodiversitetit, organizimin e fushatave për vetëdijësimin e komunitetit mbi rëndësinë e biodiversitetit etj.

Në “Bjeshkët e Nemuna” gjenden lloje të gjitarëve dhe shpendëve që janë mjaft të rralla për rajonin e Ballkanit dhe më gjerë. Prej tyre ka relikte, endemike, të kërcënuara nga zhdukja dhe për këtë arsye gjenden në listat dhe në librat e kuq ndërkombëtarë.

Llojet më reprezentative të faunës së “Bjeshkëve të Nemuna”, duke përfshirë në këtë mes edhe “Bjeshkët e Istogut” me “Moknen”, janë: rrëqebulli (*Lynx lynx*), ariu i murrmë (*Ursus arctos*), kaprolli (*Capreolus capreolus*), dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*), shqiponja perandorake (*Aquila heliaca*), shqiponja e maleve (*Aquila chrysaetos*), fajkoi thonjëbardhë (*Falco naummani*), pulegra (*Tetrao urogallus*) etj., kanë status kombëtar dhe ndërkombëtar të mbrojtur. Ato gjenden në listën e IUCN-së (Unioni botëror për ruajtjen e natyrës), EU-RL (Lista e kuqe Evropiane), ËR-RL (Lista e kuqe botërore), LKSH (Libri i kuq i Shqipërisë), LKGJ (Ligji i Kosovës për Gjuetinë) etj.

Në “Bjeshkën e Thatë” dhe “Mokën” jeton ariu i murrmë. Në tërë Kosovën është llogaritur të jenë 110 të tillë. Në “Mokën”, po ashtu, haset në numër të madh edhe derri i egër, i cili është shtuar sidomos në këto dhjetë vitet e fundit për shkak të mos daljes në bjeshkë të barinjve. Kaprolli është autokton, është i përfaqësuar jo vetëm në pyjet kodrinore dhe viset e rrafshëta, por edhe në viset e maleve të larta të gjuetisë. Në këto masive jeton pulegra e madhe, lloj të cilit i kanoset zhdukja. Po ashtu, e përhapur është edhe pula e pyjeve. Në “Bjeshkët e Thata” dhe “Mokën” gjendet edhe fëllanëza e maleve, pastaj sokoli etj.

Në ujërat e lumit të “Istogut” rriten këto lloje të peshqve: bërcaku, mustaku, ngjala, trofta, trofta e prorojeve, krapuliqi, dylmori dhe trofta e Danubit. Në këta lumenj ka edhe gaforre, bretkosa dhe breshka. Lumenjtë në përgjithësi, nëpër periudha i ka karakterizuar ndotja nga nxjerrja e rërës dhe zhavorrit, gjë që ka ndikuar në popullatën e peshqve, shembjen e pjesëve të bregut dhe ndryshimit të drejtimit të ujit. Sot lumenjtë karakterizohen me ndotje nga mbeturinat e amvisërisë.

Në Istog është e ndërtuar hurdha për kultivimin e troftës së Kalifornisë. Ndërsa, në tërë Ko-



Foto 36. Sqarthi



Foto 37. Kaprolli



Foto 38. Shqiponja

munën ka rreth 6 ha sipërfaqe ujore të fermave së peshqve-hurdhave.

Nga kafshët shtëpiake rriten kryesisht: lopët, dhentë, derrat, kuajt dhe shpezët.

Ruajtja e këtyre llojeve duhet të jetë një ndër aktivitetet më të rëndësishme të Strategjisë për Mbrojtjen e Biodiversitetit.

Në Regjionin e “Bjeshkëve të Nemuna”, ku futen edhe “Bjeshkët e Moknes”, si rajoni lindor i këtyre vargmaleve, si dhe Komuna e Istogut, ekzistojnë më se 797 lloje të bimëve të ndryshme, pas-taj lloje të ndryshme të florës dhe faunës.

Po ashtu, ky rajon është i pasur edhe me një llojllojshmëri të bimëve mjekuese. Mirëpo, dita e ditës jemi dëshmitarë me problemin e humbjes së biodiversitetin dhe shkaktari kryesor që ka kërcënuar ekzistencën e shumë llojeve bimore dhe shtazore padyshim është faktori njeri. Ndërkaq, shpyllëzimet masive, shfrytëzimi intensiv i tokës, ndotjet e ajrit, ujit dhe gjuetia e pakontrolluar, janë vetëm disa nga faktorë të tjerë që vazhdojnë të rrezikojnë biodiversitetin. Nga të gjitha këto, humbja sipërfaqeve pyjore që ka përfshirë me të madhe ekosistemin natyror është një nga problemet me emergjente për natyrën e Istogut.

Reduktimi i sipërfaqeve pyjore dhe degradimi i vazhdueshëm i tyre ka ardhur kryesisht si pasojë e shfrytëzimit pa kriter të zonave pyjore. Kafshët e rralla, si: rrëqebulli, ariu i murrmë, kaprolli, dreri, dhia e egër etj., janë të rrezikuara dhe kanë filluar të pakësohen, si pasojë e dëmtimit dhe ndryshimeve në habitate të tyre, gjuetisë së pakontrolluar, varfërimit dhe degradimit të ekosistemeve, erozionit dhe shpyllëzimit. Për llojet shtazore është shqetësuese, sidomos gjuetia e ushtruar gjatë periudhës së riprodhimit, ndërsa për llojet bimore grumbullimi i tyre gjatë fazës së lulëzimit.

Për të tejkaluar këtë situatë, nevojitet:

- Të hartohet një strategji për biodiversitetin;
- Miratimi i ligjeve përkatëse për këtë lami dhe implementimi i tyre;
- Organizimi i fushatave për vetëdijesimin e komunitetit mbi rëndësinë e biodiversitetit etj.;
- Oferta turistike për zhvillimin e turizmit në përgjithësi dhe;
- Zhvillimin e turizmit të gjuetisë të koncentruar në ato vende, të cilat janë të pasura me lloje.

3.7.1 Peizazhet

Komuna e Istogut është e pasur me peizazhe natyrore të llojeve të ndryshme: peizazh kodrinor, peizazh bujqësor, peizazh rural, peizazh i livadheve, peizazh lumor. “Bjeshkët e Istogut” njihen për peizazhe të bukura dhe atraktive të cilat njehërit shfrytëzohen për kullosa të bagëtive dhe vend verime të blegtorëve. Peizazhet më të njohura janë: “Gurrat e bardha”, “Livadhet e Istogut”, “Bollovani”, “Bajshja”, “Radusha”, “Vuqa”, “Rudina”, “Kosharishta”, “Vojdulla”, “Mokna”, “Shymeku”, “Cerrovoda”, “Lugu i Butë”, “Lugu i Zajmit”, “Koreniku”, “Lugu i Madh”, “Kodra e Dynes”, “Gurra”, “Klopqani”. Peizazhet më atraktive të cilat mund të shfrytëzoheshin edhe për ndërtimin e qendrave turistike janë: “Mokna”, “Gurrat e bardha”, “Livadhet e Istogut”, “Lugu i Butë”, “Radusha”.

3.7.2 Shpella

“Bjeshkët e Istogut” janë të njohura edhe Maja të maleve dhe shpella të shumta që gjenden në këtë rajon. Majat e maleve janë: “Maja e Zezë”, “Koreniku”, “Mokna”, “Sejnova”, “Vojdulla”, “Rudina”, “Maja e Legjenices”. Janë evidentuar më se 24 shpella, mirëpo deri më tani ende asnjëra prej tyre nuk është hulumtuar në mënyrë shkencore, gjë që në të ardhmen do të duhej të bëhej hulumtimi i tyre. Në këtë mes më të njohura janë: “Shpella e Keqe”, “Shpella e Tershanit”, “Shpella Shkëmbi i zhveshur”, “Shpella e Sinesë”, “Shpellat Binake”, “Shpella e Majës së Legjenices”, “Shpella e Golakut”, “Shpella e Hoxhës”, “Shpella e Hutit” etj.

3.7.3 Bota shtazore dhe bimore

Shtazët dhe shpezët e egra - Ariu, ujku, derri, kaprolli, dhia, lepuri, dhelpra, çakalli, kitara, jazbaci, bukla, pula, qura, fllanxa, shqiponja, qyqja, qukapiku, bilbili etj. Në “Bjeshkët e Istogut” rriten edhe disa lloje të gjarpinjeve helmues, si: Gjarpri me zile, gjarpri me topa, pastaj jo helmues, si breva dhe bolla. Mirëpo, shumë prej këtyre llojeve të kafshëve janë të rrezikuara nga gjuajtjet e paligjshme. Sipas shënimeve të Shoqatës së gjuetarëve “Gurrat e Bardha” në Istog kësaj çështje i kushtohet rëndësi të madhe dhe ata e përcjellin situatën e orareve për gjuajtje të parapara me ligj.

Tabela 15. Lloji i kafshëve të gjuajtura me leje

Nr.	Lloji i kafshëve të gjuajtura me leje	Sasia (numri) në vit
1.	Lepuri	70
2.	Derri i egër	4
3.	Ujku	18
4.	Dhelpra	16

Bimët mjekuese – “Bjeshkët e Istogut” të cilat janë edhe vazhdimësi e “Bjeshkëve të Nemuna” janë të pasura me lloje të ndryshme të bimëve mjekuese e që në popullatë njihen me emra popullore: Anguliqja, Thundër Mushka, Murrizi, Gjethe Dielli, Bar Pezmi, Krasta, Rigoni, Menta, Boronica, Gllijat, Hitha, Bar Blete, Ruta, Lincuri, Shushorka, Pelini, Mjedrra, Dredhza, Kamomili, Mollaga, Rrodhezja, Qakorrja, Kamfuri, Breza, Kinfusha, Sherbeli, Kleka, Grami, Bar Pate, Lule Kaqe, Molla e Egër, Shtogu, Lena, Valerina, Bukë Arushe etj.

3.7.4 Trashëgimia natyrore

Në territorin e Komunës së Istogut nuk është asnjë zonë apo tërësi me vlerë të veçantë natyrore me status të mbrojtur edhe pse në territorin e saj shtrihet një pjesë e “Bjeshkëve të Nemuna”, “Bjeshka e Mognës”, disa burime të ujit termal dhe natyral, si dhe shumë monumente të tjera të natyrës me vlerë natyrore. Gjatë vitit 2002-2003, nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës është punuar studimi për arsyeshmërinë e shpalljes së “Bjeshkëve të Nemuna” si Park Kombëtar. Ky Park Kombëtar do të përfshinte një sipërfaqe prej 5065 ha të Komunës së Istogut. Mirëpo, ky propozim përfshinë vetëm një pjesë të “Bjeshkëve të Istogut”, duke lënë kështu jashtë “Bjeshkën e Mognës” dhe “Bjeshkët mbi Cerrcë dhe Istog”. Sipërfaqja totale e objekteve apo tërësive me vlera të veçanta natyrore të evidentuara në tërë territorin e Komunës, është 8976.497 ha. Me vënien nën mbrojtje, rreth 20 % e tërë territorit të Komunës do të ishte zonë e mbrojtur.



Foto 39. Trungu i rrënjës ne Trubuhoc (Quercus robur)



Foto 40. Kompleksi i trungjeve të bung- butes (Quercus sp) Sine

Tabela 16. Monumentet e natyrës – Istog

Nr	Emërtimi	Vendi-Lokacioni	Kategoria e mbrojtur
1.	Dy trungje të manit të zi (Morus sp.) (Skamat).	Cercë	Kategori e III-Monument i Natyrës i karakterit botanik.
2.	Trungu i blirit të argjend (Tilia sp.).	Lubozhdë	Kategori e III-Monument i Natyrës i karakterit botanik.
3	Burimi ujit natyral.	Vrellë	Kategori e III -Monument i Natyrës i karakterit hidrologjik.
4	Trungu i blirit të kuq(Tilia sp).	Istog i Poshtëm	Kategoria e III -Monument i Natyrës i karakterit Botanik.
5.	Kompleksi i trungjeve të bungëbutës (Quercus sp).	Sine	Kategoria e III-Monument i Natyrës i karakterit Botanik.
6.	Trungu i blirit të argjenditë.	Shushicë e Epërme	Kategoria e III -Monument i Natyrës i karakterit Botanik.
7.	Burimi i ujit natyral.	Istog	Kategoria e III -Monument i Natyrës i karakterit hidrologjik.
8.	Trungu i Vadhës (Vojsa) (Sorbus sp).	Uçë	Kategoria e III -Monument i Natyrës i karakterit Botanik.
9.	Trungu i blirit të argjend (Tilia sp.).	Kaliqan	Kategoria e III -Monument i Natyrës i karakterit Botanik.
10.	Burimi i ujit termal.	Banjë	Kategoria e III-Monument i Natyrës i karakterit hidrologjik.
11.	Trungu i blirit të kuq (Tilia sp.).	Lubovë	Kategoria e III -Monument i Natyrës i karakterit Botanik.
12.	Trungu i rrënjës (Quercus robur).	Zallq	Kategoria e III-Monument i Natyrës i karakterit Botanik.
13.	Trungu i rrënjës (Quercus robur).	Trubuhoc	Kategoria e III-Monument i Natyrës i karakterit Botanik.
14.	Trungu i rrënjës (Qurcus robur).	Saradran	Kategoria e III-Monument i Natyrës i karakterit Botanik.
15.	Trungu i rrënjës (Qurkus robur).	Gurrakoc	Kategoria e III-Monument i Natyrës i karakterit Botanik.

7.4.1 Mokna

“Mokna” e cila ka sipërfaqe 6.782 ha, dhe e cila shtrihet në territorin e Mitrovicës dhe Istogut, ka qenë e propozuar nga Enti Krahinor për Mbrojtjen e Natyrës, të shpallet Park i Natyrës me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës. Sipërfaqja e tërësishme në territorin e Komunës së Istogut e cila ishte propozuar si Park i Natyrës është 3.905,41 ha dhe shtrihet në gjashtë komuna kadastrale (Zhakovë, Uçë, Shushicë, Cercolez, Mojstir, Syrigonë). Nga kjo sipërfaqe, nën pyje gjinden 1.737.18 ha, nën livadhe 460.58 ha, nën kullosa 1.685.81 ha dhe sipërfaqe tjera 21.84 ha.

Ky territor, me vlerat e tij siç janë: peizazhi natyror, relievi, përbërja gjeologjike, klimatike dhe karakteristikat hidrografike, flora, mbuloja vegjetative dhe fauna, paraqet territor me vlera natyrore dhe estetike dhe ka rëndësi arsimore, shkencore, turistike, rekreative, prandaj në tërësi i plotëson kushtet për mbrojtje si park i natyrës. Fauna është mjaft e zhvilluar e disa lloje janë shumë të rralla, si ariu i murrmë, rrëqebulli, pulegra, kaprolli, macja e egër, dreri, dhia e egër, ketri etj. Shumica prej tyre, janë lloje të rrezikuara dhe gjinden në librat dhe listat e kuqe ndërkombëtare. Ka lartësi mbidetare mbi 1300 m, ndërsa disa maje ngritën edhe mbi 1800 m.



Foto 41. Liqeni i “Moknës”




Foto 42. Peizazh nga “Bjeshka e Moknës”

3.7.4.2 Ruajtja e trashëgimisë natyrore

Për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë natyrore është e nevojshme që “Bjeshkët e Nemuna” të shpallen Park Nacional. Me këtë do të vendosej një regjim i caktuar i zhvillimit, ku do të bëhej regjenerimi i mjedisit të degraduar si dhe shfrytëzimi për qëllime turistike. Me këtë Biodiversiteti dhe resurset natyrore me vlerë do të mbroheshin me çdo kusht. Parku nacional mund të shfrytëzohet për aktivitete edukative, shkencore, kulturore, shpirtërore dhe aktivitete rekreative, duke respektuar parimet e mbrojtjes së natyrës. Kuvendi komunal i Istogut ka kërkuar që edhe territori i “Bjeshkëve të Istogut” të futet në kuadër të projektit për shpalljen e “Bjeshkëve të Nemuna” Parka nacional. Është kërkesë edhe Grupit punues komunal për hartimin e PLVM-së është që edhe “Bjeshkët e Istogut” të përfshihen në projektin për Shpalljen e “Bjeshkëve të Nemuna” Park Nacional, me qëllim të ruajtës dhe mbrojtës së tyre sidomos të ruajtjes së biodiversitetit.

Konkluzionet:

Me qëllim të vendosjes së kontrollit dhe rregullit hapësinor dhe menaxhimit urban, KK i Istogut ka miratuar dokumentin e PZHK dhe PZHU, por jo dhe PRRU.

Nga të dhënat e marra nga organet kompetente të Komunës dhe nga dokumenti i PZHK dhe PZHU shihet se Komuna e Istogut nuk ka të dhëna për:

- Sipërfaqen e hapësirave të shërbimeve publike;
- Sipërfaqen e shndërruar të tokave bujqësore në toka ndërtimore;
- Sipërfaqen e pyjeve të djegura nga zjarret;
- Për monitorimin e cilësisë së tokës;
- Sipërfaqen e zonave industriale;
- Sipërfaqet e vërshuara dhe;
- Kapacitetet turistike.

Nga pikat e sipërshënuara vërehet se Komunës, megjithatë, i mungojnë të dhëna të rëndësishme të cilat do të ndikojnë në përgatitjen e projekteve të mirëfillta me qëllim të zhvillimit më të shpejtë ekonomik dhe përmirësimit të kualitetit të jetës së qytetarëve, si dhe përgatitjen e projekteve për mbrojtjen e resurseve natyrore dhe biodiversitetit.

Prandaj, rekomandohet që Komuna të:

- Siguroj të dhënat e plota për pikat e sipërshënuara;
- Përgatisë projektet për rritjen e sipërfaqeve gjelbëruese në suazë të zonave urbane të qytetit;

- Përgatisë planet detale (rregulluese) urbanistike për të gjitha zonat e qytetit;
- Përgatisë planet rregulluese urbane për qendrat dytësore të parapara me PZHU;
- Mbrojë dhe ruaj tokat bujqësore, duke përgatitur planet e hollësishme urbane dhe orientimin në ndërtim të larta;
- Bashkëpunojë me MBPZHR për certifikimin e pyjeve private;
- Përgatis projektet për ripyllëzimin e sipërfaqeve të dëmtuara;
- Përgatisë projekte për vetëdijësimin e popullatës për mbrojtjen e vlerave të biodiversitetit;
- Përgatisë projektet për kufizimin e erozioneve dhe;
- Kontrollujë gjuetinë përmes Shoqatës së Gjuetarëve dhe mekanizmave të tjerë.

3.7.5 Trashëgimia kulturore

Territori i Komunës së Istogut ka trashëgimi të pasur kulturore, materiale dhe shpirtërore. Ky territor i përket krahinës etnografike të Podgurit, i cili ka qenë i banuar që nga parahistoria. Dëshmi për këtë janë disa varreza tumulare dardane, qytete dhe rrugë antike, si dhe material i konsiderueshëm arkeologjik i gjetur. Gjurmët e para të banimit të kësaj treve, të gjetura deri sot, i takojnë kohës së neolitit të vonë (mijëvjeçari i VI p.e.s.- sëpata e strallit e gjetur në Rakosh).

Edhe pse stacionet shpellore nuk janë hulumtuar, duket se edhe shpellat e shumta të Kosovës kanë qenë stacione banimi gjatë kohës së paleolitit dhe mezolitit (zbulime të tilla priten të bëhen me hulumtimin e shpellave). Kërkimet në këtë drejtim mendohet se do të jenë të favorshme, duke u mbështetur te numri i madh i vendbanimeve të epokës vijuese të dhe të një kulture mjaft të begatshme të saj. Interesimi i parë për qendrat arkeologjike filloi në shekullin XIX, ndërsa studiuesi i parë që realizoi një ekspeditë arkeologjike gjatë Luftës së Parë Botërore ishte Budaj Arpad. Gjatë viteve '60-të dhe '70-të, me vendime të posaçme janë futur nën mbrojtje 14 monumente kulturore. Në periudhën gusht-shtator 2000, është bërë një hulumtim i gjendjes së 49 kullave në Komunën e Istogut, të udhëhequra nga Sahar Rassam (arkitekt) - zyrtar për çështje të banimit në Misionin e Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë.

Gjatë vitit 2002, është bërë inventarizimi i trashëgimisë kulturore të paluajtshme në Komunën e Istogut. Nga Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore në Gjakovë, ku janë evidentuar gjithsej 116 monumente të kulturës, prej të cilave lokalitete arkeologjike (9), kisha ortodokse mesjetare (4), xhami (8), mejtepe (3), kulla (72), ura (1), mulli (13), sharrë me ujë (1), kosha dhe hambar (5).

Në prill të vitit 2005, Instituti Arkeologjik i Kosovës në bashkëpunim me sektorin e Muzeut dhe Arkeologjisë të Komunës së Istogut, realizoi ekspeditën e evidentimit të vend gjetjeve arkeologjike në territorin e Komunës së Istogut. Gjatë kësaj ekspedite u evidentuan rreth 30 vend gjetje arkeologjike të cilat kanë një shtrirje kohore nga neoliti i vonë e deri në mesjetë. Gjykuar nga materiali arkeologjik, del se Podguri, si pjesë integrale e Dardanisë antike, ishte i banuar shumë herët.



Foto 43. Themelet e Kalasë së Sudenicës



Foto 44. Portat e Kullës së Ramë Ali Bicaj

3.7.5.1 Trashëgimia arkitektonike

Periudha Parahistorike

Lokalitete arkeologjike të huluntuara

Banja - Tuma princore prej dy pjesësh, i takon periudhës mes shekujve VI-V p.e.s. E zbuluar rastësisht në vitin 1974, gjatë kryerjes së punëve ndërtimore në kompleksin hotelier, ndërsa hulumtimet arkeologjike janë bërë po atë vit nga Muzeu i Kosovës.

Bajica - Tumë e fiseve dardane, e huluntuar në vitin 1979 nga arkeologët e Muzeut të Kosovës, ku u gjetën 18 varre, bashkë me disa ekspozate arkeologjike me vlerë. Varri qendror i takon kohës së bronzit (XVIII-VIII p.e.s.). Të 17-të varret e shtresës së epërme të tumës i përkasin periudhës mesjetare të shek. XII-XIII, ndërsa monedhat e gjetura aty janë të periudhës romake mes shek. III-IV të e.s.

Lokalitete arkeologjike të evidentuara

Rakoshi - Janë gjetur gjurmët më të vjetra të vendbanimit në territorin e Komunës së Istogut dhe bashkë me Runikun (Ilironi i dikurshëm), konsiderohet të jenë vendbanimet më të hershme të zbuluara deri sot në Kosovë. Një sëpatë stralli e gjetur në Rakosh dëshmon për rrënjët e civilizimit ilir para më së paku 5500 vitesh-neoliti i vonë.

Lubozhda - Tri tuma ilire të evidentuara janë të shekullit VIII-V p.e.s. Vendndodhja e tyre është në anën e majtë të rrugës rajonale Istog-Vrellë, 100m larg rrugës, në një arë (pronë private e Gëzim Meshit).

Tuma I - me dimensione 13 x 7 x 1.5 m, e ndërtuar mbi një terren të rrafshët dhe e dëmtuar në anën juglindore. Tuma II – është më mirë e ruajtur se e para. Ka dimensione 18x7x1 m. Tuma III- e shpërbërë nga erozioni dhe punimet bujqësore. Për këtë kompleks është marrë vendimi që të bëhen gjurmime arkeologjike.

Shushica - Gjurmët e tri kishave të vjetra.

Një kishë e vogël me infrastrukturë banimi përreth është evidentuar rrëzë malit. Ka qenë vendbanim i grupuar rreth truallit të kishës me sipërfaqe prej 1 ha. Gjetjet arkeologjike dëshmojnë për periudhën e bronzit të vonë, por që kishte vazhdimësi edhe në kohën e hekurit të hershëm.

Themelet e një kisha tjetër në lagjen Mulaj, e cila po ashtu ishte e rrethuar me infrastrukturë banimi. Material arkeologjik është gjetur edhe në lagjen Nimanaj.

Zhakova - Varrezat e vjetra me monolite guri në Zhakovë - lokaliteti Seishtë. Janë gjetur fragmente arkeologjike të cilat dëshmojnë për epokën e bronzit - 1500 vite p.e.s. Ndërsa, në Lugun e Vakëfit, nën Shkozë ndodhet një kishë e vogël. Në drejtim të Stropcit ndodhet "Kroi i etheve", i cili nga populli konsiderohet i shenjtë dhe shërues.



45. Dionisi (Zoti i plleshmërisë) i gjetur në Vrellë



Foto 46. Oxhaku i odës së Ukë Sylës në Istog të Poshtëm

Periudha antike

Istog - Relikte të rrugës tregtare antike të quajtur nga populli “drum”, janë evidentuar nën lokalitetin Quka e madhe, në anën e djathtë të përroit të Bollovonit në Istog. Kjo rrugë ka shtrirje nga lindja në drejtim të perëndimit duke lidhur Stantërgun (si qendër ekonomike e minerare), ka vazhduar në drejtim të perëndimit nëpër Radishevë, Suhogërrllë dhe në fshatin Synejë, ku mund të ketë qenë edhe degëzimi i saj në dy drejtime. Njëri drejtim ka vazhduar nëpër Istog e deri në Sanxhak, kurse drejtimi tjetër ka kaluar nëpër Istog të poshtëm, Pejë, Gjakovë e deri në lidhje me rrugën transballkanike Lezhë - Nish. Kjo rrugë ka pasur gjerësi rreth 4 m dhe ishte e shtruar me kalldrëm.

Dragolevc - Janë evidentuar themelet e një kishe të vogël romake, me dimensione 12x6 m'. Materiali ndërtimor është gur gëlqeror i lidhur me harason. Ka absidën e kthyer kah lindja. Populli e quan kisha e Rimit.

Vëriq - Themelet e një kishe iliro-romake të shekullit II janë evidentuar në lokalitetin “trolli i kishës”. Kisha ka absidën e kthyer kah lindja. Në këtë lokalitet është gjetur kurora e altarit.

Shushicë - Themele antike janë evidentuar në lokalitetin “Ledina e kishës” në Starasellë (në veriperëndim të Shushicës- 2.5 km vijë ajrore nga qendra e fshatit Shushicë). Themelet e kishës dhe vendbanimit përreth i përkasin shek. IV-V, që do të thotë antikitetit të vonë e deri në mesjetë.

Vrellë - Gjurmë të vendbanimit antik janë evidentuar mbi burimin e Vrellës, i njohur si lokaliteti “Krye”. Ka qenë i shtrirë në një terren të pjerrët dhe sipërfaqe 1.5 ha. Bazuar në materialin arkeologjik të gjetur brenda sektorit të vend-gjetjes, del se vendbanimi i takon antikitetit të vonë dhe ka vazhduar të jetë i banuar edhe në mesjetën e hershme, shekulli V-VI.

Cerrcë - Janë evidentuar gjurmë të vendbanimit antik të shek. V-VI dhe ka pasur sipërfaqe prej 5 ha.

Lubozhdë - Themele të vjetra të vendbanimit të periudhës ilire-romake, të ndërtuara me gur të pa lidhur, janë evidentuar në lokalitetin “shkëmbi i kroit”, mbi kroin e Lubozhdës. Gjyteti - gradina që gjendet në rrafshin e Llokfave mbi Lubozhdë, konsiderohet të jenë themelet e një kalaje të kohës së perandorit Justinian.

Syne - Një kishë e vogël ilire ndodhet në anën e majtë të rrugës Syne-Mojstir. Kisha ka qenë me absidë të kthyer kah lindja, me dimensione 5.6 x 4.6 m, e punuar me gur gëlqeror. Dera e kishës është e ndërtuar në anën perëndimore. Po ashtu, një vendbanim i periudhës romake i shekullit II dhe III është evidentuar në Syne-lokaliteti Seishtë. Është shtrirë në pjesën jugore dhe në sipërfaqe prej 10 hektarësh. Në afërsi ndodhet një lokalitet i njohur në popull si “Kunjë”, për të cilin mendohet të jetë tumë ose kishë paleokristiane (mbetet të precizohet në të ardhmen nga arkeologët).

Periudha mesjetare

Bajicë - Kishë paleokristiane dardane. Kjo kishë interesante njëpjesëshe nga kristianizmi i hershëm, me kriptë dhe apsidë është zbuluar dhe hulumtuar nga arkeologët në vitin 1967, në varrezat e fshatit.

Studenicë - Bazilikë paleokristiane dardane e shekullit të V-të. Themelet e kësaj bazilike trepjesëshe të epokës së hershme bizantine u zbuluan gjatë vitit 1967-68, nën gërmadhat e kishës së Studenicës (shek. XIII-XIV). Ky mund të jetë një shembull tipik se kishat mesjetare serbe janë ndërtuar në shumë raste mbi themelet e kishave dhe bazilikave të hershme ilire-dardane.

Urat

Zallq - Ura e vjetër e gurit - e ndërtuar në vitin 1695, me gjatësi 82,45 m; gjerësi 4,72m, me 13 harqe, e punuar me gurë gëlqeror të latuar, e lidhur me harason dhe e shtruar me kalldrëm. Është ekzemplar mjaft i bukur i urave të vjetra dhe një prej ndërtesave më të çmueshme të trashëgimisë

arkitektonike të Istogut. Tani është bërë meremetimi dhe konservimi i sajë nga Ministria e Kulturës. Gjatë periudhës osmane e deri në vitin 2003 prej kur nuk funksionon më, kishte rëndësi jetike për lidhjen e dy anëve të Podgurit, e më tutje edhe me Klinën dhe qendrat tjera të Kosovës.



Foto 47. Ura e Zallçit, para riparimit



Foto 48. Ura e Zallçit e meremetuar

Xhamitë

Istog - Xhamia e ndërtuar në vitin 1730 nga Mulla Kurta, e djegur dhe bombarduar nga serbët në qershor të vitit 1999, e restauruar pas lufte.

Shushicë - Xhamia e Mehmet Akifit. Mehmet Akifi ka lindur në Stamboll dhe ka prejardhje nga familja Mulaj në Shushicë (Babai i tij ka qenë Tahir Haradin Mulaj). Ai e kishte ndërtuar xhaminë në vitin 1879, në shenjë respekti për paraardhësit e tij. E djegur gjatë luftës së fundit dhe ende nuk është rinovuar. Kanë mbetur vetëm muret.

Kaliqan – Xhamia e ngritur në shek. XIX. Edhe pse ishte e mbrojtur me ligj, është djegur gjatë luftës së vitit 1999. Gjatë restaurimit të saj, ka pësuar ndryshime të dukshme dhe ka humbur mjaft nga vlerat e saj. Kjo godinë është masive në formë të katërkëndëshit, e ndërtuar nga guri. Minarja me pullaz katër ujorë ka qenë e mbuluar me tjegulla .Në krye të godinës, në kat, gjendej çardaku i hapur i punuar nga druri dhe në frymën e ekzemplarëve më të bukur të arkitekturës popullore.

Xhamitë tjera që mund të kenë vlera të trashëgimisë janë: Xhamia e Vrellës, Xhamia dhe Mejtepi në Uçë , Xhamia dhe Mejtepi në Tomoc, Xhamitë në Studenicë, Trubuhovc, si dhe Mejtepi në Zabllaq.



Foto 49. Xhamia e Kaliqanit



Foto 50. Kisha e Cerkozëzit

Mullinjë

Në kohën e sundimit turk dhe më vonë, në Istog, është karakteristik zhvillimi i mullinjve me ujë dhe shkaltoreve të zhgunit. Kanë qenë gjithsej 60 mullinj dhe 6 shkaltore të zhgunit në Komunën e Istogut. Vetëm përgjatë lumit Istog, kanë qenë të ndërtuar 36 mullinj me ujë.

Mullinjte më të vjetër janë: Mulliri i Griajve në Istog (i ndërtuar me 1520), Mulliri i Pren Palokës në Gjurakoc, (i ndërtuar në vitin 1695, me pesë gurë dhe i cili punoi për katër breza me radhë) .

Mullinj të më të njohur janë: Mulliri i Idriz Sak Bytyqit (me pesë gurë, me kapacitet 1200 kg/ditë), mulliri i Nimon Shaban Sadikajt (me pesë gurë, kompleks i cili kishte edhe kullën dhe hanin). Nga këta mullinj kanë ngelur vetëm disa mure.

Mullinj të aktiv - Janë në numër të vogël dhe ekskluzivisht përdoren për bluarjen e misrit: Mulliri i Ibish Arifajt - në Istog të Poshtëm, Mulliri i Qelë Shaban Bicajt - në Vrellë Mulliri i Mazo Hajdarpashiqit - në Corrollukë, Mulliri i Tahir Morinës - në Bajicë.

Kullat

Kullat janë objekte arkitektonike autentike shqiptare të ndërtuara nga familjet e kamura (feudale) shqiptare. Shërbenin si strehë familjare. Kati i parë (I) zakonisht shërbente për strehimin e bagëtisë, kati i dytë (II) për vendosjen e familjes, kurse kryevepër e çdo kulle ishte oda kati i III-të. Kullat i kanë ndërtuar mjeshtrit më të përsosur të gurgdhendës dhe murimit më gur-ustallarët dibran.



Foto 51. Kulla e Halil Dervish Syles



Foto 52. Rozeta dhe dritarja e kullës së Podgurit

3.7.5.2 Trashëgimia etnokulturore

Etnografia

Krahas trashëgimisë arkitektonike, Komuna e Istogut është e pasur edhe me trashëgimi të pasur etnokulturore. Një ndër trashëgimitë më të pasura të kësaj treve është:

Veshja popullore e Podgurit (e njohur si veshja e Dukagjinit).

Karakteristikë emblematike e etnokulturës së trevës së Podgurit është veshja e Podgurit, e cila konsiderohet mbretëreshë e veshjes popullore për femra. Zonë e shtrirjes etnokulturore e kësaj veshjeje është i gjithë Rrafshi i Dukagjinit. Veshja popullore në përgjithësi, e në kuadër të saj veshja e femrave të Podgurit, bëjnë një thesar të pasur vlerash në tërësinë e kulturës materiale dhe artistike të Podgurit. Pra, edhe kjo veshje bën pjesë në kuadër të 140 formave të veshjeve popullore shqiptare sa njëh sot etnografia shqiptare. Kjo veshje në kontekstin e rrethanave historike të zhvillimit kulturor të këtij mjedisi ka ndikuar në pasurimin e vlerave që i hasim të realizuara në vetë strukturën e veshjes, morfologjinë e saj, kromatiken, funksionin në veçanti, sipas kushteve dhe nevojave jetësore.

Veshja kombëtare e burrave, kryesisht, ishte veshje tradicionale e Rrafshit të Dukagjinit.



Foto 53. Veshja e Podgurit



Foto 54. Trashëgimi etnogafike

3.7.5.3 Trashëgimia shpirtërore:

Besëtytnitë: Syni i keq, apo m'syshi, magjitë. Pastaj: shtriga, lugati, dhampiri, kuçedra, zana, ora etj.

Ritet: Riti i lindjes, dhe vdekjes, ninullat, fejesa, dasma, dita e divanit e pamja etj.

Kulti: Shën Gjergji, Shën Marku, apo Sh'marku, Shën Mitri, apo Sh'mitri.

Urimet: Të lumtë goja, t'knoft zemra, t'lumt, t'u rrit nera, e mira të gjet, të prift ora e mirë etj.

Mallkimet: Mos ia pafsh hajrin, t'i djegt zjarri, e hangsh kryet t'at, i lash shkret etj.

Betimet: Pasha këtë diell që po rrezon, pasha Zotin, pasha Besën, pasha shpirtin e babës, nanës, vëllait etj

Këngët popullore: Këngët Kreshnike (lahutare) këngët e vajit (vajtimet mortore) këngët folklorike-rapsodike etj.

Vallet Popullore: Vallja e Podgurit (vallja Podrimqe) dhe Vallja fësht ta-ta fështa (valle pa instrumente).

Lojërat popullore: Kërcimi pup, Kërcimi në hap, Gurë-bira, Mundja, etj dhe keto lojra popullore janë në zhdukje e sipër. Disa prej tyre do të mund të bëhen lojra tradicionale dhe Kosova të konkurroj me to edhe në botë.

Veglat muzikore: Lahuta, Çiftelia, Sharkia, Defi, Kavalli, Fyelli, Filikaqa, Mishnicat, Tupani, Zurla.

Veglat baritore: Pipi, gjethi, tatirangja, filikaqa.

3.7.6 Zhvillimi ekonomik

Istogu, zhvillimin e vetë e mbështet në resurset njerëzore dhe natyrore, në traditën e popullatës së kësaj ane dhe llogaritet si një vend i potencialit dhe traditës bujqësore, me agrikulturë, blegtori, peshkatari dhe pylltari të zhvilluar.

3.7.6.1 Bujqësia

Bujqësia si degë e rëndësishme e ekonomisë ka një rendësi të madhe për Komunën e Istogut. Njëra prej detyrave primare e bujqësisë është prodhimi i ushqimit të mjaftueshëm dhe cilësorë për mbarë popullsinë, si dhe sigurimi i lëndës së parë për industrinë përpunuese.

Me bujqësi merret rreth 65 % e popullsisë së Komunës së Istogut dhe prej saj ajo siguron ekzistencën e vet. Në bazë të kushteve agroekologjike që ka rajoni i Istogut, mund të arrihen rendimente të kënaqshme dhe cilësore, si të kulturave lavërtarie, ashtu edhe prodhimeve blegtorale. Edhe pse ekzistojnë kushte të volitshme natyrore, mandej ekzistimit i potencialit njerëzor dhe i kualifikuar, zhvillimi dhe prodhimi i produkteve vendore të natyrës ushqimore janë të ulëta dhe si pasojë kemi furnizimin e pamjaftueshëm me artikuj ushqimorë të nevojshëm për popullatën. Për këtë arsye shumica e këtyre artikujve, si dhe materiali riprodhues, kryesisht vinë nga importi, janë prodhime ushqimore, si: mielli, qumështi, pemët, perimet, vaji, mishi, farat etj.

Tabela 17. Struktura e sipërfaqes bujqësore në Komunën e Istogut

Nr.	Struktura e sipërfaqes bujqësore	ha
1.	Ara	10.085.21 ha
2.	Vreshta	23.77 ha
3.	Pemishte	715.83 ha
4.	Livadhe dhe jonxhë	6.404.37 ha

Komuna e Istogut ka përparësi të mëdha për zhvillimin e bujqësisë, duke filluar nga:

- Kushtet agroekologjike mjaftë të favorshme;
- Resurset natyrore, toka, pasuritë ujore (lumenjtë) etj.;
- Fuqia punëtore, me përvojë dhe e kualifikuar, dhe;
- Shitja e produkteve në tregun e brendshëm, si dhe mundësia për eksport (tregu dikurshëm i Malit të Zi dhe Bosnjës).

Krahas përparësive ekzistojnë edhe vështirësitë në zhvillimin e bujqësisë. Një prej vështirësive që po ballafaqohet Komuna e Istogut për zhvillimin e mirëfilltë të bujqësisë është dëmtimi i kanaleve për ujitje, si dhe mungesa e meremetimit të atyre ekzistuese. Në Komunën e Istogut ekziston një rrjet i gjerë i kanaleve për ujitje të tokave bujqësore në gjatësi 85.50 km. Në këtë mes duhet cekur se shumica e kanaleve për ujitje në Komunën e Istogut janë kanale të hapura të ndërtuara qysh në vitet e '30-ta, përkatësisht vetëm 9 kilometra janë të betonuara. Kështu që nga 3.990 hektarë të arave të planifikuara për ujitje nga sistemi i kanaleve të ujitjes, që furnizohen me ujë nga burimet dhe lumenjtë që përshkojnë Komunën e Istogut, si “Burimi Istog”, “Drini i Bardhë”, “Burimi i Vrellës”, ujiten vetëm 1240 hektarë. Nga kjo sipërfaqe, 150 hektarë ujiten nga grumbullimi i rrjedhave të ujërave nëntokësore.

Për shkak se kanalet e ujitjes të janë të tipit të hapur e të pa betonuara dhe nuk pastrohen me rregull, gjatë reshjeve të mëdha gjatë stinëve të vitit, ujët e tyre vërshojnë sipërfaqe të mëdha të tokave të bukës dhe shkaktojnë dëme dhe erozione, duke shkatërruar sipërfaqe të mëdha të tokave. Vetëm gjatë vitit të kaluar nga reshjet dhe daljet e ujërave nga shtretërit janë vërshuar 170 hektarë tokë e punueshme. Po ashtu, mangësi e rrjetit të ujitjes në Komunë është edhe mungesa e pendëve përkatësisht digave për ujitjen e tokave, si në Bajicë, pastaj në Lluga të Saradaranit, si dhe Gurrakoc, aty ku bashkohet Jazi i Gogës me Shushicën.

Një problem të veçantë për kuqësinë e Komunës së Istogut paraqesin dëmtimet e kanaleve, Ana e majtë dhe e djathtë e burimit të Istogut, prej nga ujitej shumica e sipërfaqes së tokës bujqësore e Komunës së Istogut. Këto kanale janë të tipit të mbyllur me tubacione në tërë gjatësinë deri në 25 km, mirëpo ato janë dëmtuar nga hapjet e dhunshme, përkatësisht hapja e vrimave përgjatë rrjetit të kanaleve për nevojat e banorëve nga shtrihet ky rrjet. Kurse, në dhjetë vjetet e fundit, ujët e këtyre kanaleve nuk arrin të shkojë në destinacion në arat e Komunës së Istogut edhe për shkak se shfrytëzohet nga prodhuesit e fermave të peshqve, të cilët janë të detyruar që ujin e përdorur pas trajtimit, përkatësisht filtrimit, ta kthejnë në kanal që të përdoret për ujitje. Mirëpo, këtë nuk e bëjnë, kështu që uji i kontaminuar nga hurdhat e peshqve derdhet në përroska apo në rrjetin e kanalizimeve, e nga aty në lumin e “Istogut”.

Vështirësitë me të cilat ballafaqohet bujqësia e Istogut janë:

- Sipërfaqja e tokës mjaft e kufizuar, me tendencë të zvogëlimit nga ndërtimet e pakontrolluara në tokat bujqësore;
- Sipërfaqet në pronësi të fermerit është e copëtuar në disa ngastra të vogla, çka e pa mundëson shfrytëzimin racional të tokës dhe mekanizmit bujqësor;
- Mungesa e kapitalit qarkullues të fermerët;
- Marketingu i prodhimeve bujqësore nuk është i organizuar;
- Mungon tregu i ndërmjetëm - grumbullimi i produkteve, deponimi, ruajtja në frigorifer të mëdhenj dhe përpunimi i tyre etj.);
- Mungon subvencionimi i prodhimitarisë bujqësore;
- Çmimi i lartë i repromaterjalit etj.;
- Shfrytëzim i pakontrolluar i resurseve natyrore;
- Konkurrenca globale e tregut;

- Qasje e kufizuar në resurset financiare;
- Mungesë e ndihmës teknike dhe;
- Pasiguria në investimet afatgjata në bujqësi.

Por, mundësitë janë evidente:

- Zhvillimi i tregtisë jashtë Kosovës;
- Mundësi e mirë për shtimin e prodhimeve vendore;
- Investime në shtimin e vlerës së prodhimeve vendore;
- Menaxhim më i mirë i resurseve ujore;
- Menaxhim më i mirë i viseve malore dhe pyjore, dhe;
- Zhvillimi i turizmit rural dhe malor.

3.7.6.2 Prodhimtaria perimore

Komuna e Istogut, sidomos zona e Fushës, përkatësisht rajoni i njohur, si “Lugu i Drinit”, njihet si rajon i kultivimit të perimeve, duke ju falënderuar kushteve agroekologjike, si dhe traditës së fituar të bujqve në kultivimin e tyre. Kjo i jep Komunës së Istogut një karakteristikë të jashtëzakonshme agrare. Këto sipërfaqe mundësojnë shfrytëzimin intensiv për arsye të mundësisë për ujitje.

Sipërfaqet e bujqësisë së Komunës së Istogut i përbëjnë arat dhe kopshtet me sipërfaqe 12 059 ha, zakonisht të mbjella me kultura të cilat paraprijnë: gruri, misri, elbi, jonxha, perime etj. Gjithashtu, të volitshme janë edhe kushtet për kultivimin e mollës, kumbullës, dardhës, qershisë, vishnjës, ftoit dhe pjeshkës.

Tabela 18. Sipërfaqja e tokës e mbjellur me drithëra

Shpërndarja e sipërfaqes tokësore sipas kultivimit	Ha
Misër	1.750
Grurë	2.740
Luledielli	00
Perime	320

Përbërja e tokës dhe mundësia për t’i ujitur ato, mundësojnë produktivitet të madh të perimeve të ndryshme, e sidomos: patates, specit, shalqirit, pjeprit, qepës, domates dhe lakrës.



Foto 55. Zhvillimi i kopshtarisë



Foto 56. Zhvillimi i pemëtarisë

3.7.6.3 Zhvillimi i pemëtarisë

Zhvillimi i pemëtarisë ka një rëndësi të madhe në aspektin ekonomik dhe social nga se frutat e pemëve, qoftë në gjendje të freskët apo të përpunuara janë një komponent e rëndësishme për ushqimin e popullatës. Nutricionistët Botëror rekomandojnë që të shpenzohen rreth 115 kg fruta të pemëve në vit për kokë të banorit, kurse të ne, në Kosovë, sipas disa shënimeve statistikore harxhohen diku rreth 45 kg frute të pemëve në vit. Nga këtu shihet edhe kërkesa për kultivimin e pemëve, faroreve (molla, dardha, ftoni etj.), bërthamorëve (kumbulla, vishnja, pjeshka etj.), arroreve (arra, lajthia etj.), pemëve të imta (dredhëza, mjedra, manaferra), të cilat janë shumë të kërkuara, si në tregun e brendshëm, ashtu edhe në tregun ndërkombëtarë.

Me rëndësi duhet të janë edhe masat stimuluese apo subvencionet shtetërore:

- Stimulimi i fermerëve për ngritjen e pemishteve;
- Sigurimi i fidanëve cilësore, varietete me potencial të lartë prodhues dhe të qëndrueshëm ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve;
- Të organizohen trajnime të fermerëve për ngritjen dhe menaxhimin e pemishteve;
- Të ngritën fidanishte bashkëkohore për prodhimin e fidanëve;
- Sigurimi i kredive me kushte të volitshme;
- Zgjerimi i sistemit të ujitjes (përfshirja e të gjitha sipërfaqeve të mundshme të tokës me ujitje dhe;
- Ngritja e depove bashkëkohore për ruajtjen e pemëve dhe përpunimit të tyre etj.

Rekomandimet për të ardhmen e bujqësisë në Komunën e Istogut:

- Mbrojtja e tokave bujqësore nga ndërtimet e egra;
- Zgjerimi i qytetit të racionalizohet me ndërtime të larta-banime kolektive;
- Të bëhet komasacioni apo grupimi i tokave, sepse parcelat e imtësuar dhe të shkapërderdhura të një prone janë një nga faktorët imitues për një prodhimtari bujqësore të organizuar, për aplikimin e masave bashkëkohore agroteknike për shfrytëzimin racional, të makinave, aplikimin e qarkullimit bimor, për shfrytëzimin e sistemit për ujitje etj.;
- Të shikohet mundësia e shtimit të sipërfaqeve të tokës, në brezin e mesëm, sidomos rrafshinave dhe bregoreve, që janë të mbuluara me shkurre, për mbjelljen me kultura adekuate, si hardhi dhe farore të ndryshme;
- Meremetimi i sistemit ekzistues të ujitjes, zgjerimi i rrjetit të tij, ngritja e pendave nga betoni për gjatë lumit, të cilat përdoren për ujitje, parandalimi i përmbytjeve. Shfrytëzimi i hapësirave për akumulimeve të vogla të ujit të cilat do të kontribuojnë në radhë të parë në mikroklimën e rajoneve përkatëse, zhvillimin e peshkatarisë, shfrytëzimin e ujit për ujitje, ngritjen e mini-hidrocentraleve energjetike, si dhe për rekreacion;
- Organizimi i fermerëve në bazë të veprimtarisë së tyre (blegtor, pemëtar, kultivues të perimeve etj.), në kooperativa bujqësore, shoqata të fermerëve, sindikatën e bujqve etj.;
- Marketingu i prodhimeve bujqësore, grumbullimi, ruajtja, përpunimi i prodhimeve bujqësore dhe shitja e tyre (ekzistimi i tregut të ndërmjetëm);
- Ngritja profesionale e fermerëve (organizimi i kurseve, trajnimeve për lëmit përkatëse të bujqësisë);
- Aplikimi i teknologjive të reja në prodhimtarin bujqësore;
- Përdorimi i farërave dhe fidanëve cilësore me potencial të lartë të prodhimit;
- Shtimi i fondit blegtoral, si dhe përmirësimi i racave të kafshëve me raca me potencial të lartë të prodhimit;

- Shfrytëzimi i kullosave ekzistuese në viset kodrinore-malore dhe aplikimi i prodhimit të ekologjikë në blegtori në pjesët kodrinore-malore;
- Ngritja e fidanishteve dhe pemishteve me pemë të ndryshme;
- Ngritja e serave për kultivimin e perimeve përkatësisht eliminimi i karakterit sezonal në prodhimtarin perimore dhe kultivimin e luleve;
- Përmirësimi i gjendjes së mekanizimit bujqësor;
- Ruajtja e pyjeve nga prerjet ilegale dhe ripyllëzimi i tyre;
- Zhvillimi i gjuetisë për rekreacion;
- Ruajtja e bimëve mjekuese, si dhe shqyrtimi i mundësive për kultivimin e tyre, dhe;
- Rregullimi i infrastrukturës nëpër zona rurale do të kontribuonte zhvillimit të bujqësisë, pengimit të migrimin të popullsisë fshat-qytet etj.

3.7.6.4 Agrikultura (Blegtoria, bimët mjekuese)

Kushtet klimatike dhe toka në këtë zonë mundësojnë kultivimin e bimëve të ndryshme mjekësore, të cilat mund të përdoren në industrinë farmaceutike. Rritja e bimëve mjekësore dhe e luleve është e rëndësishme edhe për bletarinë, prodhimin e mjaltit dhe produkteve të tjera bletare.

Blegtoria, si veprimtari ekonomike në këtë zonë, kryesisht zhvillohet më afër vendbanimeve dhe si veprimtari sezonale (gjatë verës) në kullosa dhe livadhe. Livadhet dhe kullosat, si resurs dhe potencial për blegtori, shtrihen kryesisht në këtë zonë. Mënyra se si funksionon sot kjo veprimtari nuk është e kënaqshme dhe nuk ka një organizim të mirë. Për shfrytëzimin sa më të mirë të potencialeve të agrikulturës, janë të nevojshme aftësi dhe njohuri shtesë për prodhim dhe marketing, si dhe rritja e njësive bujqësore me madhësi mesatare.

Masat që duhet ndërmarrë për përparimin e blegtorisë:

- Përmirësimin e racave të kafshëve;
- Prodhimi dhe përpunimi i ushqimit të kafshëve, përdorimi i mekanizmit bashkëkohor për përgatitjen e ushqimit voluminoz dhe atij të koncentruar, si: makineri për përgatitjen e sillazhes, makinat për zhveshjen e misrit, rrotoballert për konservimin e ushqimit, aparatura për përgatitjen e ushqimit të koncentruar;
- Grumbullimi dhe përpunimi i prodhimeve blegtorale (pika grumbulluese të qumështit);
- Ofrimi i shërbimeve profesionale nëpër fshatra (stacionet për përparimin e blegtorisë dhe shërbimet veterinarë) dhe;
- Mënyra e sigurimit të mjeteve (financimit) për zhvillimin e blegtorisë.

3.7.6.5 Apikultura

Zhvillimi i kësaj veprimtarie është ngushtë i lidhur me bujqësinë e sidomos me kultivimin e pemëve të cilat sigurojnë kushte të mira dhe stimulojnë bletarinë. Ndikim tjetër pozitiv në zhvillimin e kësaj veprimtarie kanë edhe lulet dhe bimët tjera, si erëzat, sidomos ato që rriten në zona të tjera, në bjeshkë dhe rrëzë. Prodhimet nga bletaria, mjaltë dhe dylli kanë përdorim të gjerë edhe nga kompanitë farmaceutike dhe kozmetike, si përbërës të medicinës dhe kozmetikës. Edhe në apikulturë, një organizim më i mirë mund të ndikojë në ngritjen, si të kualitetit, ashtu edhe të prodhimit të mjaltës dhe prodhimeve të tjera nga kjo kulturë. Shoqata e bletarëve duhet të synojë që produktet e mjaltit të kenë një etiketë kualiteti të mbrojtur që i shquan ato në Kosovë dhe jashtë saj.

3.7.6.6 Akuakultura (Kultivimi i peshkut)

Burimet e ujit dhe kushtet e tjera klimatike mundësojnë kultivimin e peshkut. Akuakultura është industri ushqimore e cila në botë po rritet shumë shpejtë. Kjo veprimtari e bën Istogun të dalluar, jo vetëm në këtë zonë, por edhe Komunën me rrethinë.

Akuakultura i referohet rritjes, kultivimit dhe prodhimit të gjitha llojeve të bimëve dhe shtazëve në ambientet ujore. Sikurse agrikultura edhe akuakultura mund të zhvillohet në ambiente natyrore të krijuara nga njeriu.



Foto 57. Hurdhë e peshqve



Foto 58. Kultivimi i peshkut

Në Istog është i zhvilluar kultivimi i peshkut të ujërave të ëmbla.

Janë dy kërkesa themelore për operimin e suksesshëm të një ferme për kultivimin e peshkut: Hapësira fizike (toka) dhe furnizimi i mirë me ujë të kualitetit të lartë.

Sasia e ujit dhe sipërfaqja e tokës në dispozicion, përcaktojnë tipin e pajisjeve për kultivim dhe numrin e peshqve që mund të kultivohen. Ujërat nëntokësor nga burimet dhe pusët, janë burimet më të mira të ujit për ferma të peshqve, e që në këtë zonë janë të mjaftueshme. Gjithashtu, edhe burimet e tjera, si ujërat sipërfaqësor, ujërat e lëvizshëm etj., mund të përdoren për rritjen e peshkut, por natyrisht se të gjitha burimet duhet të jenë të pastra nga sëmundjet e peshqve, parazitët, peshqit bezdisës dhe grabitqarë, balta, pesticidet, klori dhe kemikalet tjera të cilat janë të dëmshme për shëndetin e peshqve. Furnizimi i mirë me ujë me sasi të mjaftueshme dhe kualitativ janë elemente thelbësore për kultivimin e peshqve në ferma. Kurse, vendet ideale për vendosjen e fermave janë pjesët më të larta të kësaj zone, ku toka është në nivel më të lartë nga sipërfaqet e vërshuara dhe furnizimi i vazhdueshëm me ujë të pastër është i detyrueshëm.

3.7.6.7 Pylltaria

Zona malore e bjeshkëve të Istogut ofron mundësi të zhvillimit të veprimtarive të lidhura me resursin e pyjeve. Zona malore është e mbuluar me pyje të larta të cilat mund të shfrytëzohen për prodhimin e lëndës drunore, prodhimtari të vogla të zdrukthëtarisë dhe prodhimin e biomasës e cila mund të përdoret për ngrohje dhe prodhimin e energjisë në shkallë të vogël. Shfrytëzimi i resurseve pyjore duhet të jetë i qëndrueshëm, me prerje të kontrolluar dhe politikë të pyllëzimit. Detyrë e Komunës është që së bashku me institucionet përgjegjëse të ndalojë prerjen ilegale dhe të pakontrolluar të pyjeve.

3.7.6.8 Industria dhe zhvillimi ekonomik

Parashihet që Istogu të zhvillojë edhe më tej industrinë e drurit, industrinë përpunuese, ndërsa sa i përket prodhimit të peshkut, synohet që të rritet për të plotësuar nevojat e tregut edhe jashtë Kosovës.

Eksplorimi i resurseve minerale

Për eksplorim të pasurive minerale nuk ka plane të caktuara, e megjithatë plani zhvillimor shqyrton mundësitë e eksplorimit të thëngjillit dhe oniksit në Komunë. Me plan përshkruhet eksplorimi i thëngjillit (7-7.5 tonë) në një minierë në Istog dhe Klinë, si dhe ndërtimi i termoelektranës 600 MW në Zllokuqan, Klinë. Ndërsa, eksplorimin e oniksit dhe travertin-oniksit e lë të varur nga zhvillimi i Banjës dhe zhvillimi i turizmit shëndetësorë në përgjithësi.

3.7.6.9 Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

Istogu zhvillimin ekonomik e ndërlihd edhe më fuqizimi e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe industritë dhe bizneset me emetim të ulët. Fokusi i ndërmarrjeve lokale duhet të orientohet në prodhimtarinë bujqësore dhe shërbime.

Përveç prodhimit edhe përpunimi dhe përsosja e produkteve ushqimore janë shumë të rëndësishme për zhvillimin e kësaj industrie. Për prodhimin e produkteve kualitative është e nevojshme fuqi punëtore e aftë, prandaj trajnimet dhe kurset profesionale janë ato që duhet ta plotësojnë prodhimtarinë bujqësore dhe përpunimin e produkteve ushqimore.

Për shkak se shumica e territorit në këtë zonë është rrafshinore, arat e mbjella me drithëra dhe pemë dhe perime duhet të mbrohen dhe zgjerohen.

Industritë dhe bizneset të cilat i përpunojnë resurset rajonale, duhet të gjejnë përkrahje në agjencinë rajonale për marrëveshje, që është përgjegjëse për hulumtim profesional të lokacioneve, si dhe menaxhim të tyre. Në kuadër të zonave të krijuara biznesore dhe industriale, duhet të sigurohet infrastruktura dhe lidhjet efikase me rrjetin regional rrugor. Hapësira e parkut komunal të biznesit duhet të pajiset me furnizim vetanak të energjisë, e bazuar në format e përsëritshme të energjive rajonale. Kjo siguron furnizim të përhershëm me energji për ndërmarrjet. Profesionistët e rinj duhet të trajnohen për zhvillim ekonomik dhe marketing, me anë të seminareve dhe kurseve në shkollat profesionale.

3.7.7 Tregtia

Meqenëse në Komunë e Istogut nuk ka një zhvillim të mirëfilltë ekonomik, si dhe industri dhe bujqësi të zhvilluar, mund të thuhet se tregtia është degë parësore në ekonominë e kësaj shtetshpirtë. Mirëpo, në këtë mes kryesisht importohet malli, nga komunat fqinje dhe nga shtetet fqinje, çka do të thotë se tregtia e brendshme është e theksuar më shumë në krahasim me tregtinë e jashtme. Andaj, tregtia vazhdon të jetë forma më e përhapur e koncentrimit të kapitalit në sektorin privat. Numri i bizneseve, që veprojnë në Komunën e Istogut është 2036, e ku nga kjo shifër 704 janë tregtare.

3.7.8 Zejtaria

Komuna e Istogut e cila shtrihet në pjesën veri-perëndimore të Kosovës, për shkak të pozitës jo të përshtatshme gjeografiket, larg qendrave të mëdha rajonale dhe rrugëve kryesore të Kosovës, nuk mund të mburret me një zejtari të zhvilluar. Në këtë mes zejtaria përfaqësohet nga zejjet tradicionale si: zdrukthëtaria, farkëtaria, këpucarët, rrobaqepësit etj. Me një investim dhe përkrahje të duhur nga Komuna dhe donacione të tjera kjo degë e ekonomisë së Komunës së Istogut me prodhimet dhe shërbimet e veta paraqet një segment të veçantë të zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

3.7.9 Turizmi

“Bjeshkët e Nemuna” dhe malet e “Moknës”, pjesë e së cilës janë edhe “Bjeshkët e Istogut”, janë elementet kyçe për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm. Mirëpo, koncepti i turizmit duhet të fokusohet në potencialet natyrore dhe kulturore të Komunës: mundësitë që ofron ky rajon për kurimin me ujërat termo-mineral, marrjen me sportet e bazuara në natyrë, sidomos për sportet ekstreme, interesimi për natyrën, interesimi për trashëgiminë kulturore, si dhe për jetën në fshat.

“Bjeshkët e Istogut” janë të njohura me një flore dhe faunë të pasur, me kullosa të shumta dhe livadhe të cilat janë bazë e mirë për zhvillimin e blegtorisë, pastaj ka sipërfaqe të mira për ngritjen e terreneve të skijimit, si dhe pyje dhe ambiente atraktive për zhvillimin e turizmit. Po ashtu, “Bjeshkët e Istogut” janë të njohura për rritjen e bimëve të ndryshme mjekësore. Njëherit “Bjeshkët e Istogut” me lartësinë e tyre dhe peizazhet atraktive ofrojnë mundësi të zhvillimit të sporteve të ndryshme, si: lëshimi me fluturake nga bjeshka në fusha, pastaj zhvillimin e sporteve të çiklizmit dhe motoçiklizmit malor. Mirëpo, shumica e këtyre resurseve nuk shfrytëzohen për mungesë të infrastrukturës rrugore.

Llojet e turizmit që mund të zhvillohen në regjionin e Komunës së Istogut janë: Turizmi malor, turizmi transit, turizmi shëndetësorë, turizmi kulturor eko-turizmi dhe turizmi rural.

Turizmi malor

“Bjeshkët e Istogut” me bukuritë e veta natyrore me vlera të veta të larta ekologjike, gjeomorfologjie, me florën dhe faunën e saj shumë të pasur, me peizazhin e jashtëzakonshëm të lokaliteteve, me gryka, kanjone, shpella dhe me monumente të pasura të trashëgimisë, ofron kushte të volitshme për zhvillimin e turizmit, i cili do të jetë një promotor shtytës për zhvillimin e degëve të tjera të ekonomisë. Turizmi malor, dimëror dhe veror duhet të jetë një prej formave më të avancuara të turizmit dhe këtë për shkak të kushteve të volitshme që ofron ky rajon për vizitorët. “Bjeshkët e Istogut” njihen për peizazhe të bukura dhe atraktive, të cilat njëherit shfrytëzohen për kullosa të bagëtive dhe vend verime të blegtorëve.

Peizazhet më të njohura janë: “Gurrat e Bardha”, “Livadhet e Istogut”, “Bollovani”, “Bajshja”, “Radusha”, “Vuqa”, “Rudina”, “Kosharishta”, “Vojdulla”, “Mokna”, “Shymeku”, “Cerrovoda”, “Lugu i Butë”, “Lugu i Zajmit”, “Koreniku”, “Lugu i Madh”, “Kodra e Dynes”, “Gurra”, “Klopqani”. Lokalitetet e këtyre peizazheve ofrojnë kushte të volitshme për ndërtimin e qendrave të ndryshme turistike.

Njëherit “Bjeshkët e Istogut” ofrojnë mundësi të volitshme për zhvillimin e turizmit dimëror. Edhe pse janë bjeshkë të ulëta, një pjesë të dimrit mbulohen me borë gjë që do ka hapësira të mjaftueshme për skijim, sidomos në “Livadhet e Istogu”, “Bajshje”, “Lugu i Butë” etj.

Sa i përket turizmit veror, mund të thuhet se tashmë ka filluar frekuentimi i këtyre lokaliteteve

edhe pse edhe kjo formë e turizmit është në fazën fillestare, për shkak të mungesës së infrastrukturës rrugore deri të këto atraksione, si dhe për shkak të mungesës së infrastrukturës hoteliere në bjeshkë. Ky lloj i turizmit kryesisht zhvillohet nga banorët vendës të Komunë së Istogu, si dhe nga ata që kanë pronat e veta në këto lokalitete, të cilët tashmë kanë filluar ndërtimin e staneve dhe vilave për shfrytëzim gjatë qëndrimeve të tyre disa ditore në bjeshkë. Në këtë mes krahas kësaj “Bjeshkët e Istogut”, vizitorëve të rastit u ofrojnë atraksionet, si: kanjonet, grykat dhe majat e maleve. Majat e maleve më të njohura të bjeshkëve të Istogut janë: “Maja e Zezë”, “Koreniku”, “Mokna”, “Sejnova”, “Ruselia”, “Vojdull”, “Rudina”, “Maja e Legjenicës” etj.

Për zhvillimin dhe nxitjen e kësaj formë të turizmit do të duhej të ndërtohen shtëpi malore të cilat do të përdreshin sidomos nga pensionerët, pasi që kjo shoqëri është më e prekura nga sëmundjet e ndryshme, e që do tu nevojitej ajri i pastër, relaksimi dhe qetësia.



Foto 59. Stan në Livadhet e Istogut



Foto 60. Stan në Përrua të Vrellës

Turizmi shëndetësor

Burimi i ujërave termal në Banjë është një resurs me potencial për zhvillimin e turizmit shëndetësorë për klientelen kombëtare dhe ndërkombëtare. Zhvillimi i kësaj veprimtarie ka një traditë në Komunën e Istogut Standardet janë shumë të rëndësishme kur është fjala për kujdesin shëndetësorë. Zhvillimi i kësaj veprimtarie kërkon plotësimin e së paku tri kushteve:

- Njohje zyrtare - ndërkombëtare të kujdesit shëndetësorë;
- Dëshmi shëruese dhe;
- Kualitet i garantuar.

Qendra rehabilituese “Ilixha” në Banjë, me Plan Zhvillimor është propozuar të shpallet Zonë Turistike, për shkak të resurseve të ujërave shëruese dhe ambientale, që ofron ky lokalitet. Në kuadër të këtij kompleksi ka vepruar Stacionari i vjetër dhe hoteli me pesë yje Onix, që kanë pasur në dispozicion 750 shtretër por për momentin shfrytëzohen vetem 270 shtretër si pasoje e demeve të luftes. Mirëpo turistët gjatë sezonit të verës, shfrytëzojnë edhe hotelet, përkatësisht bujtinat private për fjetje dhe ushqim, me një kapacitet prej 250 shtretërve, kurse shërbimet shëruese i kryejnë në mjediset e këtij stacionari.

Speleo-turizmi: “Bjeshkët e Istogut” janë të njohura edhe për shpellat e shumta që gjenden në këtë rajon. Janë evidentuar më se 24 shpella, mirëpo deri më tani ende asnjëra prej tyre nuk është hulumtuar në mënyrë shkencore, gjë që në të ardhmen do të duhej të bëhej hulumtimi i tyre.

Numri i madh i shpellave në bjeshkë janë resurse me potencial për zhvillimin e turizmit. Kushtet e vështira, si lagështia dhe mungesa e dritës, janë faktorë që e bëjnë speleo-turizmin aktivitet aventuristik dhe për këtë arsye është shumë i popullarizuar për moshat e reja. Në këtë mes më të njohura janë: “Shpella e Keqë”, “Shpella e Tershanit”, “Shpella Shkëmbi i zhveshur”, “Shpella e Sinesë”, “Shpellat Binake”, “Shpella e majës së Legjenices”, “Shpella e Golakut”, “Shpella e Hoxhës”, “Shpella e Hutit” etj.



Foto 61. Peizazh rural



Foto 62. Shpella e Vojdullit

Tri shpella janë vizituar gjatë një ekspedite të përbashkët të shoqatave speleologjike “Aragonit” nga Peja dhe “Spiljar” nga Spliti, në gusht të vitit 2006. Këto janë:

Turizmi kulturor

Tradita, trashëgimia kulturore dhe lokalitetet arkeologjike në Komunën e Istogut janë potencial për zhvillimin e turizmit kulturor. Numri i madh i ndërtesave të trashëgimisë kulturore, kulla, mulli, objekte të religjionit, lokalitete arkeologjike etj., janë resurse të cilat mund të përdoren nga asociaçione apo korporata të cilat merren me mirëmbajtjen e tyre, për promovimin e këtij tipi të turizmit.

Objektet e trashëgimisë kulturore, të ndërtuara para shumë shekujsh, të cilat kanë një vlerë të madhe kulturo-historike, si “Ura a Zallqit” e ndërtuar në shek. XVII, si dhe vendndodhjet e shumta arkeologjike dhe kulturore, paraqesin një bazë të mirë për zhvillimin e kësaj forme të turizmit.

Në vitin 2011 është realizuar një projekt, në sferën e turizmit kulturor nga OJQ “Podguri” në bashkëpunim me Komunën e Istogut, i cili është financuar nga KE/BE, e që qëllim të vetin ka “nxitjen e turizmit përmes trashëgimisë kulturore”. Me këtë projekt janë përzgjedhur disa lokacione të trashëgimisë kulturore dhe natyrore më atraktive në Komunë, duke formuar një shteg turistik për vizitorë. Ky shteg, me këto vendndodhje kulturore është botuar në një hartë e cila do të shërbejë si udhërrëfyes turistëve për vizitë në këto lokacione. Po ashtu, lokacioneve të përzgjedhura në afërsi u janë vënë nga një pllakë informative me të dhënat e përgjithshme për atë lokacion. Njëherit OJQ “Podguri”, po ashtu me qëllim, nxitjen e turizmit përmes vlerave të trashëgimisë kulturore, ka botuar një Katalog dhe gjiruar një Film dokumentar për Veshjen e Podgurit, si një trashëgimi e rrallë e etnokulturës së kësaj treve.

Turizmi rural

Një ndër format e turizmit në Komunën e Istogut mund të jetë edhe turizmi rural. Tokat e punueshme që gjenden në fshatrat e Istogut janë të mbjellura me shumë produkte të ndryshme, si me pemë, ashtu edhe perime. Po ashtu, në këtë rajon është e zhvilluar edhe blegtoria ku tregon edhe prodhimi i produkteve qumështore e ku fshatarët e Istogut kanë një traditë është një mundësi e mirë që duhet shfrytëzuar. Me meremetimin e kullave, si trashëgimi kulturore, fshatarët do të mund të ofrojnë turistëve akomodim në familjet e tyre dhe ushqime nga produktet vendore. Ndikim pozitiv në zhvillimin e këtij lloji turizmi kanë festivalet e ndryshme lidhur me bujqësinë apo blegtorinë, siç është “Festivali i Mollës”, i cili organizohet për çdo vit në fshatin Kovragë të Istogut, me rastin e fillimit të vjeljes së mollëve. Një organizim i mirëfilltë i agro-turizmit, do t’u ofronte turistëve mundësinë që të mbledhin molla, të shohin se si prodhohet mjalti, si funksionon mulliri, të njihen për së afërmi me rritjen e bagëtisë, shpezëve etj., si dhe të blejnë prodhimet lokale.

Turizmi transit

Kjo formë e turizmit mund të zhvillohet edhe në Komunën e Istogut, për shkak të pozitës që ka si vend kufitar me Malin e Zi dhe Serbinë. Turistët në kuadër të vizitave transite të këtij rajoni, sidomos të monumenteve kulturore dhe arkeologjike, si dhe atraksioneve të ndryshme natyrore, do të mund të shfrytëzojnë edhe shërbimet e gastronomisë që ofrojnë hotelet në këtë lokalitet, për shijuesit e ushqimit të këndshëm. Në këtë mes më e njohura është hotel “Trofta” e cila ka një ambient të bukur dhe atraktiv, si dhe ofron një koleksion të pasur të gjitha llojeve të ushqimit të peshqve, si dhe të llojeve të ndryshme të specialiteteve ushqimore. Një akomodim dhe shërbim në nivel të këtij lloji, për turistët, ofrojnë edhe hotelet “Kosova Park” në Banjë, hotel “Park” në Gurrakoc, si dhe restorantet e shumta.

Eko-turizmi

Istogu, si vend me natyrë shumë të pasur dhe të pa shkatërruar, me tokë shumë pjellore, e cila punohet nga fshatarët, të cilët ofrojnë shumë produkte të ushqyeshme, të trajtuara vetëm me plehra organike, me bjeshke atraktive të cilat ofrojnë kushte të volitshme për pushim dhe rekreacion, pas-taj me një përkujdesje më të madhe ndaj pastërtisë së qytetit dhe mirëmbajtës dhe grumbullimit të mbeturinave, ofron kushte shumë të volitshme dhe ofertë e begatë për të gjithë turistët që dëshirojnë ta vizitojnë këtë lokalitet.

Çka të ndërmerret për nxitjen e turizmit

Për arritjen e të gjitha këtyre synimeve që kanë për bazë zhvillimin e turizmit duhet të investohet më shumë në infrastrukturë turistike, si: qendrat informative, restorantet, kafenetë, rrugët lokale etj. që familjet me fëmijë dhe persona të cilët çmojnë elementet e aktiviteteve të bazuara në natyrën, duhet të vendosen në lokacione të përshtatshme në natyrë ose në qytet dhe fshatra.

Qendra informative për turistë ofron informata për mundësitë e akomodimit, aktivitetet sportive dhe kulturore, vendet për tu vizituar, zhvillon konceptet për infrastrukturën turistike shtesë dhe aktivitetet e lira, si ekskursionet ose ngjarje të ndryshme. Seminaret dhe kurset e niveleve të ndryshme të trajnimit të stafit kualifikues, do të ofrohen përkohësisht në Komunë me qëllim të sigurimit të kualitetit të shërbimeve turistike.


Ndertimi i stazave për ecje dhe shetitje të cilat janë format më të mira për ta përjetuar natyrën. Ndërsa, ecja apo çiklizmi malor në distancave të gjata ose nëpër terren të vështirë, kërkon aftësi fizike dhe njohuri dhe staza për bicikleta. Aktivitetet tjera të cilat mund të zhvillohen këtu janë alpinizmi, çiklizmi malor, kampimi dhe gjuetia.

Prandaj, mbrojtja e biodiversitetit dhe e peizazhit duhet të jetë detyrë e përhershme e Komunës. Ndërsa, futja e “Bjeshkëve të Istogut” në kuadër të shpalljes së “Bjeshkëve të Nemuna”, Park Nacional, do ta rriste vlerën e kësaj zone dhe mundësonte zhvillimin e veprimtarive ekonomike.

Pjesa 4


IV. Anketa me qytetarë dhe Identifikimi i Problemeve

1.1. Pesë problemet kryesore në fushën e mjedisit në Komunën tuaj



Si probleme të tjera të theksuara nga qytetarët e Istogut janë: Prerja apo dëmtimi i pyjeve dhe ndezja e zjarreve – qoftë për pastrim të arave apo mbeturinave të tjera.


1.2. Tre ndotësitë kryesore të mjedisit në territorin e Komunës tuaj




Probleme të tjera të theksuara nga respondentët, si ndotës të mjedisit janë:

Djegia e mbeturinave, gjeneratorët, gurthyesit dhe vetë njeriu.

1.3. Çka duhet të jetë bazë e zhvillimit të ardhshëm të Komunës suaj?



1.4. Rrumbullakësoni tri problemet që më së shumti ndikojnë negativisht në cilësinë e jetës në lagjen tuaj?



Pjesa 5

IDENTIFIKIMI I PROBLEMEVE

1.Ujërat

Problemi	Shkaku (Listë shkaqesh që sjellin problemin, që mund të jenë, fizike dhe njerëzore).	Shkalla e ndikimit	Ndikimi (Paraqet ndikim negativ në mjedis, shëndet, mirëqene etj.).	Prioriteti (I matur me shkallën: *Pak i rëndësishëm **Mesatarisht i rëndësishëm ***Shumë i rëndësishëm
1.1 Lumenjtë Ndotja e vazhdueshme nga derdhjet e ujërave të zeza dhe mbeturinat. Vërshimet, si pasojë ngushtimet të shtretërve dhe hedhjes së mbetjeve urbane.	-Derdhja e ujërave të zeza të pa trajtuara; -Hedhja e mbeturinave urbane; -Hedhja e mbeturinave të ngurta; -Ngushtim i shtretërve të lumenjve nga ndërtime të pa kontrolluara; -Devijimi nga shtrati i vet natyror dhe; -Mungesa e digave për kanale të ujitjes.	E lartë	- Rritje e nivelit e ndotjes në lumenj; -Ndotja e bregut të lumit deri të vendbanimet e afërta; -Ulje e oksigjenit-rrezikon florën dhe faunën në ujë; -Përmbytja e tokave bujqësore nga ngushtimi i shtretërve dhe kanaleve, dhe; -Ujë i papastër.	***
1.2 Lumi “Istog” Degradimi i rrjedhës së lumit dhe ulja e nivelit të ujit. Derdhja e ujerave të zeza të pa trajtuara.	-Mungesa e një sistemi për trajtimin e ujërave atmosferike; -Reshjet e pakta atmosferike; -Ndryshimet klimatike dhe; -Hedhja e mbetjeve urbane në lum dhe kanale.	E lartë	-Përmbytje në kohë reshesh. -Pakësimi i rezervave të ujit. -Ndikim në cilësinë e jetës dhe; -Ndotje e lartë e ambientit.	***
1.3 Sistemi i ujitjes Dëmtimi i kanaleve të ujitjes.	-Mos funksionimi i mirëfilltë i sistemit të ujitjes dhe; -Prishja e pusetave shkarkuese.	E mesme	-Zvogëlimi i sipërfaqeve të ujitura dhe; -Humbje e ujit për ujitje.	**
1.3.1 Rrjeti i kanaleve të ujitjes Mosmirëmbajtja e kanaleve të ujitjes. Sistemi i vjetruar i kanaleve.	-Humbje e ujit; -Mosmirëmbajtja e kanaleve nga ndërmarrja e ujërave; -Mungesë investimesh dhe; -Mungesa e digave për kanale të ujitjes.	E lartë	-Ulja e rendimenteve nga bujqësia; -Rënie e cilësisë së prodhimeve bujqësore dhe; -Zvogëlim i të ardhurave.	***
1.4 Ujërat nëntokësore. 1.5 Rëne e sasisë së ujërave nëntokësore, si pasojë e reshjeve të pakta.	-Ndryshime klimatike dhe; -Dëmtimi i sipërfaqeve të gjelbëria dhe i pyjeve.	E mesme	-Zvogëlim i sasisë së rezervave të ujërave nëntokësore dhe; -Ndikim negativ në ambient.	**
1.6 Burimet e ujërave të ëmbla Mosmirëmbajtja e hapësirave përreth burimeve.	-Mungesë e investimeve dhe; -Mungesa e infrastrukturës.	E mesme	-Ambient i papastër; -Mungesë e mbrojtjes nga erozioni dhe; -Papastërti e shtratit përgjatë lumit.	**
Burimet e ujërave termo-minerale. Shfrytëzimi joracional i tyre.	-Këq menaxhimi; -Promovimi i dobët dhe; -Mungesa e iniciativave për investime.	E mesme	-Shfrytëzim i pamjaftueshëm i potencialeve; -Ambient i papastër dhe; -Ulje e numrit të turistëve.	***

2. Toka

Problemi	Shkaku	Shkalla e ndikimit	Ndikimi	Prioriteti
2.1 Zvogëlimi i sipërfaqes së tokës bujqësore.	-Lëvizje demografike e popullatës; -Mungesa e planeve rregullative urbane dhe; -Ndërtimet në toka bujqësore.	E mesme	Ndërrimi destinacionit të tokës bujqësore, në ndërtimore; -Ulje e nivelit të zhvillimit bujqësisë dhe; -Ulje e rendimenteve të prodhimit.	**
Përmytjet e tokës bujqësore.	-Mos pastrimi i shtretërve të lumenjve dhe; -Mos mirëmbajta e kanaleve të ujitjes dhe kanaleve kulluese.	E mesme	-Humbja e sipërfaqes së tokës punuese dhe; -Ndryshimi i përdorimit të tokës.	**
Ulja e nivelit të punësimit në bujqësi.	-Emigracioni fshat qytet; -Mungesë subvencionesh dhe; -Mungesë e tregut të shitjes.	E mesme	-Të ardhura të ulëta dhe; -Ulë vlerat e tokës dhe ndikon negativisht në zhvillimin e qëndrueshëm.	**
2.2 Tokat pyjore Problemi i pakësimit të sipërfaqeve të gjelbëruara.	-Prerja pa kriter i pyjeve dhe; -Mos pyllëzimi.	E ulët	-Ndikimi në peizazhe dhe; -Ndikim në cilësinë e tokës humusore.	*
2.3 Tokat erozive Bimësi e pakët, ndikim në erozion.	-Prerja pa kriter i pyjeve dhe; -Mungesa e pendave mbrojtëse.	E mesme	-Shkaktimi i erozioneve dhe; -Përmytje e vendbanimeve në kohë reshjesh.	**
2.4 Tokat ndërtimore Shfrytëzim joracional i tokës ndërtimore.	-Mos interesim i duhur; -Mungesa e planeve rregulluese; -Mos zbatimi i ligjeve dhe; -Mungesë fondesh dhe kapacitetesh.	E lartë	-Pengon mundësinë e zhvillimit të prioriteteve; -Parregullsi urbanistike; -Ulë cilësinë e mjedisit dhe; -Rritë volumin e inerteve dhe ndotje e ajrit.	**
Rritja e trafikut në qytet. Mungesa e vend parkingjeve.	-Rritja e numrit të automjeteve.	E mesme	-Rritja e nivelit të ndotjes në ajër; -Rritje e zhurmave në mjedis dhe; -Dëmtimi i trotuareve.	**
Mungesa e parqeve dhe lulishteve.	-Mosinteresimi për investime në këtë drejtim dhe; -Mungesë fondesh.	E mesme	-Mungesë e mjediseve çlodhëse; -Ajër dhe ambient i papastër dhe; -Ulë vlerat turistike të qytetit.	***

3. Ajri

Problemi	Shkaku	Shkalla e ndikimit	Ndikimi	Prioriteti
Ndotja e ajrit nga emetimet e gazrave të dëmshme.	-Numri i madh i automjeteve pa filtër; -Gjeneratorët, si pasojë e mungesës së rrymës; -Djegia e mbeturinave plastike, gomave dhe atyre familjare, dhe; -Avullimet nga deponitë dhe rrjeti i zbuluar i ujërave të zeza.	E lartë	-Ndikimi në shëndetin e popullatës; -Mundësia e infeksioneve të ndryshme dhe; -Ajër i papastër.	***
Ndotja e ajrit nga pluhurat	-Strukturë jocilësore e rrugëve; -Mospastrimi i duhur i rrugëve dhe; -Rrugët e pa asfaltuara.	E mesme	-Ndikimi në shëndetin e popullatës dhe; -Ndotje e ambientit.	***

4. Biodiversiteti

Problemi	Shkaku	Shkalla e ndikimit	Ndikimi	Prioriteti
4.1 Biodiversiteti Mungesa e një strategjie për ruajtjen e florës dhe faunës. Mungesa e një studimi për llojet e rrezikuara të specieve të veçanta.	-Mungesa e një strategjie për ruajtjen e biodiversitetit dhe; -Mungesa e investimeve në këtë lëmi.	E lartë	-Dëmtimi i florës dhe faunës; -Zhdukja e specieve të rralla bimore dhe shtazore dhe -Varfërimi dhe dëmtimi i habitateve.	***
Zvogëlimi i sipërfaqeve të gjelbra (pyje, livadhe).	-Prerja pa kriter i pyjeve dhe; -Erozioni si pasojë e mos mirëmbajtës së shtretërve të lumenjve.	E mesme	-Ndikim negative në mjedis dhe; -Pakësim i florës dhe faunës.	**
Pakësim i botës shtazore dhe shpezore.	-Zvogëlimi i sipërfaqes pyjore dhe -Gjuetia e paligjshme gjatë kohës së shumimit.	E lartë	-Prishja e ekosistemit (zinxhirit jetësor ushqyes) dhe; -Ndikon negativisht në zhvillimin e faunës së egër, gjuetisë sportive dhe turistike.	**
Zvogëlimi i sasisë dhe llojeve të peshqve në lumenj.	-Ndotja e lumenjve nga derdhjet e ujërave të zeza dhe; -Gjuetia e peshkut në kohën e shumimit me mjete të ndaluara (gjeneratorë).	E lartë	-Pakësim i peshkut dhe ujë e nivelit mjedisor dhe ekonomik.	***
4.2 Zonat e mbrojtura Mungesa e zonave të mbrojtura.	-Mos interesim i organeve kompetente; -Rrezikimi nga dëmtimet e llojeve florës dhe faunës dhe; -Menaxhim i dobët i autoritetit pyjor.	E mesme	-Ndikim negativ në mjedis; -Humbje e vlerave ekologjike dhe; -Dëmtimi i florës dhe faunës.	***
4.3 Ekosistemet specifike Dëmtimi i brigjeve të lumit.	-Shfrytëzimi i rërës pa kriter dhe; -Mos marrja e masave për sanimin e terrenit të dëmtuar.	E mesme	-Ndryshim i rrjedhjes së lumit e si pasojë erozioni i brigjeve; -Dëmtim i peizazhit natyror dhe; -Peizazh jo i këndshëm.	**

5. Mjedi social dhe ekonomik

Problemi	Shkaku	Shkalla e ndikimit	Ndikimi	Prioriteti
5.1 Arsimi Mungesë e një strukture të plotë edukimi mjedisor në shkolla dhe në komunitet.	-Mungesë vizioni; -Mungesë investimesh dhe; -Koordinim jo i mirë në mes institucioneve relevante.	E lartë	-Ndikim negativ në menaxhimin e natyrës; -Ulje e vlerave qytetare të rajonit dhe; -Ndikon në rritjen e brezit të ri (ambientalist).	***
5.2 Bujqësia Zvogëlim i sipërfaqes së tokës.	-Copëzimi i tokave; -Lëvizja demografike e popullatës dhe; -Kthimi i tokës në livadhe.	E lartë	-Ndikim në uljen ekonomike dhe; -Mosinteresim për tokën dhe kultivimin e qëndrueshëm bujqësorë.	**
Ulje e nivelit të punësimit në bujqësi.	-Nivel i ulët i punimit të tokës bujqësore; -Niveli i ulët i subvencioneve dhe -Mungesë e tregut të shitjes.	E lartë	-Të ardhura të pakta ekonomike dhe; -Nxitje e emigracionit.	**
Struktura e mbjelljeve jo e drejtë.	-Nuk ka prioritete për kultura industriale (farore) e në vreshtari.	E mesme	-Ulë vlerat e tokës dhe; -Ndikim negative në zhvillimin e qëndrueshëm.	**
5.3 Blegtoria Pakësimi i numrit të krerëve në blegtori.	-Mungesë investimesh në përmirësimin racor dhe; -Mos subvencionimi.	E lartë	-Rënie e të ardhurave ekonomike.	***
Mungesa e përpunimit dhe tregtimit të produkteve blegtorale.	-Mungesa e fondeve për teknologjinë e përpunimit.	E mesme	-Rritje e ulët e krerëve të bagëtive në raport mundësitë ushqyese të kullotave.	**

6. Turizmi

Problemi	Shkaku	Shkala e ndikimit	Ndikimi	Prioriteti
Mungesa e një politike për zhvillimin e turizmit.	-Mungesë e planifikimit në këtë fushë.	E lartë	-Shkallë e ulët e zhvillimit të turizmit dhe; -Ulje mundësinë e të ardhurave nga ky sektor.	***
Mungesa e produktit atraktiv turistik. Mungesa e qendrave të informimit.	-Mungesa e promovimit të ofertës turistike (turizmit malor, fushor, speleoturizmit).	E lartë	-Ulje e vlerave turistike dhe; -Ulje e numrit të turistëve.	***
Mungesa e një strategjie të zhvillimit afatgjatë shoq-ekonomik.	-Mungesa e ekspertëve për hartimin e një plani afatshkurtër.	E mesme	-Formë e paorganizuar e turizmit.	***
Mungesa e paketave turistike profesionale për tërheqjen e klientëve të huaj dhe vendës.	-Mungesa e një promovimi profesional të produktit turistik e kulturor i gërshetuar me aktivitete argëtuese.	E mesme	-Ulje e vlerave turistike dhe; -Interesim i vogël i turistëve për ta vizituar vendin.	***
Pamundësia e vizitave të zonave atraktive turistike.	-Mungesa e një rrjeti të mirëfilltë të akseve rrugore.	E lartë	-Mos promovimi i zonës.	***
Menaxhimi jo profesional i hoteleve. Mungesa e restoranteve tradicionale.	-Staf me një nivel të ulët profesional dhe; -Mungesa e promovimit të restoranteve tradicionale.	E mesme	-Mosinteresimi për vizitë në vend dhe; -Humbje e vlerave turistike.	**
Lokacione arkeologjike dhe historike të pa hulumtuara dhe të pambrojtura.	-Lënie pas dore dhe; -Mos interesim i institucioneve relevante nga niveli qendror dhe lokal.	E lartë	-Degradim i vlerave turistike të rajonit.	***
Mungesa e një kuadri promovues dhe menaxhues për ofertën turistike të vendit.	-Mungesa e trajnimeve për aftësimin e kadrove për guidë turistike dhe; -Mungesa e materialeve promovuese turistike (tabela orientuese, spote, broshura etj.)	E lartë	-Mos zhvillim i Komunës -Ulje e vlerave turistike dhe; -Migrim i popullatës për mungesë pune.	***

V. Planifikimi i veprimeve

Veprimet:

Lista e veprimeve që duhet të ndërmerren për zgjidhjen e problemeve.

Prioriteti - i matur me shkallen:

* Pak i rëndësishëm

** Mesatarisht i rëndësishëm

*** Shumë i rëndësishëm

Afati kohor - i matur me shkallën:

Afatshkurtër, deri 5 vjet

Afatmesëm, deri 10 vjet

Afatgjatë, deri 15 vjet

Akterët përgjegjës dhe bashkëpunëtorët e mundshëm:

Mund të jenë institucionet që janë direkt përgjegjës për problemin, si dhe aktorë të tjerë në rolin e bashkëpunuesit

Efekti:

Një përshkrim i efektit pozitiv që vjen nga zgjidhja e këtyre problemeve.

Problemi	Veprimet	Prioriteti - Afati kohor	Akterët	Efekti
1.1 Lumenjtë (përroskat, ujërat sipërfaqësore) Ndotja e ujit dhe degradimi i lumenjve dhe përroskave nga komuniteti dhe faktorët natyror.	-Ndalimi i hedhjes së mbeturinave të ngurta në lumenj; -Ngritja e gardheve antierozive në brigjet e zhveshura dhe; -Rregullimi i shtretërve të lumenjve, “Qaushi”, “Shushica” etj.	*** Afatshkurtër	-Komuna; -Ministritë përkatëse; -Donatorët e mundshëm dhe; -Komuniteti.	-Vetëdijesimi i qytetarëve; -Mbrojtja e tokave nga përmbytjet dhe; -Ujë i pastër për ujitje.
1.2 Lumi “Istog” Derdhja e ujërave të zeza, të pa trajtuara. Degradimi i rrjedhjes së lumit dhe ulja e nivelit të tij.	-Ndërtimi i një impianti për qytetin për trajtimin e ujërave të zeza; -Studimi i fizibilitetit të lumit për shkak të ndryshimeve klimatike dhe -Pastrimi dhe rregullimi i shtratit të lumit “Istog”.	*** Afatshkurtër	-Ministritë përkatëse; -Donatorët dhe; -Komuna.	-Zgjidhja e problemit të ujërave të përdorura; -Mbrojtja e florës dhe faunës së lumit dhe; -Ambient i pastër.
Mostrajtimi i ujërave atmosferike.	Ndërtimi i kanaleve për disiplinimin e ujërave atmosferike.	** Afatmesëm	Ministritë përkatëse; -Donatorët dhe; -Komuna.	-Shmangen përmbytjet e qytetit.
1.3 Sistemi i ujitjes Dëmtimi i kanaleve të ujitjes.	-Riparimi i kanaleve të ujitjes (Ana e majtë dhe e djathtë e kanaleve, të Burimit - Istog); -Të zbatohet ligji: Prodhuesit e peshqve , ujin e përdorur, të filtruar, ta kthejnë në kanale për ujitje.	*** Afatmesëm	-Komuna; -Ministritë përkatëse; -KRU “Hodrodrini” dhe; -Donatorët.	-Ujë i pastër dhe; -Shtim i sipërfaqes së tokës në sistemin e ujitjes.
1.3.1 Rrjeti i kanaleve të ujitjes Sistemi i vjetruar i kanaleve të ujitjes. Mungesa e pendave.	-Betonimi i kanaleve të ujitjes; -Meremetimi i atyre ekzistuese dhe; -Ndërtimi i pendave për ujitje (Bajicë, Lluga të Saradaranit, Gurrakoc).	*** Afatmesëm	-Ministritë përkatëse; -Komuna dhe; -Donatorët e mundshëm.	-Efikasitet më i lartë i përdorimit të ujit; -Rritje e prodhimeve bujqësorë dhe; -Rritë mirëqenien e bujqve.
1.4 Ujërat nëntokësore	-Studimi hidrologjik për rënien e nivelit të ujërave nëntokësore dhe; -Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura.	*** Afatmesëm	-Ministria e Ambientit dhe Bujqësisë, dhe; -Komuna	-Përmirësim i ekosistemeve në rajon dhe; -Rritja e sipërfaqeve të pyllëzuara.
1.5 Burimet Infrastrukturë e dobët afër burimeve të ëmbla.	-Ndërtimi i urës që lidh dy brigjet e burimit në Istog; -Rregullimi i ambientit për rreth burimeve dhe; -Vendosja e kontejnerëve dhe ulëseve për vizitorë.	*** Afatshkurtër	Komuna dhe; Donatorët.	-Ambient i pastër dhe atraktiv, dhe; -Nxitje e turizmit.
Burimet e ujërave termominerale-mosshfrytëzimi i duhur i kapaciteteve.	-Hartimi i një strategjie për mundësitë rritjes së kapacitete shfrytëzuese; -Rregullimi i infrastrukturës përreth burimeve dhe; -Hartimi i projekteve për shfrytëzim dhe promovimi i vlerave të këtyre burimeve.	** Afatmesëm	Ministritë përkatëse; Komuna dhe; Donatorët.	-Nxitje e zhvillimit ekonomik të zonës; -Ambient i pastër dhe -Zhvillimi i turizmit shëndetësorë.

2 Toka

Problemi	Veprimet	Prioriteti - Afati kohor	Akterët	Efekti
2.1 Copëzimi i sipërfaqeve të tokave.	-Të bëhet rigrupimi i sipërfaqeve të tokave (kamasacioni); -Nxjerrja e rregulloreve për përdorimin e tokave bujqësore dhe; -Kontrollimi i lëvizjes demografike të popullatës.	*** Afatmesëm	Ministritë përkatëse; Komuna dhe; Donatorët.	-Rritje e sipërfaqeve të tokës; -Rritja e rendimenteve bujqësore dhe; -Rritje e mirëqenës dhe përmirësim i mjedisit.
Përmbytjet e tokave bujqësore.	-Rregullimi i shtretërve të lumenjve; -Hapja e kanaleve kulluese dhe; -Pastrimi i kanaleve ujitëse dhe betonimi i tyre.	*** Afatshkurtër	Komuna; Ministritë dhe; Qytetarët.	-Ruajtja e sipërfaqes bujqësore; -Shtim i rendimenteve dhe; -Ambient i këndshëm.
Ulja e nivelit të punësimit në bujqësi. Mosinteresimi për punimin e tokës.	-Stimulimi i fermerëve me kredinë të volitshme; -Organizimi i trajnimeve për menaxhimin e pemishteve dhe mbjelljen e bimëve industriale (farorëve, vreshtave) dhe; -Shtimi i masave stimuluese-subvencioneve shtetërore për bujqësinë.	*** Afatmesëm	Ministritë; Komuna; Donatorët dhe; OJQ-të.	-Hapja e vendeve të reja të punës; -Zhvillim ekonomik; -Ngritja e nivelit të Dijës të fermerëve dhe; -Aplikimi i teknologjive të reja në bujqësi.
2.2 Tokat pyjore	-Ndalimi i shfrytëzimit pa kriter i kullosave dhe; -Plehërimi i sipërfaqeve të caktuara të kullosave.	** Afatgjatë	Komuna dhe; Ministritë përkatëse.	-Përmirësohet gjendja e kullosave dhe; -Zvogëlohet rreziku nga erozioni.
2.3 Tokat erozive Prerja pa kriter i pyjeve. Zhvëshja e sipërfaqeve të tokave nga gurëthyesit.	-Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhvëshura; -Parandalimi i shfrytëzimit joracional i resurseve natyrore dhe; -Ndërtimi i pendave dhe gardheve mbrojtëse.	** Afatgjatë	Ministritë; Komuna dhe; Donatorët.	-Zvogëlim i rrezikut nga erozioni; -Pengimin i prurjeve të ngurta nga përrenjtë malor dhe; -Zvogëlon rrezikun e përmbytjeve në qytet .
2.4 Tokat ndërtimore	-Hartimi i planeve rregulluese për qytetin dhe për të gjitha qendrat urbane; -Zbatimi i Ligjeve dhe; -Ngritje e kapacitetesh projektuese.	*** Afatshkurtër	Qeveria dhe; Komuna.	-Ndalon parregullsitë urbanistike dhe; -Rritë cilësinë e mjedisit, zvogëlon shtimin e inerteve dhe ndotjen e ajrit.
Shtimi i trafikut në qytet. Mungesa e vend parkingjeve.	-Hartimi i studimeve për rikonstruimin e rrjetit rrugor; -Ngritja e një vend parkimi për automjete në afërsi të Komunës dhe; -Shqyrtimi i mundësive për shtimin e vend parkingjeve në qytet dhe në qendrat urbane të Komunës.	** Afatmesëm	Ministritë; Komuna dhe; Donatorët.	-Përmirësimi i qarkullimit të automjeteve dhe të këmbësorëve, dhe; -Mbrojtja e zonave të veçanta të qytetit nga mbingarkimi.
Mungesa e parqeve dhe lulishteve.	-Ngritja e parkut të qytetit në sipërfaqen e ish-ndërmarrjes “Radusha”; -Ngritja e parqeve dhe lulishteve në të mirat e fshatrave, (e njohur si utrina) dhe; -Të bëhet rregullimi, përkatësisht gjelbërimi i ambienteve të shkollave.	*** Afatshkurtër	Ministritë; Komuna dhe; Donatorët.	-Krijimi i mjediseve çlodhëse dhe argëtuese për komunitetin -Përmirësim i peizazhit dhe; -Ngritë vlerat turistike të qytetit.

3 Ajri

Problemi	Veprimi	Prioriteti - Afati kohor	Akterët	Efekti
Ndotja e ajrit nga emetimi i gazrave të dëmshëm për shëndetin.	-Eliminimi i deponive të mbeturinave në vende urbane dhe rurale; -Parandalimi i djegies së mbeturinave familjare, gomave, mbeturinave me përbërje, si dhe regjistrimi i automjeteve pa filtër, dhe; -Ndërtimi i një furre moderne për djegien e mbetjeve spitalore të rrezikshme.	*** Afatshkurtër	Ministritë; Komuna dhe; Donatorët.	-Ulë rrezikun nga sëmundje të ndryshme të rrugëve respiratore, bronkiet dhe astme-bronkiale; -Minimizim i ndotjes së ajrit, nga shpërbërja e mbetjeve organike në ajër dhe djegia e tyre, dhe; -Minimizon ndotjen e ajrit rreth territorit të spitalit.
Ndotja e ajrit nga pluhurat.	-Ngritja e cilësisë së pastrimit të qytetit, me mjete për larjen e rrugëve; -Asfaltimi i rrugëve dhe rrugicave në qytet dhe zona urbane, dhe; -Sigurimi e aparatit monitorues për matjen e cilësisë së ajrit nga ndotësit e ndryshëm.	*** Afatmesëm	Ministritë; Donatorët dhe; Komuna.	-Përmirësim i situatës mjedisore dhe; -Njohja e saktë e situatës së ndotjes së ajrit, si dhe rritë mundësinë e ndërhyrjes në zbutjen ndotësve në zona të banuara të qytetit.

4. Biodiversiteti

Problemi	Veprimet	Prioritet - Afati kohor	Aktorët	Efekti
4.1 Biodiversiteti Rrezikimi i florës dhe faunës e sidomos i specieve të rralla.	-Të hartohet strategjia për ruajtjen e biodiversitetit dhe; -Të bëhet studimi për llojet e rrezikuara të specieve të veçanta dhe mbrojta e tyre.	*** Afatmesëm	Ministritë; Komuna; Donatorët dhe; OJQ-të.	-Mbrojta e specieve të veçanta të bimëve dhe shtazëve, dhe; - Ruajtja e ekosistemeve.
Zvogëlimi i sipërfaqeve të gjelbëruara.	-Ndalimi i prerjes pa kriter i pyjeve dhe; -Pyllëzimi i peizazheve (Gurrat e Bardha, Lugu i Zajmit, Lugu i Butë, Lugu i Madh, Radusha, etj.)	*** Afatmesëm	Ministritë; Komuna; Agjensioni pyjor dhe; Donatorët.	-Mbrojta e ambientit; -Ruajtja e peizazheve dhe; -Ruajtja e vlerës ekologjike.
Problemi i pakësimit të gjitarëve (kaproj, dhelpra, ketri) dhe e shpendëve vendore, dhe shtegtarë.	-Shtimi i sipërfaqeve pyjore dhe; -Ndalimi i gjuetisë së paligjshme, si dhe gjuetisë në kohën e shumimit.	*** Afatmesëm	Ministritë; Komuna; Shoqata e Gjuetarëve dhe; Agjensioni Pyjor.	-Ruajtja dhe shtimi i vlerave të larmisë biologjike; -Shtimi i shtazëve dhe shpendëve të rrezikuar nga zhdukja dhe; -Zhvillimi i gjuetisë sportive dhe turistike.
Zvogëlimi i sasisë dhe llojeve të peshqve vendor në lumenj.	-Ndalimi i peshkimit të peshqve në kohën e shumimit, si dhe gjuajtja me gjeneratorë (rrymë) dhe; -Ruajtja dhe kultivimi i “Troftës” dhe specieve tjera të lumenjve.	** Afatgjatë	Komuna; OJQ-të dhe; Shërbimi policor.	-Ruajtja e specieve të veçanta dhe; -Rritje e turizmit lumor (gjueti sportive dhe turistike).
4.2 Zonat e mbrojtura Mungesa e zonave të mbrojtura.	-Futja e tërë sipërfaqes së “Bjeshkëve të Istogut” në kuadër të projektit për Shpalljen e “Bjeshkëve të Nemuna” Park Nacional; -“Mokna” të shpallet Zonë e mbrojtur dhe; -Sensibilizimi i komunitetit për njohjen e vlerave të zonave të mbrojtura dhe rëndësinë e tyre.	*** Afatshkurtër	Ministritë; Komuna; OJQ-të mjedisore dhe; Komuniteti.	-Ruajtja e ekosistemeve (zinxhirit natyror); -Ruajtja e florës dhe faunës, dhe; -Ruajtja dhe kultivimi i peizazhit.
4.3 Ekosistemet specifike Dëmtimi i sipërfaqeve të gjelbëria nga gurthyesit.	-Detyrimi i shfrytëzuesve të zhavorrit si dhe të gurthyesve për sanimin e sipërfaqeve të dëmtuara (kthim në gjendjen paraprake).	*** Afatshkurtër	-Komuna; -Ministritë; -OJQ-të mjedisore dhe; -Policia.	-Ruajtja e peizazhit të lumenjve; -Ruajtja e specieve të rralla dhe; -Zvogëlim i rrezikut nga erozioni.

5. Mjedisi social dhe ekonomik

Problemi	Veprimet	Prioriteti - Afati kohor	Akterët	Efekti
<p>5.1 Arsimi</p> <p>Mungesa e një strukture të plotë mjedisore në shkolla dhe në komunitet.</p> <p>Mungesa e programeve mjedisore.</p>	<p>-Edukimi mjedisor në shkolla të bëhet si lëndë e domosdoshme;</p> <p>-Publikim i materialeve të shkruara, botim i librave për edukimin mjedisor dhe;</p> <p>- Organizimi i ekskursioneve mjedisore në natyre.</p>	<p>**</p> <p>Afatmesëm</p>	<p>Ministria e Arsimit dhe; Komuna.</p>	<p>-Krijimi i kushteve për rritjen e brezave me dije dhe kulturën e duhur për respektimin e mjedisit, duke kontribuar për të ardhmen e vendit, dhe;</p> <p>-Rritja e ndërgjegjes qytetare dhe krijimi i traditës mjedisore.</p>
<p>5.2 Bujqësia</p> <p>Zvogëlimi i sipërfaqes së tokës.</p>	<p>-Të bëhet rigrupimi i tokave (kamasacioni);</p> <p>-Të subvencionohen prodhuesit bujqësorë;</p> <p>-Ndikimi në lëvizjen demografike të popullsisë fshat-qytet dhe;</p> <p>-Hapja e sipërfaqeve të tokës të mbuluara me shkurre.</p>	<p>***</p> <p>Afatmesëm</p>	<p>Ministria përkatëse; Komuna dhe; Donatorët.</p>	<p>-Rritje e sipërfaqes së tokës punuese;</p> <p>-Zhvillim ekonomik dhe;</p> <p>-Rritë mirëqenien e popullatës.</p>
